



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 43.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, nenin 5.1 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, nenit 37 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, dhe nenit 25.1 të Rregullores së punës të Kuvendit të Komunës së Podujevës,

THËRRAS

Mbledhjen e XXX-të (tridhjetë - mandati VII)-e rregullt, të Kuvendit të Komunës së Podujevës, e cila do të mbahet më **31 tetor 2023**, në sallën e mbledhjeve të Kuvendit në Komunën e Podujevës, në orën **10:00**, me këtë;

REND TË DITËS

1. Procesverbali nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e mbajtur më 31 korrik 2023
2. Propozim vendimi për formimin e komisionit ad-hoc për hartimin e Draft Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024
3. Propozim vendimi për vënien në konsultim publik Draft Planin Lokal i Veprimit për Barazi dhe Diskriminim në Komunën e Podujevës për periudhën 2023-2026
4. Të Ndryshme

Nr.Prot. 01-060/01-0077029/23
Podujevë, datë; 19 tetor 2023





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS

Procesverbal nga mbledhja e XXVIII-të (njëzetetë)-e rregullt, mandati VII-të, e mbajtur më 31 korrik 2023.

Mbledhja filloi në orën 10:35 dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit.

Në fillimin e mbledhjes të pranishëm ishin anëtarët/et e Kuvendit të Komunës së Podujevës:

(Nga LDK Valon Demolli; Arnisa Sylejmani; Arjeta Abazi; Edona Shabani; Arjant Topanica; Donjetë Sheqiri; Ilir Koprani; Qëndrim Softolli; Naim Çunaku; Ekrem Rrahmani; Tringa Sfishta; Fahri Hasani; kurse munguan; Demokrat Hodolli dhe Adnan Zymeri;

Nga LVV, Florent Hasani; Artrit Mulliqi; Kasib Bashota; Sebastina Vokri; Drita Pajaziti; Qëndresë Hajrizi; Ragip Fetahu; Xhevdet Maloku; Ardi Hasani; Haki Rudari; Bahri Blakçori; Lirika Maliqi; kurse mungoi Fitim Muçolli;

Nga PDK, Bashkim Syla; Mimoza Abdullahu, kurse mungoi Endritë Murati.

Nga AAK, Mrika Thaçi; Burim Hasani; Arbnor Fazliu.

Nga OBKD, Gazmend Islami i cili mungoi me arsyetim shëndetësor me shkrim dërguar Kryesuesit të Kuvendit.

Gjithashtu të pranishëm në fillimin e mbledhjes ishin, z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, znj.Marigona Lahu Nënkyetare e Komunës, drejtorët e Drejtorive të Komunës, dhe atë;

(Fatlum Osmani-Drejtoria e Buxhetit dhe Financave DBF; Avni Fetahu-Drejtoria e Arsimit DKA; Leutrim Krasniqi-Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit DPUMM; Saranda Stublla-Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë DPKGJ; Bahri Selimi-Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit DSHPMSSH; Vigan Salihu-Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik DPZHE dhe i Autorizuar për Drejtorinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural DBPZHR, Adelinë Stublla-Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale DSHMS dhe e Autorizuar për Drejtorinë e Administratës DA, Alban Zeka-Drejtoria e Inspeksionit DI)

Të pranishëm ishin edhe përfaqësues të KFOR, Përfaqësues të OSBE, përfaqësues të mediave lokale dhe disa zyrtar komunal.

Rendi i Ditës

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, e hapi mbledhjen duke i përshëndetur të pranishmit dhe duke i'u dëshiruar mirëseardhje dhe punë të mbarë në këtë mbledhje, konstatoi kuorumin, dhe në vazhdim theksoi, materialit besoj se i keni të gjithë me kohë duke përfshirë edhe ato nga mbledhja e KPF-së e mbajtur më 28.07.2023, andaj vetëm mund të vazhdojmë me këtë mbledhje.

Për momentin në sallë sipas listës së nënshkruar të pranishëm janë 30 anëtar/e të Kuvendit, kurse 5 mungojnë, pra kuorumi ekziston dhe mund të fillojmë me mbledhjen.

Urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth rendit të propozuar të ditës.

z.Arjant Topanica, theksoi, duke parë rezistencën e madhe kundërshtimin që u bë në mbledhjen e kaluar që pika Të Ndryshme të renditet e para në kuadër të rendit të ditës, me qëllimin e vetëm që interesi i qytetarëve të përcillet në Kuvendin e Komunës dhe interesi i tyre i shfaqur tek ne, të shihte se po ka dikush që i del zot zërit të tij, pyetjeve të tij, interesit të tij, por meqë hasëm në rezistencë të madhe duke përdorur arsyetim nga ana juaj (i drejtohet pozitës) se pika Të Ndryshme çdo kund si praktikë është pikë e fundit e rendit të ditës, unë tani propozoj që të shtohet një pikë e

re e rendit të ditës që në praktikën e shumicës së Kuvendeve Komunale është prezente dhe do të duhej të ishte prezente edhe tek ne, është pika Pyetje dhe Përgjigje, pikë e cila zakonisht vie si pikë e parafundit afër pikës Të Ndryshme, mirëpo propozimi jonë i Grupit të LDK-së është që kjo pikë e re e rendit të ditës të futet si pikë shtesë e rendit të ditës dhe të renditet si pikë e parë.

Besoj se nuk do të zgjasë shumë dhe secili do ta ketë mundësinë që të drejtoj një ose dy pyetje qoftë Kryetarit të Komunës apo drejtorëve përkatës të Drejtorive në mënyrë që të merren përgjigje në interesin e qytetarëve që ata kanë për këtë Komunë, për zhvillimet që ndodhin në të dhe shpenzimin e parasë publike që është para e tyre. Pra edhe njëherë kërkojmë mirëkuptimin e juaj dhe propozimi është që pika Pyetje dhe Përgjigje të shtohet në rendin e ditës dhe të renditet si pikë e parë në rendin e ditës, çështje kjo e cila nuk besoj se nuk merë shumë kohë 30-40 minuta varësisht pyetjeve dhe intensitetit të tyre që janë e që qytetarët i marrin ato përgjigje që i shohin me interes dhe pastaj vazhdojmë me pikat tjera sipas radhës.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi,

Meqë nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën, Kryesuesi i Kuvendit e hedh në votim dhe konstaton se 13 vota janë Për, 15 vota Kundër asnjë votë e Përmbajtur, (të tjerët nuk votuan), nuk mbështetet propozimi i z.Arjant Topanica që në kuadër të rendit të ditës si pikë e parë të hynë edhe pika Pyetje dhe Përgjigje.

znj.Edona Shabani, theksoi, dua të ndërlihem diçka jashtë rendit të ditës, ka të bëjë me super skandalin e javës ë kaluar nga kjo qeverisje komunale, andaj i nderuar Kryetar i Komunës, a mund të na tregosh deri kur do të vazhdojnë transferet dhe hakmarrjet ndaj punëtorëve të administratës komunale, përkundër faktit që krejt ato vendime tuajat janë anuluar prej Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil në Kosovë. Cili është tani problemi juaj me zyrën ligjore.

Kryesuesi i Kuvendit, duke i reaguuar parafolëses theksoi, e nderuar kolege nuk ka debat gjatë rendit të ditës por ka vetëm propozime për heqje të ndonjë pike, për ndonjë pikë shtesë apo rirenditje të pikave të rendit të ditës. Debati është në pikën të Ndryshme

znj.Edona Shabani, vazhdoi,, në rregull është kjo vetëm dua që i gjithë Ekzekutivi të jetë prezent në pikën Të Ndryshme, pavarësisht sa do të zgjatë kjo mbledhje, vetëm Ekzekutivi të jetë prezent kërkoj.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, sërish jua rikujtoj se nuk lejohet debat në pikën e rendit të ditës.

Urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim rendin e propozuar të ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës të dërguar për këtë mbledhje, edhe konstatimet nga mbledhja e KPF-së e mbajtur më 28.07.2023.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 30 anëtar/e sa ishin prezent në sallë, me 17 Vota Për, asnjë votë Kundër dhe asnjë votë e Përmbajtur (të tjerët nuk morën pjesë në votim), miratohet rendi i propozuar i ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës të dërguar për këtë mbledhje.

1. Informatë për aktivitetet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi – KKSB, për vitin 2022

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, dhe sipas detyrës zyrtare Kryesues i KKSB, duke e paraqitur Informatën në fjalë, theksoi, konform Udhëzimit Administrativ nr.27/2012-MPB, dhe nr.03/2012-MAPL, për themelimin dhe përbërjen e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, ashtu siç parashihet KKSB kam ndërmarrë veprime për përmbushjen e obligimeve sipas këtij akti nënligjor, përkatësisht para Kuvendit kam paraqitur Informatë për aktivitetet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2022.

Për përgatitjen e kësaj Informatë është themeluar Grupi punues i cili përveç përgatitjes së draft planit të punës së KKSB për vitin 2023, ka përgatitur edhe draftin e informatave të cilat janë diskutua dhe kanë kaluar përmes këtij Këshilli.

Informata në fjalë përfshinë punët dhe aktivitetet e zhvilluara të KKSB në përputhje me planin e punës, me një fjalë në këtë Informatë është përshkruar një përmbledhje e përmbajtjes së procesverbaleve nga takimet e rregullta të këtij Këshilli.

Sigurisht që për të gjithë ata që kanë nevojë për informata shtesë, besoj se materialin e kanë marrë me kohë dhe jemi të gatshëm për të diskutuar.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, informata që kemi dëgjuar përmes aktiviteteve në planin e punës së KKSB për vitin 2022 nuk është realizuar bash asnjë, nuk e di çfarë keni bërë, por punë. Plani i punës së KKSB ka pasë 7 objektiva dhe 14 aktivitete dhe asnjë prej tyre nuk është kryer, krejt çfarë ka ndodhë është raportimi i Komandantit të Stacionit të Policisë në Podujevës, dhe ai i KFOR. Nuk e di përse duhet të mblidhen rreth 20 persona të KKSB-së dhe ta dëgjojnë raportin e Komandantit të Policisë kur ai për çdo mëngjes e jep atë prej Stacionit për gjendjen krejt çka ka ndodhë në 24 orë. Në të gjitha punët tjera jeni “katastrofë” që s’keni bërë asgjë, këtu edhe më asgjë hiq, as plan dhe asnjë punë tjetër.

Kur flasim për siguri, Komuna e Podujevës nuk ka plan të reagimit emergjent që është obligim ligjor, kurse neve këtu na keni thënë që ka plan të tillë, do të thotë se na keni gënjer neve si Kuvend, ata që kanë besuar natyrisht. Keni rrezikuar rreth 80 mijë banorë të Komunës së Podujevës sepse diçka eventualisht të ndodh askush nga Agjencitë e Reagimit Emergjent nuk dinë se çfarë të bëjë, as Policia, as Zjarrfikësit, as emergjencat mjekësore e as grupet vullnetare, nuk e dimë ku ka strehimore e as ku janë pikat e grumbullimit. Gjatë vitit 2022 si KKSB keni pasë një plan prej 7 pikave çfarë ka bërë dikush nga Shoqëria Civile, keni pas për të mbajtur një punëtori për vlerësimin e mjedisit publik nga aspekti i sigurisë, e që punëtori e përbashkët me aktorët nuk është mbajtur, pastaj ka qenë në plan që të mbahet konsultimi i planit të reagimit të kërkesave të qytetarëve si dhe pika kritike e rrezikut e që edhe ky nuk është mbajtur, mandej ka qenë në plan që të mbahet identifikimi i plotësimeve dhe rekomandimeve për rritjen e sigurisë nga investimet kapitale por që edhe ky nuk është mbajtur, po ashtu ka qenë në plan të mbahet vlerësimi i shërbimeve publike nga këndi i sigurisë publike, hapësirat publike, ndërtesat publike dhe ndërtesat kolektive e që nuk është mbajtur, ka qenë në plan të mbahet vlerësimi i planit të reagimit emergjent, vlerësimi i pikave kritike të rrezikut, analiza e planit, analizë e pikave kritike të rrezikut e që nuk është mbajtur, po ashtu ka qenë në plan të bëhet një punëtori e akterëve institucional për koordinim, diskutim me palët, ndërlidhja e politikave e që nuk është mbajtur, si dhe pika e fundit ka qenë në plan që të mbahet punëtori në mes akterëve institucional dhe publik për hartimin e planeve të përbashkëta e që nuk është mbajtur, por që në këtë Informatë nuk është shkruar arsyeja përse nuk janë mbajtur këto, andaj a ka mundësi të na tregoni tani përse nuk janë mbajtur këto dhe përse nuk janë realizuar, përse mblidheni dhe jua jepni atyre anëtarëve nga 50€ të na tregoni nëse

janë ngushtë për ato 50€, mirëpo punë nuk kanë bërë fare, ndërsa nëse jeni mbledh që ta dëgjoni Komandantin e Stacionit të Policisë, nëse dëshironi jua sjellë raportin për çdo ditë këtu.

z.Haki Rudari, theksoi, Grupi i këshilltarëve të LVV-së në mbledhjen e vet të rregullt ka analizuar ndër të tjera edhe Informatën për aktivitetet e KKSB për vitin 2022, pra thjesht kemi të bëjmë me një Informatë për vitin paraprak dhe në këtë informatë gjithsej janë mbajtur 4 takime dhe në të gjitha takimet kanë marrë pjesë akterët që kanë të bëjnë me sigurinë, duke përfshirë Komandantin e Policisë, përfaqësues të KFOR, FSK-së, nga Ekzekutivi i Komunës etj.

Ajo çfarë kam zgjedh në këtë informatë janë disa çështje të cilat realisht janë në informatë, fjala është për raportimet e Komandantit të Policisë i cili ndër të tjera potencon: 1-kemi mungesë të stafit, 2-një numër i policëve është në moshë të shtyrë dhe me probleme shëndetësore, 3-kemi probleme logjistike, prandaj këto çështje është mirë që diskutohen edhe pse e dim se janë çështje të nivelit të lartë (Qeveri-Ministri).

Ajo që unë dëshiroj të ndalem në aspektin lokal është problemet e qytetarëve e që edhe përkundër krejt çka është bërë dhe angazhimeve të ndryshme sërish problemet e qytetarëve janë;

1-përdorimi i narkotikëve, 2-siguria në komunikacion, 3-siguria në shkolla apo afër shkollave, 4-vjedhjet e ndryshme dhe 5-lokalet afër shkollave e që për këtë kërkohet një vizitë ose një kontroll më e madhe.

Megjithatë, përkundër krejt këtyre çfarë u potencua, edhe në informatë shkruan se Komuna jonë është e qetë, stabile në aspektin politik, nacional, racor, religjioz e të tjera, por janë disa çështje të cilat unë mendoj se mund të tensionohen ose të kenë efekte negative siç janë; -rreziku nga qentë endacak, -vjedhjet, -dhuna në familje, -posedimi i arëve pa leje, -cenimi i sigurisë në komunikacion e që do të propozoja të ketë më shumë vizita, të ketë më shumë policë në vijat Lluzhan-Orllan; Podujevë-Sfeçël-Shajkoc; dhe Podujevë-Peran-Kërpimëh, e që në këto vija realisht ka një frekuencim të madh të mjeteve e sidomos në këtë kohë kur kemi edhe ardhjen e mërgimtarëve e që pastaj komunikacioni po është më i madh dhe mundësia e rrezikut për qytetarë është shumë e madhe, pra do të dëshiroja që në mbledhje të ardhshme të KKSB këto që i ceka të diskutohen më detajisht.

z.Bashkim Sylja, theksoi, në bazë të kësaj Informate vëhet re se mbledhja e parë e KKSB-së është mbajtur më 08.06.2022 e që realisht nga janari deri në qershor nuk është mbajtur asnjë mbledhje e KKSB-së.

Parafolësi përmendi disa shqetësime, realisht ato të Komandantit të Policisë sa i përket stafit të vjetruar, problemeve të paraqitura logjistike dhe për punë operative në terren si dhe disa kërkesa tjera e që njëra ndër to ishte për një kompani për bartjen e veturave që ish bërë në mbledhjen e dytë të KKSB e që pastaj ky problem është zgjedh. Pastaj problem tjetër ishte edhe për një veturë me targa për operimin e policëve me targa civile, kështu që ka pasë aktivitete të policisë. Jemi në dijeni se edhe me stafin e zjarrfikësve kemi probleme me mungesë të tyre por që është kompetentë e nivelit qendrorë. Është mirë që çfarë është në kompetencën tonë të bëhen kërkesa që këto probleme të zgjidhen. Pati edhe disa aktivitete tjera nëpër shkolla për çka falënderoj Policinë për punën që kanë bërë dhe gjithë akterët tjerë në mbarëvajtjen e rendit dhe ligjit.

z.Naim Çunaku, theksoi, mora fjalën për diçka që jemi duke debatuar dhe që e kemi vë akcentin kryesor vetëm te një akter që e përbën KKSB-së, pra i'u referuam Policisë mirëpo të mos harrojmë se ai është vetëm njëri prej akterëve. Në këtë Informatë faktikisht e kemi të incizuar apo të paraqitur një gjendje reale me gjendjen që e kemi, por shtrohet pyetja KKSB është ai i cili konstaton gjendje apo merre masa për identifikimin dhe për të siguruar që të mos ndodhin ato dukuri negative, dhe unë mendoj se kjo është puna e KKSB-së.

znj.Donjetë Sheqiri, theksoi, meqë jemi duke diskutuar për sigurinë në Komunën tonë dëshiroj të parashtoj një pyetje për Ekzekutivin e Komunës, a ka bërë Komuna jonë kërkesë për rritjen e stafit në brigadën e zjarrfikësve pasi që jemi në dijeni se kapacitetet punëtore janë shumë të vogla, pra a është bërë kërkesë dhe a pritet që të zgjerohet stafi në brigadën e zjarrfikësve.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, i dëgjova me vëmendje të gjitha çfarë u potencuan nga parafolësit anëtar të Kuvendit e që besoj se mund të jenë ashtu çfarë e potencuan disa prej tyre, por po ndalem tek Plani për emergjenca dhe planet tjera që u cekën, unë besoj se Komuna e Podujevës që 22 vite nuk ka punuar pa asnjë plan, ne nuk e kemi marrë prej fillimit këtë punë por kemi trashëguar diçka, janë në proces disa gjëra dhe besoj se parafolësi (Ekrem Rrahmani) i dinë këto gjëra. Nuk e kemi themeluar ne këtë institucion por kemi trashëguar diçka dhe është proces e që besoj se ju e dini këtë.

Jeni në dijeni se në këtë përbërje të këtij Këshilli është një Grup i cili është votuar nga ky Kuvend, nuk është Kryetari i Komunës që i bënë ato punë që u përmenden, por është ai Grup, madje shpresoj dhe konsideroj se është shumë mirë që në atë përbërje është edhe Shoqëria Civile mirëpo ajo duhet edhe të jep kontributin e jo vetëm ti interpretoj juve ato e pastaj ti (i drejtohet Ekrem Rrahmanit) ti thuash këtu, pra Shoqëria Civile është mirë të jap kontributin e vet në KKSB sepse është pjesë e përbërjes së tij, dhe jeni në dijeni se jo rastësisht i kemi dhënë kompetenca shtesë duke e caktuar kryesues të grupit punues për t'i vë ato të dhëna.

Sigurisht se ne jemi duke punuar në këtë aspekt, është Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit e cila është duke i kryer disa punë dhe shpresoj se shumë shpejt do t'i kemi disa prej atyre planeve emergjente të cilat janë të plotësuara dhe ndryshuara konform rrethanave dhe nevojave që janë.

Ajo që e potencoj kolegu anëtar i Kuvendit dhe kryesues i Grupit të LVV, është fakti që si Komunë e Podujevës po ndjehemi si Komunë me një siguri solide, dhe veprimet të cilat janë marrë prej të gjitha instancave që ndërlidhen me sigurinë janë në nivelin e duhur sepse nuk kemi telashe të cilat mund të ishin për tu veçuar, përveç atyre që janë të përgjithshme e që po merren të gjitha instancat relevante në segmentet dhe fushat e tyre që ti mbulojnë.

Ajo që është shumë e rëndësishme është bashkëpunimi i mirë me Policinë e Kosovës, me KFOR, me trupat e FSK-së. Kemi pas disa gjendje emergjente gjatë këtyre dy viteve të cilat mendoj se relativisht mirë janë menaxhuar e që besoj se pajtoheni edhe ju me mua që mirë janë menaxhuar të gjitha ato rrethana

Fatkeqësitë natyrore janë gjithmonë të mundshme, zakonisht Kosova nuk shuhet për vullkane dhe vullkanizëm por edhe ato mund të ndodhin, pra janë fatkeqësi natyrore që i ndodhin çdo kujt e që mund të na ndodhin edhe neve, por mirë është që me instancat relevante po komunikomë mirë.

Ajo që është problematike dhe shqetësuese për të gjithë ne është numri i vogël i Policëve duke marrë parasysh nivelin e Stacionit Policorë që e kemi në Podujevë, çështje kjo e cila është diskutuar me dhjetëra herë me nivelin lokal në Stacionin Policor, me Komandantin e Stacionit, por edhe me nivele tjera qendrore që të bëhet përpjekje për ta rritë numrin e Policëve sepse rritje e numrit të Policëve do të krijoj siguri më të madhe për të gjitha fushat që mbulon ky institucion i sigurisë, por ne jemi në dijeni se kemi pasë një situatë emergjente me numrin dhe kërkesat e mëdha që janë paraqitur për një periudhë të gjatë në veriun e vendit dhe sigurisht se për këtë janë arsyetuara edhe me mungesën e Policëve.

Ajo që është shqetësuese e që me të cilën jemi marrë jo tani por që nga ardhja jonë në pushtet është numri i vogël i zjarrfikësve, por këtë numër të vogël të zjarrfikësve nuk e kemi bërë ne, e kemi gjete kështu, pra nuk është diçka e sodit e as e djehit, por është në kontinuitet dhe kërkesë e jona ka qenë për ta rritë këtë numër, mirëpo jeni në dijeni se me këta zjarrfikës menaxhon Agjencia e

Menaxhimit Emergjent AME me një pjesë të kompetencave si dhe një pjesë të kompetencave e ka edhe niveli komunal e që në realitet ata janë për keqardhje sepse as nuk po kemi kompetenca të plota t'i menaxhojmë ne si Komunë, por as AME nuk i menaxhon siç duhet, e them këtë dhe për këtë po e jap një shembull; Komuna e Skenderajt, e që Podujeva mund të jetë dy ose tri herë më e madhe se ajo, ka numër më të madh të zjarrfikësve dhe atë sepse Komandanti i AME-së për një kohë të gjatë është menaxhuar prej tyre, i ka marrë në Prishtinë dhe në emër të Prishtinës i ka dërguar në Skenderaj duke i aktivizuar, prandaj e them se me numrin që jemi duke u ballafaquar dhe duke punuar këtu në Komunën e Podujevës është për keqardhje, mirë që nuk kemi pasë rreziqe shumë të mëdha sepse rreziku është i jashtëzakonshëm për mungesë të këtyre kuadrove.

Ne disa herë kemi tentuar të bëjmë rritjen e numrit të zjarrfikësve përmes formave të ndryshme, përmes një Shoqate jemi munduar t'i aktivizojmë ata persona që kanë qenë sepse ju e keni pas më të lehtë se sa ne ngase bënit disa kontrata mbi vepër dhe i punësonit dhe i mbanit disa miq, kurse ne nuk po mundemi as ato t'i bëjmë tani sepse janë ndaluar ato gjëra, kështu që ne kemi bërë përpjekje që ta rrisim këtë numër mirëpo nuk po kemi mundësi sepse nuk është çështja që po varet prej neve, madje jeni në dijeni se edhe numri i shërbyesve civil është i kufizuar dhe nuk mund të dalim jashtë numrit të lejuar.

Prandaj falë Zotit nuk kemi pasë zjarre të mëdha dhe nuk është paraqitur ndonjë rrezik i veçantë, këto që kanë qenë deri tani mënojnë se relativisht mirë janë menaxhuar dhe besoj se do të bëjmë përpjekje që koordinimet me institucionet relevante të sigurojnë të vazhdojnë dhe të thellohen në të ardhmen.

Sa i përket planit të punës po e them se nuk është detyrë ekskluzive e Kryetarit të Komunës që t'ju kryej ato detyra dhe obligime por unë i'u kam krijuar kushte dhe do t'iu krijoj kushte gjithëherë që ai Grup punues të punoj, të marrin iniciativa dhe sigurisht që ne si institucione lokale jemi të obliguar t'i përkrahim dhe t'i shtyjmë përpara.

Për fund dëshiroj t'ju rikujtoj të gjithë juve se gjendja e sigurosisë në Komunën e Podujevës është e mirë, nuk kemi probleme për të cilat mund të themi se janë shqetësuese, kemi dukuri të ndryshme qoftë në shkollë, qoftë me përdorimin e narkotikëve qoftë me dukuri tjera devijante me të cilat realisht po merren organet kompetente kurse ne jemi duke bashkëpunuar shumë mirë me ata dhe po i'u ofrojmë mundësitë dhe potencialet tona që kemi edhe pse shpeshherë të kufizuara për çka jeni në dijeni të gjithë.

Kemi pas disa probleme që kanë ndodh në disa objekte të kultit gjatë kësaj periudhe por që janë menaxhuar ato sa herë që është shtruar kërkesa dhe nevoja nga organet e sigurosisë që ne t'iu dalim në ndihmë me potencialet tona që kemi e që konsideroj se ja kemi dal, prandaj besoj se një bashkëpunim i tillë do të vazhdojë dhe jemi në rrugën emirë që të gjitha ato plane të cilat janë të nevojshme dhe emergjente për t'iu bërë, do të bëhen së shpejti.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, i nderuar Kryetar ju e dini se Plani i reagimit emergjent është obligim ligjor dhe ne nuk mund të vijmë atje dhe t'iu themi të gjithëve bëjeni ti, ai, mirëpo ti je Kryetar i Komunës dhe Kryesues i atij Këshilli, ne të drejtohem ty kurse ti pastaj merresh me atë Këshill. Unë parashtrova pyetje, ku janë strehimoret, ku janë pikat e grumbullimit, a kemi plan nëse ndodh diçka, por nuk e thash që do të shpërthejë vullkan sepse nuk jam "baba vanga" dhe nuk e di atë, mirëpo këto merren si paramasa në rast se ndodh ndonjë vërshim, zjarr e të ngjashme. Nuk jam i sigurt 100% por mendoj se Komuna e Podujevës as bark nuk ka, por duhet të improvizohet diçka për të shpëtuar.

z.Qëndrim Softolli, theksoi, këto përgjigjet se çfarë ka ndodh deri tani dhe çfarë ka ndodh me 20 vjeçar, përnjëmend janë konsumuar dhe janë bërë bajate, por nëse juve ju duken të arsyeshme unë jua përsëriti që ti (i drejtohet Kryetarit të Komunës) dhe disa bashkëpunëtor tuaj jeni bashkëfajtor të gjithë atyre punëve të këqija që kanë ndodhë e që po vazhdoj sërish e njëjta.

E keni pushtetin qendrorë, përse nuk po veproni, përse nuk i'u bëni presion dhe t'i zgjedhni të gjitha këto probleme të cilat u diskutuan deri tani.

z.Naim Çunaku, theksoi, poenta kryesore e KKSB-së është plani i veprimit si preventivë për t'u ballafaquar me krizat e mundshme, qofshin ato kriza natyrore qofshin të ndonjë natyre tjetër, dhe po këtu kur kemi pasë vërshimet në foltore e kam ngritur si shqetësim mungesën e planit të veprimit por që atëherë më është thënë se e kemi një plan, (është diku, nuk është diku, e kanë bërë ata, e kanë bërë këta), por nëse ndokush mendon se një Këshill i paraparë ligjërisht të zgjedhet për preventivë për siguri të qytetarëve dhe duke potencuar se do ta bëjmë mirë por në anën tjetër duke u munduar të hudhet faji jo ata jo këta, por kur të ndodh ndonjë fatkeqësi të gjithëve do t'i mundon ndërjegjja e tyre që nuk ka qenë në nivel të detyrës që i'a përcakton ligji.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, meqë nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën, e konstatoi të përfunduar si pikë të rendit të ditës.

2. Raporti i Auditorit të Përgjithshëm për Komunën e Podujevës, për vitin fiskal 2022

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, duke e paraqiti raportin në fjalë, theksoi, Raporti i auditimit të pasqyrave financiare të Komunës për vitin 2022 konstaton se pasqyrat financiare të Komunës së Podujevës prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit publik të cilët aplikohen në Republikën e Kosovës.

Për vitin 2022 Komuna e Podujevës ka një Raport të kualifikuar e që arsyeja kryesore e këtij kualifikimi është si rrjedhojë e kontratës kolektive e nënshkruar në vitin 2017 dhe e cila ka rezultuar në vendime gjyqësore në vlerë 1,882,992.00€ ku arsimtarët dhe sektori i arsimit që punojnë në institucionet arsimore të Komunës së Podujevës i ka realizuar të drejtat e tyre që jua njëh kontrata kolektive pames vendimeve gjyqësore. Vendimet që janë marrë nëpër Gjykatat e Republikës së Kosovës, përkatësisht në Gjykatën Themelore-Dega në Podujevë, janë ekzekutuar nga Thesari i Ministrisë së Financave dhe atë në vlerën e cekur financiare në vitin 2022, ku pjesa dërmuese e këtyre mjeteve buxhetore janë ekzekutuar nga kategoria e pagave, mirëpo në muajin dhjetor 2022 afër 600,000.00€ janë ekzekutuar nga kategoritë tjera të shpenzimeve (nga kategoria e investime kapitale; mallra dhe një pjesë e vogël nga kategoria e subvencioneve) e që kjo ka rezultuar në keq klasifikim në vlerë prej 672,897.00€ gjë që e ka kualifikuar Raportin e Auditorit për vitin 2022.

Vlen të ceket se ne si Komunë e Podujevës e kemi të pamundur që ta rregullojmë këtë çështje e cila lidhet me Kontratën kolektive sepse dihet se edhe buxhetin që e propozon Ekzekutivi i Komunës dhe e miraton Kuvendi i Komunës, propozohet dhe votohet në bazë të Qarkores Buxhetore e cila vie nga ana e Ministrisë së Financave, qarkore e cila ka limitet e saj buxhetore në të gjitha kategoritë, dhe kjo vlerë e madhe financiare që ka rrjedh si detyrim nga Kontrata Kolektive një pjesë e madhe e tyre është mbuluar edhe nga Ministria e Financave e cila ka alokuar mjetet buxhetore në muajt e fundit të vitit 2022 e që po të mos ndodhte ky alokim shtesë nga Ministria e Financave sigurisht se në muajin nëntor dhe dhjetor do të mbeteshim pa paga për punëtorët e sektorit publik të Komunës së Podujevës. Faktikisht me këtë problematikë përballen pjesa dërmuese e Komunave të Kosovës ku disa prej tyre janë ballafaquar më shumë në vitet e

kaluara kurse disa janë ballafaquar në vitin 2022 për shkak të vendimeve gjyqësore ashtu siç janë nxjerrë ato por që sigurisht se do të vazhdoj edhe në vitin 2023 mirëpo deri më tani në vitin 2023 mjetet që janë marrë janë nga kategoria përkatëse.

Përveç kësaj janë edhe disa të gjetura tjera nga Auditori i Përgjithshëm që rezultojnë në raportin e vitit 2022 dhe për këto të gjetura ne si Komunë e kemi përpiluar Planin e veprimit të Raportit të Auditorit për të gjeturat sa i takon llogarive të arkëtueshme ku Komuna e Podujevës ballafaqohet me një numër të madh të obligimeve të cilat qytetarët i kanë në tatimin në pronë, disa edhe nga qiratë që nuk i kanë paguar andaj bëhet fjalë për një vlerë bukur të madhe me mbi 3 milion euro që janë llogari të arkëtueshme.

Gjithashtu janë edhe disa vërejtje të cilat janë teknike dhe që kanë të bëjnë me regjistrimin e pasurive dhe kjo është një problematikë edhe tek Komunitat tjera për arsye të mungesës së një sistemi enkas të regjistrimit të pasurive, problematikë e cila po përcillet edhe në Komunën e Podujevës. Pastaj ka disa vonesa në ekzekutimin e pagesave që vie si rezultat i planifikimit të shpenzimeve mujore dhe si rezultat që Komuna e Podujevës në vitin 2022 nuk e ka pas buxhetin e miratuar në muajin shtator të vitit 2021 e që rrjedhimisht në vitin 2022 kemi hyrë pa buxhet të miratuar të cilin pastaj e kemi miratuar në e kemi miratuar në fund pastaj në fillim të vitit 2022 por që në fund të muajit mars 2022 na është alokuar buxheti nga ana e Ministrisë së Financave dhe kjo ka detektuar edhe tek e gjetura tjetër të zotimet - hyrja në detyrime kontraktuale pa zotimin e duhur të mjeteve, pra edhe kjo është si rezultat i mungesës së buxhetit të rregullt në fillim të vitit 2022.

Para vetës keni Raportin e Auditimit dhe Planin e veprimit për zbatimin e këtyre rekomandimeve.

z.Qëndrim Softolli, theksoi, shpresoj të keni durim dhe t'i dëgjoni deri në fund të gjitha gjetjet e Auditorit të jashtëm për pasqyrat e financiare të Komunës së Podujevës për vitin 2022.

E rëndësishme dhe shumë shqetësuese është opinioni i kualifikuar në këtë raport në të cilin janë gjetur një numër i shkeljeve rreth menaxhimit financiar dhe kontrollit nga Ekzekutivi i Komunës.

Dobësi evidente janë vërejtur në fusha të rëndësishme financiare, si mungesë e zotimeve, mungesë e projektit ekzekutiv, dobësi në pagesa, mos raportim i menaxherëve të kontratave në platformën elektronike të prokurimit publik, e që nuk e di se çfarë keni dashur të fshihni këtu pasi që ju shiteni goxha transparent, pastaj dobësi në menaxhimin e pasurive nën 1000€, vonesa në inkasimin e llogarive të arkëtueshme të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formën e gjetjeve dhe rekomandimeve. Po ashtu procesi i raportimit në Komunë është përcjellë me mangësi e që kjo është vërejtur edhe me rastin e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore të cilat kishin edhe gabime tjera, do të thotë keni gënjyer dhe nuk e keni paraqitur ashtu siç duhet, këtë si shqetësim e kemi ngritur edhe në gjatë diskutimit në Kuvend rreth keq klasifikimit të shpenzimeve, pasuritë dhe shpenzimet janë paraqitur jo sakt dhe jo drejtë në pasqyrat financiare vjetore.

Ky Raport ka rezultuar me 14 rekomandime, 7 prej tyre janë të reja kurse për 7 tjera jeni zotuar në vitin e kaluar që do t'i zbatoni por që nuk e keni bërë një gjë të tillë. Vitin e kaluar keni pasë 12 rekomandime kurse vetëm 5 i keni zbatuar kurse 7 tjera i keni vazhduar me avazin e vjetër.

Po filloj me të parën, çështja B1 - keq klasifikimi i shpenzimeve, pra 672,897.00€ janë shpenzime të cilat ky Ekzekutiv nuk ka ditur t'i klasifikoj dhe parashikoj në buxhet për pagën jubilarë dhe shujtat për arsimtarët (fajtoje janë qeverisjet e kaluara edhe për këtë raport të kualifikuar), pra do të thotë 401,980.00€ janë marrë nga investimet kapitale, 67,809.00€ nga kategoria mallra dhe shërbime, kurse 209,424.00€ janë marrë subvencionet dhe transferet. Po ashtu kemi një pagesë tjetër nga investimet kapitale në vlerë prej 93,584.00€ që për nga natyra i takojnë kategorisë mallra dhe shërbime.

Çështja A1 - realizmi i pagesës pa faturë dhe pa raport të pranimit të punëve, Komuna e Podujevës gjegjësisht Kryetari i Komunës më datë 16 dhjetor 2021 kishte lidhë Marrëveshje Bashkë investimi

me Organizatën Joqeveritare Qatar Charity për ndërtimin e Qendrës së Urgjencës mjekësore në Podujevë në vlerë 1.2 milion euro ku parashihet që Qatar Charity të investoj me 700,000.00€ kurse Komuna e Podujevës me 421,000.00€, ndërsa më vonë më datë 09 gusht 2022 ishte lidhë një Marrëveshje tjetër e këtij projekti duke plotësuar Marrëveshjen e vitit 2021, në vlerë 1.7 milion euro ku specifikohet se procedurat tenderuese do të bëhen me rregullat dhe politikat e brendshme të Qatar Charity, pra 1.1 milion euro Qatar Charity kurse 600,000.00€ participim nga Komuna, Marrëveshje me të cilën parashihet që Komuna këstin e parë të pagesës prej 250,000.00€ ta bëjë me 31 dhjetor 2022, ndërsa Komuna e Podujevës më 29 nëntor 2022 kishte bërë pagesë nga kodi ekonomik Objektet shëndetësore kishte kryer këtë pagesë në shumë 250,000.00€ bazuar vetëm në Marrëveshje bashkë investimi në llogarinë e Qatar Charity pa faturë dhe raport që tregon se punimet janë përfunduar, madje e keni regjistruar si pasuri në përdorim pa i plotësuar kushtet që janë fatura dhe situacioni i punëve të kryera.

Çështja B2 – mos prezantimi i buxhetit final te neni 14.6 pjesa e hyrjes dhe mos shpalosjes së lëvizjeve buxhetore, në nenin 14.6 shpalosja e ndarjeve fillestare dhe finale të buxhetit dhe pasqyrave vjetore financiare Komuna në pjesën hyrëse nuk kishte shpalosur lëvizjet dhe ndryshimet buxhetore të të hyrave vetanake si dhe në pjesën hyrëse tek kolona e buxhetit përfundimtarë në SIMFK për të hyrat vetanake në shumë 1.3 milion euro, huamarrje 180,000.00€, klauzola e investimeve në vlerë 321,000.00€ dhe grandet e donatorëve në shumë 171,000.00€, është e paplotësuar. Krejt kjo ka ndodhur si rezultat i pakujdesisë ose i ka konvnuar kështu zyrtarit kryesor financiar për t'i shpalosur informatat e kërkuara në raportin vjetor financiar. Tani specifikisht e pyes drejtorin e DBF, me çfarë baze ligjore ke marrë mjetet financiare nga projekti i rrugës “Xhemajl Mustafa” dhe “Vëllezërit Frashëri” duke bërë tejkalime ë autorizimeve ligjore pasi që neni 30 i Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, lejon që vetëm 5% e mjeteve buxhetore mund të lëvizin me vendim të Kuvendit, 15% me vendim të Qeverisë, dhe 25% me vendim të Kuvendit të Kosovës, kurse ti na tregon se me çfarë baze ligjore arritët të bëni lëvizje prej 95% të atyre mjeteve buxhetore.

Çështja B3 - mos regjistrimi i pasurisë nën 1000€ në sistemin e E-pasurisë, në vitin 2022 blerjet në vlerë prej 127,209.00€ nuk janë regjistruar në sistemin E-pasuria e që këtu ceket se kjo ka ndodh si rezultat i neglizhencës së zyrtarit që merret me menaxhimin e pasurive nën 1000€ dhe kontrolleve të dobëta që kishte menaxhmenti i Komunës ndaj zyrtarit të pasurisë, Zoti e din çka u ble dhe ku janë shpenzuar gjithë ato mjete financiare.

Çështja A2 – regjistrimi i pasurisë në kategorinë e gabuar, në vitin 2022 pagesat që janë bërë për projektet kapitale edhe pse ishin në ndërtim e sipër nuk janë regjistruar si pasuri nga investimet në vijim por i ka regjistruar si pasuri në përdorim, paramendojeni 3,750.000.00€ është vlera e pagesave që është regjistruar si pasuri në përdorim edhe pse projektet nuk janë përfunduar ende.

Çështja A3 - Komuna nuk kishte konfiskuar sigurimin e tenderit operatorit ekonomik, te projekti ndërtimi i objektit të shkollës në fshatin Obrançë Komuna nuk e ka konfiskuar sigurimin e tenderit edhe pse operatori ekonomik ishte tërhequr, vlera që do të ishte dashur të tërhiqet ishte 12,000.00€, pra Zyra e prokurimit anashkaloj rregullat dhe nuk bëri konfiskimin ku Komuna humbi 12,000.00€ dhe çka paraqet rrezik tjetër është se operatorët ekonomik tjerë të mos i përfillin rregullat edhe në rastet tjera.

Çështja A4 – mos arsyetimi i avansit për udhëtime zyrtare, kemi një rast me shumë 6000€ i cili përnjëmend tregon se jeni goxha të dobët dhe amaterë dhe nuk i dini as gjërat elementare në menaxhimin e financave publike.

Çështja A5 - mungesë e dokumenteve që ndërlidhen me kërkesat e përshtatshmërisë në platformën e prokurimit publik, këtu thuhet që dokumentet e kërkuara sipas kërkesave të përshtatshmërisë për

përfituesin e kontratës siç janë vërtetimi nga Gjykata kompetente dhe vërtetimi i ATK-së nuk ishin vendosur në platformën elektronike të E-prokurimit, rast i vërejtur është te kontrata me vlerë rreth 200,000.00€ Furnizim me Mëshqerra.

Çështja A5 - mungesa e projekte ekzekutuese, kjo mendoj s është interesante sepse paramendojeni Komuna e Podujevës kishte filluar procedurat e prokurimit dhe kishte lidhë kontratë pa hartuar projekt ekzekutiv për ndërtimin e shkollës në fshatin Obrançë, projekt ky me një shumë rreth 500,000.00€, si dhe ndërtimi i sallës së edukatës fizike në shkollën “Enver Maloku” në vlerë mbi 215,000.00€, qysh i jepni kontratë një operatori ekonomik pa pasur projekt ekzekutues, nuk ka logjikë kjo dhe nuk e di si mund ta arsyetoni këtë, ose jeni shumë të dobët ose lakmia për të vjedhur edhe në projekte të shkollave.

Menaxhimi i kontratave jo përmes platformës E-prokurimi, Komuna e Podujevës menaxhimin e kontratave dhe vlerësimin e performancës së kontraktuesve asnjë nuk i ka mbajtur të arkivuara përmes sistemit elektronik të prokurimit publik.

Çështja A7 - iniciimi i projekteve pa zotim të mjaftueshëm të mjeteve buxhetore, furnizimi me kabinete të shkencave natyrore me vlerë të kontratës 168,250.00€ kurse të zotuarra kanë qenë vetëm rreth 23,000.00€; pastaj largimi i deponive ilegale vlera e kontratës 45,000.00€ kurse zotimi ishte 10,757.00€; intervenimi për raste emergjente për rastet e vërshimeve vlera e kontratës 36,225.00€ kurse zotimi ishte 28,000.00€, pra jeni duke punuar me logjiken “hajt se i qon Zoti”, pa pasë mjete keni bërë zotime dhe shpenzimet i keni tejkalluar shumëfish.

Çështja B5 - vonesa në kryerjen e obligimeve të papaguara, në 4 raste me një vlerë 199,000.00€; 190,619.00€ komuna nuk kishte kryer obligimet financiare brenda afatit prej 30 ditëve dhe vonesat ishin deri në 70 ditë nga data e pranimin të faturës, kjo ndodh për shkak se Komuna nuk ka pasuar mjete të mjaftueshme financiare dhe ka hyrë në obligime pa ndonjë analizë të mirëfilltë buxhetore.

z.Haki Rudari, theksoi, Auditimi i jashtëm është një kontroll i pavarur i pasqyrave financiare të një entiteti qëllimi i të cilit është dhënia e një opinionit se si janë pasqyrat financiare dhe a janë në një vijë me aspektet ligjore. Për të kryer një auditim konsideroj se duhet pasur për bazë disa parime, 1-ligjshmërinë apo aspektin ligjor; 2-integritenin apo aspektin profesional; 3-paanësinë; 4-fshehtësinë profesionale dhe vetëm në raste specifike nëse kërkohet me ligj; 5-kompetencat dhe 6-pavarësinë. Pra auditimi duhet t’i ketë këto parime në mënyrë që të jetë një auditim ashtu si duhet. Në rast se shkojmë te aludimit i cili na ka ardhë unë do të lexoj nga auditimi që e kemi të gjithë kolegët, Auditimi i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore, po citoj, ne kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Podujevës të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave me para të gatshme në të gjitha sektorët, pastaj cili është opinionit i tyre, citoj sërish, sipas opinionit tonë përveç ndikimit të çështjeve të përshkruara në paragrafin për bazën për opinion, do të thotë përveç ndikimit për bazën në opinion që është i kualifikuar, sërish po citoj, pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Podujevës prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit në sektorin publik. Pjesa tjetër e po këtij Raporti, unë nuk u ndala te baza për opinion sepse është sikurse është kështu, konkluzioni për pajtueshmërinë thuhet, ne kemi audituar nëse proceset e transaksionit përcjellëse janë në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit, përgjigja e po këtij auditimi citoj, sipas mendimit tonë përveç ndikimit të çështjeve të përcaktuara tek baza për konkluzion transaksionet e kryera në proceset e ekzekutimit të buxhetit të Komunës së Podujevës kanë qenë në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit, pra unë jam duke e lexuar këtë raporte që unë e kam para vetës.

Sa i përket rekomandimeve që u tha se janë 7 të reja, unë do të ndalem vetëm te rekomandimi i parë i cili vërtetë po i’u sjellë probleme të gjitha Komunave mirëpo Kontrata Kolektive është

nënshkruar më 17 prill 2017 që i bie se para një kohe të gjatë është nënshkruar ajo kontratë dhe natyrisht ata që e kanë nënshkruar këtë Kontratë në atë kohë vetëm e kanë nënshkruar dhe më nuk janë marrë fare me menaxhimin dhe implementimin e asaj Kontrate dhe është e vërtetë se një pjesë e madhe e Komunave po kanë probleme në këtë drejtim, kështu ka pasë edhe Komuna e Podujevës me ish pushtetin e LDK-së, këto probleme tani po na përcjellin edhe neve por që kjo sigurisht se diku do ta ketë një përfundim. Keq klasifikim i shpenzimeve thuhet se ka ndodh për shkak të Kontratës Kolektive të nënshkruar nga Niveli qendrorë ngase Ministria e Financave në Qarkoren Buxhetore bazë e së cilës ishte edhe Raporti, thjesht këto mjete tani mësimdhënësit po i marrin përmes proceduarve gjyqësore, sigurisht se nuk do të ishte mirë kështu sepse po dëmtohem edhe ne si mësimdhënës por edhe Komunitat, por problemi më i madh për mua ka qenë nënshkrimi i Kontratës Kolektive më 17 prill 2017 nënshkrimi i cili është bërë në atë kohë vetëm për poteza dhe poena politik, dhe më tutje nuk janë marrë fare me atë se çfarë do të bëhet, dhe nuk është kjo vetëm në Komunën tonë por është problem në të gjitha Komunitat pavarësisht kush e udhëheqë dhe kush e ka nën kontroll, prandaj këto probleme të mos i harrojmë sepse nuk datojnë vetëm në vitin 2022 apo 2023 por vijnë nga viti 2017 dhe janë probleme të cilat sigurisht se do të ishte mirë të përfundojnë, madje unë pajtohem se edhe kjo qeverisje që është tani është dashtë ta përfundoj këtë çështje në njëfarë formë.

z.Bashkim Sylja, theksoi, raporti i auditimit për vitin 2022 ka dhënë 14 rekomandime për qeverisjen komunale. Keq klasifikim i shpenzimeve në kategori të ndryshme, gjë për të cilën e potencuan edhe parafolësit se ka ndodh për shkak të Kontratës Kolektive andaj për këtë çështje kam pyetje se a është afër të përfundoj ky proces sepse është rekomandim i cili po na përsëritet disa vite rresht.

Rekomandimi i dytë ka të bëjë me atë ku thuhet se Komuna ka bërë pagesa pa faturë dhe pa raport të pranimit të punëve, fjala është për një Marrëveshje e lidhur me Kryetarit të Komunës dhe Organizatës Qatar Charity për ndërtimin e emergjencës së qytetit, Marrëveshje e cila është plotësuar më vonë e që këtu Auditori ka gjetë shkelje. Mandej kemi të gjeturën tjetër ku thuhet se në raportet financiare nuk janë pasqyruar lëvizjet buxhetore dhe buxheti final sipas kërkesës dhe Rregullores përkatëse që rregullon këtë çështje, mirëpo është marrë një praktikë e viteve të kaluara por që besoj se viteve të ardhshme nuk do të ndodh. Kemi çështjen tjetër ku thuhet mos regjistrimi i pasurisë nën 1000€, por që arsyetimi i Komunës ka qenë që kjo është bërë për arsye teknike dhe rekomandimi e konteston edhe raportin vjetor financiar që nuk është i saktë sa i përket pasurive nën 1000€. Mos ngarkimi i dokumenteve në platformën Elektronik e-prokurimi publik; mos pagesa e obligimeve brenda afatit ligjor që është 30 ditë; Mos konfiskimi i sigurimit të tenderit operatorit ekonomik, çështje e cila ka ndodh për shkak të projektit të shkollës në fshatin Obrançë; Pagesat për projektet kapitale të regjistruara si pasuri në përdorim e jo si pasuri që janë pasuri investive kapitale; Mos arsyetim i avansit në udhëtime zyrtare; Projekti i shkollës së fshatit Obrançë është marrë si projekt ai i shkollës së fshatit Balloc, do të thotë ka pasë mungesë të projekteve ekzistuese: inicimi i projekteve pa zotim të mjeteve.

Në vitin 2021 auditori ka dhënë 12 rekomandime prej të cilave 5 prej tyre janë zbatuar kurse 7 rekomandime nuk janë zbatuar, ndërsa për vitin 2022 kemi edhe 7 rekomandime tjera e që gjithsej janë 14 rekomandime andaj është mirë që Ekzekutivi i Komunës t'i merr më seriozisht këto rekomandime, dhe shpresoj që në raportin e vitit 2023 të jetë me më pak rekomandime të Auditorit.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, më bëri përshtypje fjalimi i shefit të Grupit të LVV-së, arsimtari im i nderuar Haki Rudari, e që ka pas raste që i kam dëgjuar herëve tjera kur ka qenë në opozitë ku edhe pse Raporti i Auditimit nuk ka qenë kështu i zi e i keq, ka pas shumë kritika ndaj atyre raporteve kurse tani u munda ta zbutë këtë duke e përmendur një pikë e gjysmë, kurse në këtë

Raport 14 rekomandime janë të këtij viti dhe 7 të vitit të kaluar e që nuk i përmendi asnjë prej tyre, por që unë në vazhdim do t'i përmend 5-6 prej tyre dhe më shumë po ndalem rreth prokurimit publik çfarë ka ndodh sepse ndoshta z.Haki Rudari nuk e lexuar por që tani mund ta merr vesh.

Komuna nuk e kishte konfiskuar sigurimin e tenderit të operatorit ekonomik, në procedurat e prokurimit publik te projekti i objektit të shkollës në fshatin Obrançë, andaj meqë zotëri Rudari nuk e kritikoj këtë nëse ka mundësi të më tregoj ai konfiskim siguri i tenderit 12,000.00€ kush e lejoj t'i tërheqë ato mjete ngase normale është që kur bëhet siguri i tenderit nuk mund të tërhiqet deri sa të përfundoj puna, pra qysh munda t'i tërheqë ato mjete, kush i ka tërheqë dhe kush e lejoj dhe ku shkuan ato mjete, u ndanë përgjysmë apo çka është bërë me ato mjete.

Po dëshiroj të diskutoj me z.Haki Rudarin sepse disi është i zëshëm dhe ka shpirt opozitari por që disi në fjalimin paraprak të tij “e lëmoj e lëmoj” në vend që të thoshte që ky është Raporti më i keq ndonjëherë pas luftës për Komunën e Podujevës, e them këtë sepse është hera e dytë që nga vitit 2000 që Auditori sjellë Raport të tillë, andaj nuk bash ashtu siç e bëri ky (Haki Rudari)

Çështja tjetër, mungesë e dokumenteve që ndërliken me kërkesat e përshtatshmërisë në platformën elektronike të prokurimit publik, shembull, i nderuar Haki Rudari, ka ndodh që Drejtorja përkatëse i ka dhënë subvencion një kompanie që është militant i juaji dhe nuk i ka kërkuar dokumentet e ATK-së dhe në atë moment që Komuna i ka ekzekutuar paratë atij personi Thesari i Kosovës i'a ka marrë ato sepse ai person ka pas borxh ATK-së, për këtë arsye është si gjetje, madje do të del sërish si gjetje sepse sërish i njëjti gabim është bërë.

Pika tjetër, mungesë e projekteve ekzistuese, do të thotë 497,715.00€ për ndërtimin e shkollës në fshatin Obrançë si dhe ndërtimi i sallës në shkollën “Enver Maloku”, gjithsej 713,203.00€ pa projekt fare.

Regjistrat e menaxhimit të kontratave jo përmes platformës elektronike e-prokurimi, do të thotë kjo platforma e prokurimit është digjitalizuar bukur moti kurse ju nuk e praktikoni këtë dhe nuk i futni fare dokumentet në këtë platformë.

Mandej kemi pikën, inicimi i projekteve pa zotim të mjaftueshëm të mjeteve financiare, u përmend edhe nga kolegu zotëri Softolli, shembull furnizimi me kabinate të shkencave natyrore janë zotuar 22,994.00€ kurse janë shpenzuar 168,250.00€, pastaj ishte largimi i deponive ilegale ku vlera e kontratës 45,000.00€ kurse të zotuara janë 10,757.00€.

Pastaj, vonesa në kryerjen e obligimeve të papaguara, shembull në këtë çështje operatorëve kur i kanë kryer punët ju kanë vonuar pagesat deri në 70 ditë, kurse ka thirrje publike, madje hiç më larg se mbrëmë është mbajtur aktivitet në sheshin e qytetit nga dikush që paratë i ka marrë prej Komunës qe 2 muaj, pra njëherë i ka marrë paratë kurse dje e ka mbajtur aktivitetin, është një person që ka barnatore, është militantë i juaji dhe nuk e ka harxhuar asnjë cent por mjetet ja keni ekzekutuar avans 1500€ për ta mbajtur një aktivitet të trashëgimisë ku janë qitë disa plisa aty ndërsa ai person është farmacist dhe nuk ka lidhje të bëjë me atë punë asgjë, prandaj për këtë arsye gjen gjetje auditori sepse dikujt t'i vonohet pagesa 70 ditë pasi që e ka kryer punës, kurse dikujt i pranohet puna pa raport të punës (pa e ditë a do të jetë gjallë ai person pas dy muajve dhe a do të mund ta realizoj aktivitetin apo jo, ndërsa ju ja jepni paratë.

z.Haki Rudari, theksoi, falënderoj parafolësin ish nxënës i imi, por të më tregoj ai vetëm diçka që unë e thash e që nuk është në opinion të Raportit, ma gjeni vetëm një. Të gjitha ato që unë i thash, kushdo që dëshironi nga Grupi i LDK-së më tregoni nëse nuk janë në Raport të auditimit.

Po e përsërisë, unë edhe në të kaluarën por edhe tani asgjë nuk kam fole asgjë që nuk është në raportin e auditimit, kështu siç është, madje unë e potencova bazën për opinion nëse veç e ka përcjellë diskutimin tim zotëri Rrahmani nëse jo është diçka tjetër pastaj.

Çështja tjetër, unë përmenda kriteret që duhet të ketë një auditim, dhe këto që i ceka janë në Raport të auditimit, bazën për opinion nuk e thash që nuk është ashtu sepse nuk mund ta heq askush, por në të njëjtën kohë e dhash mendimin po ashtu të raportit të auditimit, nuk e shpika unë dhe nuk e thash si definicion në vete. Nëse dëshironi unë mund ta përsërisë atë, por vetë dua të kursej kohë. Pra të gjitha çka i tha shefi i Grupit të LVV janë në Raport të auditimit, këtë raport nuk mund ta heqim, i ftohtë apo i nxehtë, i mirë i keq, ky që është.

Unë edhe në të kaluarën kam kritikuar, edhe në atë kohë ka pasë shumë theksim të çështjeve të cilat sërish janë tani në këtë raport, pra në Raport janë dhe unë si shef nuk mund t'i largoj, mirëpo për të gjitha ato që i thash, ma gjeni vetëm një që nuk është në Raport, unë kërkoj falje pastaj.

znj. Arnisa Sylejmani, theksoi, te Raporti i Auditori dua të ndërlihem te çështja B7 ku kemi dobësi në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme.

Sipas nenit 26 të Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme 06/L-005, Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbarese kanë kompetenca t'i mbledhin detyrimet tatimore të papaguara të cilat kalojnë shumë 10€. Në nenin 27 të ligjit të cekur thuhet që nëse një tatimpagues nuk ka paguar plotësisht detyrimet tatimore në afatet e caktuara atëherë detyrë e Komunës është njoftimi përfundimtarë ku kërkon pagesën e plotë, do të thotë që Komuna në vitin 2022 nuk ishte menaxhim efektiv dhe nuk ka marrë asnjë veprim konkret për t'i inkasuar këto tatime të cilat nuk janë paguar.

Mos arkëtimi me kohë i të hyrave vetanake ndikon në nivelin e fondeve të mbledhura në buxhetin komunal dhe reflekton negativisht në financimin dhe realizmin e projekteve.

z.Arjant Topanica, theksoi, po ndërlihem me arsyetimin e drejtorit të DBF që me gjithë këto gjetje dhe gjithë këtë Raport si të tillë ai e vendosi theksin tek Kontrata Kolektive e që ajo është vetëm njëra prej arsyeve sepse ka shumë pika tjera më të rëndësishme dhe gjetje e shkelje tjera që e nxjerrin këtë raport si të pakualifikuar. Po vazhdoj edhe me shefin e Grupit të LVV-së për çka edhe unë njëjtë sikurse kolegu z.Ekrem Rrahmani deshta t'i them se e bëri elaborimin mjaftë mirë vetëm nga aspekti teknik duke potencuar se përmban atë, këtë dhe pastaj duke u mbështetur në atë se, asgjë nuk e thash çka nuk është në këtë Raport, as ne nuk po themi që nuk është por ai e lexoj vetëm një pikë e gjysmë, kurse pjesa tjetër Raportit me gjetjet që figurojnë pamë shkeljet tjera, pra kolegu z.Haki Rudari e bëri arsyetimin sikur të thuhet “operacioni pati sukses por pacienti vdiq”. Kjo është jo serioze, është qesharake dhe jo etike se si po mundohet të na hedh hirin syve për një Raport për të cilin u lexuan 10 minuta shkelje, madje nuk janë përmenden të gjitha, kurse na thoni që është i mirë dhe vetëm për shkak të Kontratës Kolektive.

Unë dëshiroj të cekë sërish çështjen e sigurimit të tenderit sepse drejtori i Drejtorisë përkatëse në pikun e debatit nuk ishte brenda në sallë, pra kemi kthim të sigurimit të tenderit në shumë 12,000.00€ kompanisë, pa përfunduar tenderi, kjo është shkelje e ligjit dhe do të doja ta di me çfarë arsytimi janë kthyer këto mjete apo qysh janë ndarë këto mjete nëse veç janë ndarë.

Kemi lidhje të kontratave pa zotim të mjeteve e që edhe kjo është gjetje dhe shkelje flagrante e ligjit, qysh bënë kontratë me një kompani apo operator ekonomik kur nuk ke të zotuar mjetet buxhetore për të kryer atë punë, ku mendon se do t'i marrësh dhe mbi cilën bazë do të ndash mjetet për atë kontratë.

Sa i përket bartjes së mjeteve, ne disa kemi dhënë kritika se si është e mundur të bëhet bartje e mjeteve buxhetore nga projekti në projekt deri 95%, kurse në anën tjetër na thuhet se ky raport është i mirë dhe ka pika pozitive, pra kemi shkelje të ligjit sepse vetëm 5% e mjeteve mund të barten me miratim të këtij Kuvendi kurse as në Kuvend nuk janë përmend këto bartje as për 5% ndërsa në realitet janë bërë bartje deri në 95% të mjeteve buxhetore prej projekti në projekt.

z.Naim Çunaku, theksoi, të flasësh për shpenzimin e buxhetit të një vitit fiskal, ne e kemi pasë raportin vjetor financiar dhe kemi debatuar këtu në këtë Kuvend mirëpo nga përbërja e Kuvendit, varësisht prej ngjyimeve politike ka dashtë t'i jepet drejtim që ato të gjetura që ne i kemi përmendur janë shkaku i dallimeve politike, por kur sot kemi para vetës Raportin e Auditimit të jashtëm që të paktën besojmë apo ish dashtë të mos ketë ngjyrim politik sepse është i pavarur, të gjeturat e këtij raporti mua më duken shqetësim sepse nuk mund t'i konsideroj ndryshe.

Një numër të mirë të këtyre të gjeturave në këtë Raport të auditimit, për hir të vërtetës gjatë gjithë mandatit i kemi potencuar dhe kemi apeluar që të mos ndodhin, por arroganca e numrave dhe duke thënë se gjithçka çka ka qenë përpara ka qenë mbrapsht e kur të vijmë ne bëhet mirë, tani ky Raport atë të mirë e ka vë në shesh se si ka ndodh.

Po nisemi prej një elementi, Auditori merre vetëm disa mostra nga shpenzimi i një viti buxhetor dhe në gjithë këto mostra që i merr për ta dhënë opinionin e tij, nuk na doli asnjë pa defekte, llogariteni dhe paramendojeni po të ishte thelluar aktiviteti i shpenzimit të gjithë shpenzimi i buxhetit, edhe sa faqe do t'i shtoheshin këtij Raporti me të gjetura.

U përmend dhe duhet të përmendet anashkalimi i këtij Kuvendi, disa po kujtojnë që Kuvendi i Komunës është ai që mund të bëhet shaka me të dhe nuk e din abc-në e demokracisë që projektbuxheti dhe ato projekte miratohen prej neve si Kuvend që jemi përfaqësues të qytetarëve dhe detyrë e Ekzekutivit është që ta ekzekutoj atë buxhet konform asaj që ne kemi marrë vendim, ndërsa për çdo ditë mund të shohim në ueb faqen e Komunës lajme duke thënë se NN Drejtorja ka ndarë kaq mjete buxhetore për..., mashtrim me opinionin sepse nuk ndan mjete buxhetore Drejtorja por ekzekuton projektet e miratuara nga ky Kuvend.

Për fund, nuk dëshiroj të përsërisë asgjë sepse vërtetë u tha shumë për këtë raport deri tani, por vërtetë nuk më bënë të ndihem mirë një menaxhim i parasë së qytetarit në këtë formë siç është bërë dhe po përmend vetëm dy elemente të cilat i kam përmend kur ka qenë koha, kur kemi pasë rialokimin e mjeteve buxhetore nga rr. "Vëllezërit Frashëri" mbi 750,000.00€, shto kësaj edhe për rr. "Xhemajl Mustafa" 1 milion euro, vetëm këto dy të gjetura do ta bënin këtë raport të kualifikuar, e jo siç po tentohet këtu të hudhet faji te Kontrata Kolektive e cila është nënshkruar prej dikujt tjetër për çka kam bindjen se shumë prej punëtorëve të arsimit, shëndetësisë dhe shërbimit civil ju kanë gëzuar asaj Kontrate Kolektive sepse ka ndikuar drejtpërdrejt në mirëqenien e tyre, kurse të ndryshosh sot pozicion vetëm pse je në pozitë tjetër vërtetë për mendimin tim është përtej qesharakes.

Një prej kolegëve parafolës e tha shpresoj se vitin e ardhshëm të kem rekomandime më pak, por nëse prej 12 rekomandimeve vetëm 5 janë marrë parasysh ky Ekzekutiv dhe ka punuar në ato e që po e shohim qysh ka punuar, kurse 7 rekomandime nuk i ka prekë fare, andaj nëse kjo është ajo që shihet dhe vazhdon kështu mjerisht edhe në vitin e ardhshëm do të jemi kështu.

Po e përsërisë që vërtetë nuk ndihem mirë, edhe pse për hatër të politikës mund të ketë si kjo, mirëpo të menaxhosh paranë publike në kundërshtim me ligjin vërtetë dikush duhet të jap llogari.

z.Valon Demolli, theksoi, u përmend disa herë nga kolegët z.Qendrim Softolli dhe nga z.Bashkim Sylja çështja e theksuar në pikën A1. Kjo pagesa pa faturë dhe pa raport qysh është e mundur të bëhet pagesë në emër të një Organizate në shumë 250,000.00€ pa faturë dhe pa raport të kryerjes së punëve, shkelje kjo e cila figuron në Raportin e Auditorit tregon se si e trajtoni ju paranë publike të qytetarit Llapjan.

Ky është keqpërdorim i qartë dhe shkelje flagrante e ligjit për të cilën nuk do të kaloj pa përgjegjësi pasi ne jemi në finalizim të kallëzimit penal për këto çështje, andaj i bëjë thirrje hetuesisë të hetoj këto keqpërdorime në këtë Raport skandaloz.

z.Ragip Fetahu, theksoi, para vetës kemi Raportin e Auditori i cili bënë këto të gjetura, mirëpo ajo që unë nuk po kuptoj është që pse po ekzagjerohen të gjeturat e këtij Raporti ngase të gjeturat e këtij raporti nuk pasqyrojnë probleme korruptive në asnjë pikë, në asnjë vend dhe në asnjë rrethanë të Drejtorive përkatëse apo të Ekzekutivit në përgjithësi. Të gjeturat e këtij Raporti janë mangësi teknike të cilat janë bërë si lëshime nga pakujdesia e punëtorëve të Drejtorive të caktuara dhe këto të gjetura mund të eliminohen me shumë pak punë dhe angazhim në të ardhmen. Pra nuk kemi keqpërdorim të parasë publike, tërheqja e parave nga një projekt dhe dërgimi në një projekt tjetër nuk është krim dhe korrupsion, është thjesht për interes të qytetarëve, do të thotë thjesht ndiqen prioritetet dhe interesat e qytetarëve asgjë më shumë.

Andaj po e vërej këtu se asgjë më shumë ky Raport është duke u tej ekzagjeruar, është duke u përdorur politikisht, është duke u humbur kohë me gjëra të cilat nuk janë kushedi sa për t'i bërë në këtë formë.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, kolegut parafolës i'u duk si ekzagjerim por nuk është ekzagjerim sepse askush nuk e tha asnjë fjalë më shumë se sa që shkruan në raport, madje unë po çuditëm me kolegun qysh ai pe din a ka apo nuk ka korrupsion. Unë e ceka diçka që ndoshta kolegu se ka dëgjuar dhe po e përsëris sërish, kompania e cila ka fituar tenderin për ndërtimin e shkollës në fshatin Obrançë, e ka bërë sigurimin e tenderit në shumë 12,000.00€, është tërheqë duke e tërhequr edhe sigurimin e tenderit, sigurimi i tenderit ligjërisht humb nëse tërhiqet ndonjë kompani nga tenderi, andaj meqë kolegu parafolës e din që nuk është vjedh, e pyes atë ku ka shkuar kjo shumë prej 12,000.00€. unë nuk e thash as që është vjedhë e as që nuk është vjedh, thjesht bëra pyetje kush ka lejuar të tërhiqet ato mjete në shumë 12,000.00€.

kolegu parafolës po thotë që nuk është vjedhur, unë nuk e di a është vjedhur apo jo, madje pati edhe shumë çështje tjera që u diskutuan dhe nuk u ekzagjeruar asgjë nga ne të cilët i përmendëm vetëm nga 3-4 pika kurse të gjitha pothuajse i përmendi vetëm kolegu z.Qëndrim Softolli.

Me vjedh nuk është krim, por vetëm bëhesh i pasur, mirëpo është shkelje e ligjit, prandaj askush nuk e tha se është bërë krim sepse askush askënd nuk e ka mbytur, por kanë vjedhur.

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, theksoi, falënderoj të gjithë për diskutimet dhe do të përpiqem t'i u përgjigjem me sqarime të gjithëve në mënyrë të përmbledhur edhe pse disa çështja u përsëriten nga disa diskutues. Nëse ndalemi te Raporti i Auditorit tek çështja e kualifikimit që është më kryesorja, e vërteta është se ka ndodh për shkak të keq klasifikimit, edhe në bazë të të gjeturave të Auditorit është se ky ke klasifikim ka ndodh si rezultat i Kontratës Kolektive dhe disa keq klasifikime që janë në masë të vogël dhe për ato nuk do të ishte i kualifikuar ky Raport. Kontrata Kolektive natyrisht që ndërlihet edhe me planifikimin buxhetor, përveç që ne i kemi limitet buxhetore në kategorinë e pagave ne e kemi edhe teknikisht të pamundur të ekzekutojmë paga sepse të gjithë e dimë që sektori publik pagat i merr përmes listës së pagave që ekzekutohet nga Thesari përmes asaj liste që e nënshkruajmë të gjithë dhe ato mjete dalin në llogari të secilit që paguhemi nga sektori publik, pra nuk ka të bëjë në fakt që ka rezultuar nga ndonjë veprim apo mos veprim i jon sepse nuk kemi mundësi të veprimë ne në këtë çështje.

E vërtetë është që janë marrë 1,800,000.00€ nga Kontrata Kolektive mirëpo pjesa dërmuese ashtu siç e ceka janë marrë nga kategoria e pagave, dhe në fund të vitit konkretisht në tremujorin e fundit të vitit Qeveri e Republikës së Kosovës për të gjitha Komunat e Kosovës ka ndarë mjete shtesë në kategorinë e pagave ngase mos ndarja e atyre mjeteve shtesë dhe mos marrja e këtyre mjeteve nga kategoria e kapitaleve do të rezultonte se në muajt nëntor dhe dhjetor sektori publik në Komunën e Podujevës ku janë 2009 të punësuar nuk do të kishte paga sepse do të rezultonte me mungesë të buxhetit.

Sa i përket çështjes së cekur nga disa prej parafolësve që është si e gjetur në Raportin e auditimit e që ne edhe në planin e veprimit e kemi cekë dhe se faktikisht në arsyetimet tona nuk e kemi pranuar si të gjetur, ka të bëjë me një pagesë në shumë 250,000.00€ për Organizatën Qatar Charity, e vërteta është se nuk e kemi dhënë asnjë cent për këtë Organizatë por ata i kanë dhënë 1.1 milion euro për neve, dhe ai objekt i cili është duke u ndërtuar urgjencë në afërsi të rreth rrotullimit tek rrethi i shqiponjës apo te ish Hotel Besiana, pjesa dërmuese e atij projekti është donacion. Në bazë të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ne jemi të obliguar që në disa faza në bazë të periudhave kohore ti paguajmë 600,000.00€ ndërsa donatori jep 1.1 milion euro dhe ky donatorë shumë i respektuar nga ana jonë, për Komunën e Podujevës në këto dy vitet e fundit por edhe në të kaluarën ka ndihmuar shumë qytetarët e Komunës së Podujevës dhe Komunën e Podujevës, pra vlen të ceket se vetëm këto dy financimi dhe ndihmat ndaj projekteve të Komunës nga kjo Organizatë e tejkalon shumë 2 milion euro, kemi me qindra familje të cilave ju janë hapë puse/bunarë në bashkëfinancim me Komunën e Podujevës ku ne vetëm me një përqindje të vogël 10% marrim pjesë, pastaj me një Marrëveshje tjetër është ndërtuar edhe objekti shëndetësor në fshatin Gllamnik dhe disa projekte të vogla në fushën e subvencioneve të bujqësisë dhe projekte të tjera humanitare. Ne i dimë këto praktika ku të gjitha Komunitat të cilat kanë donatorë ka vetëm një mundësi dhe vetëm një rrugë që është lidhja e Marrëveshjeve në mes Zyrtarit Kryesor Administrativ të asaj Organizate buxhetore dhe donatorit, nganjëherë merret si OJQ mirëpo ai është donator i Komunës së Podujevës, ka një projekt ku fatmirësisht tani ka përfunduar pjesa e ndërtimit të vrazhdë, ka elemente tjera të brendshme si instalime, vendosje e dritareve dhe gjitha elementet tjera dhe brenda vitit objekti finalizohet edhe me pajisjet mjekësore dhe me inventarizim ku po them se është donacion prej 1.1 milion euro nga Organizata Qatar Charity.

Elemente tjera të cilat janë të gjetura të Auditori dhe ndoshta diçka që duhet të ceket si kryefjalë e këtij Raporti, e vërteta është se nga veprimet tona nuk ka rezultuar asnjë humbje financiare në Komunën e Podujevës, bëhet fjalë për një çështje që nuk dëshiroj ta bëjë debat sepse është e përmirësueshme por që lidhet me Kuvendin e Komunës por nuk është me rëndësi sepse përmirësohet, por me një fjalë nuk ka asnjë humbje tjetër buxhetore.

U fol këtu nga disa parafolës anëtar të Kuvendit mungesa e projekteve ekzekutuese për shkollën e fshatit Obrançë dhe për shkollën “Enver Maloku”, edhe në planin e veprimit që ju është përcjellë juve si Kuvend është e cekur nuk është ashtu siç u tha se është bërë pa projekt dhe nuk është ditur se çfarë po paguhet ose çka po ndërtohet, por projekti i shkollës së fshatit Obrançë është projekt i cili është marrë nga projekti të cilin Komuna e Podujevës e ka pasë në pronësi e që është ai i ndërtimit të shkollës në fshatin Balloc, krejt kjo për shkak të proceduarve më të shpejta për të shkuar me ndërtim, ka qenë një projekt i cili kur është implementuar është konsideruar funksional dhe i mirë andaj nga Drejtoria e Arsimit është vendosur të shkohet me atë projekt edhe në fshatin Obrançë, dhe kjo jo që rezulton në humbje financiare qysh mund të thuhet, por faktikisht kjo rezulton në kursim financiar sepse po të bëhet një projekt i ri minimalisht duhet të paguhet rreth 10,000.00€ ngase kompania fituese që përgatit projektin sigurisht që duhet paguar për atë shërbim që e bënë ndaj Komunës së Podujevës.

Sa i përket regjistrimit të pasurive e vërteta është se edhe ne si Komunë në mënyrë të vazhdueshme me vite të tëra ballafaqohemi me të gjeturat e auditorit që kanë të bëjnë me regjistrimin e pasurisë qoftë ato nën 1000€ qoftë ato me mungesën e funksionalitetit të shpeshtë të programit që merret për regjistrimin e pasurive por edhe për shkak të mungesës së shpeshtë të resurseve njerëzore por edhe për shkak se Ministria përkatëse shpesh nuk ka lejuar që këto regjistrime të bëhen edhe drejtpërsëdrejti në institucionet të cilat i përdorin ato mallra që janë institucionet arsimore e që ka rezultuar me të gjetura që kanë të bëjnë me disa mangësi, por në mungesë të regjistrimit, ta zëmë

disa materiale të shkollave shembull ditarët e klasave nëpër shkolla që kanë shkuar dhe nuk janë regjistruar, por ditarët janë në shkolla dhe për tu kryer një pagesë nevojitet raporti i pranimit nga ana e komisionit / menaxherët e kontratës, flet dërgesat të cilat i nënshkruajnë drejtorët e shkollave, andaj po e them se nuk ka kurrfarë shkeljeje në këtë aspekt por që normalisht rezultoni si e gjetur mungesë e regjistrimit të pasurive.

U përmend vonesa e pagesës së faturave, Auditori ka mundësi që përmes sistemit të evidentoj çdo vonesë të pagesave, jo vetëm në bazë të mostrave të marra, për arsye se në sistemin free balance në momentin që bëhet shpenzimi figuron edhe data e protokollit të faturës se kur është sjellë, dhe Auditori për një kohë shumë të shkurtër mund t'i verifikoj të gjitha pagesat e rrjedhimisht edhe vonesat që kanë ndodh, kurse prej mijërave pagesave që bënë Komuna e Podujevës ka rezultuar me 4 vonese, do të thotë se dëshira jonë ishte që të mos ketë asnjë vonesë mirëpo nëse e marrim si mesatare faturat të cilat vijnë për pagesë në DBF kryhen brenda 7-8 dite mesatarisht ndërkohë që afati ligjor për kryerjen e një pagese është 30 ditë, por që edhe këto kanë ndodh për shkak të mos kompletimit të dokumentacionit i cili shkon tek njësia kërkuese bëhet kompletimi i lëndës dhe që në disa raste ka ndodhur vonesë.

U cekë çështja e llogarive të arkëtueshme, faktikisht është mirë të sqarohet kjo çështje edhe për opinionin publik se ka të bëjë me obligimet të cilat qytetarët i kanë për tatim në pronë, për qiratë si dhe për disa obligime tjera ndaj Komunës dhe tani nëse i marrim këto vitet e fundit, të hyrat nga tatimi në pronë në bazë edhe të raportit financiar që e kemi për diskutim në pikën vijuese në këtë mbledhje, janë më shumë se të dyfishuara mirëpo sërish meqë janë miliona euro të grumbulluara si borje / obligime të qytetarëve ndaj Komunës së Podujevës sërish kjo vlerë e të hyrave vetanake edhe përkundër që është rritë nuk ka rezultuar në zvogëlimin e duhur të llogarive të arkëtueshme dhe ato obligime vazhdojnë të mbeten, çështje për të cilën u tha nga dikush që përse nuk kemi vepruar me përmbarrim ashtu siç e parasheh ligji, mirëpo deri në ndryshimin e ligjit për përmbarrim që ka ndodh tani së fundmi në Kuvendin e Republikës së Kosovës, ka qenë ekstrem i papërshtatshëm që të zbatohet ai ligj. E them këtë sepse do të rezultonte që mijëra familje Llapjane të shkojnë në përmbarrim ku pastaj përmbarruesi t'jua bllokoj të gjitha llogaritë të gjitha atyre familjeve gjë që do të ishte një kosto e cila faktikisht dhe teknikisht e pamundur, madje edhe në aspektin human e pamundur sepse në rast se janë 100 obligues mund edhe të veprohet me përmbarrim por ku janë mijëra familje është e pamundur të bllokosh mijëra llogari që sigurisht përmbarruesi privat do ta bënte një gjë të tillë.

Edhe disa çështje të cilat u diskutuan dhe që kanë të bëjnë me Zyrën e prokurimit ku njëra ishte regjistrimi të lëndëve dhe dokumentacioneve në platformën elektronike janë çështje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me atë që Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik - KRPP nuk kanë realizuar trajnime dhe certifikime të menaxherëve të kontratës për regjistrimin dhe menaxhimin e kontratave përmes platformës elektronike, mirëpo mos menaxhimi i këtyre përmes platformës elektronike nuk ka ndonjë humbje ose ndonjë kosto buxhetore për Komunën e Podujevës apo ndonjë element tjetër, kontrata është publike, raportet e pranimeve që bëhen janë të qasshme dhe mund të them publike për çdo njërin andaj në këtë formë janë bërë menaxhimet e kontratave, por nga ky vit shumë shpejt do të bëhet edhe trajnimi i menaxherëve të kontratave që janë staf i Komunës së Podujevës ku pastaj do të bëhet menaxhimi i kontratave edhe përmes platformës elektronike të prokurimit publik.

Pra këto janë disa sqarime në formë të përgjithësuar që u mundova të paraqes për ato që u diskutuan rreth këtij Raporti.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, konsideroj se drejtori i DBF i'u dha përgjigje të gjithëve për çështjet që ngritët gjatë kësaj pike të rendit të ditës. Tani ora është 12:00 dhe këtu në mbledhje kemi zyrtar të administratës të cilët kanë filluar punën në or 08:00 të mëngjesit dhe tani e kanë pauzën.

Gjithashtu konsideroj se kjo pikë e rendit të ditës përfundoj me fjalimin e fundit të drejtorit të DBF, mirëpo meqë po vërej se ka të interesuar ende për të marrë fjalën mund edhe të vazhdojmë shkurtimisht me diskutime të atyre që dëshirojnë.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, më parë nuk e ceka çështjen e realizmit të pagesës pa faturë dhe pa raport të pranimit të punëve, sa unë e kuptova drejtorin e DBF rreth kësaj çështje e tha se ne si Komunë e kemi kundërshtuar dhe nuk e kemi paguar, mirëpo unë mund t'jua lexoj se çfarë ka cekë Auditori në raport sepse unë nuk e di a është paguar apo jo, madje drejtori është në dijeni se edhe kur kam kërkuar qasje në dokumente zyrtare e kam thënë se meqë ky është donacion unë këtë nuk e dua dhe as dëshiroj të merrem me këtë qoftë çfarë bënë, qoftë sa participin dhe investon, pra në raport ndër të tjera rreth kësaj çështje thuhet kështu, Komuna e Podujevës pikërisht Kryetari i Komunës më datë 16 dhjetor 2021 kishte lidhë një Marrëveshje Bashkëpunimi me Organizatën Joqeveritare Qatar Charity për ndërtimin e qendrës së urgjencës mjekësore në Podujevë në vlerë 1,200,000.00€ ku prej tyre 780,000.00€ do t'i jap kjo Organizatë kurse 420,000.00€ Komuna e Podujevës, pra ose i'u dukur pak ose janë ulë edhe njëherë kanë bërë pazar dhe nga 1,200,000.00€ e kanë rritë në 1,700,000.00€ dhe me këtë është ndryshuar edhe vlera pastaj ku Organizata do t'i jap 1.100,000.00€ kurse Komuna 600,000.00€, do të thotë është rritur.

Mandej në vazhdim thuhet kështu për atë që drejtori i DBF e tha se nuk është paguar, Komuna më datë 29 nëntor 2022 nga kodi ekonomik objekte shëndetësore kishte bërë pagesë në vlerë 250,000.00€, andaj nuk dëshiroj të vazhdoj më tutje sepse e dini që pagesa është bërë pa raport të pranimit të punëve dhe pa faturë.

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, theksoi, përgjigje parafolësit, nuk e thash që ne nuk e kemi ekzekutuar pagesën por e thash që ne e kemi kundërshtuar të gjeturën. Pra pagesa në vlerë 250,000.00€ është ekzekutuar dhe është një projekt i jashtëzakonshëm për Komunën e Podujevës dhe atë donacion me vlerën dërmuese të këtij projekti.

Fillimisht ka qenë projekt ideor për të cilin është menduar se vlera financiare do të jetë afërsisht 1.1 milion euro dhe struktura a financimit ka qenë 65% me 35%, mirëpo kur është bërë komplet projekti ekzekutiv është konstatuar se vlera e projektit është 1.7 milion euro ku ne si Komunë kemi marrë obligim të paguajmë 600,000.00€ apo 35% të vlerës, kurse pjesën tjetër Organizata Qatar Charity, mirëpo tani janë zhvilluar procedurat e tenderimit vetëm për pjesën e tenderimit ku vlera është 1.2 milion euro, proceduar të cilat i ka zhvilluar Organizata e cekur ashtu siç figuron në Marrëveshje, ndërsa për pjesën tjetër mund të rezultojë se vlera e investimit të jetë më e vogël se 1.7 milion euro dhe varësisht kësaj vlere neve pastaj obligimi financiar na zvogëlohet.

z.Qëndrim Softolli, theksoi, po ndërlidhem paksa te fjalimet e parafolësve të pozitës të cilëve ju them se vetëm që është i kualifikuar mjafton ky Raport, pastaj analizën e bëjmë veç e veç.

I kemi 14 rekomandime, pra nuk janë as 1 e as 2 por 14 të gjetura dhe shkelje prej atyre mostrave e që nuk do të thotë që nuk ka edhe të tjera, por vetëm në ato mostra që janë marrë janë 14 gjetje ku 7 prej tyre janë të trashëguara nga Raporti i vitit paraprak e që Ekzekutivi është zotuar se do të zbatoj ato gjetje paraprake por që sërish nuk e ka bërë.

Te pagesa 250,000.00€ edhe unë u keqkuptova sikurse kolegu z.Ekrem Rrahmani, edhe pse në fund të Raportit të Auditorit thuhet se ju jeni pajtuar me të gjitha këto të gjetura, nëse keni pasë kundërshti mua nuk po më duket e kuptueshme kjo, fundja është ligji në bazë të cilit duhet të shpenzohen paratë publike dhe ka kontrole e jo kështu siç na teket neve, "me tahmin".

Unë nuk po e kontestoj donacionin, por fillimisht e thoni ka qen projekt ideor me vlerë 1.1 milion euro e pastaj është bërë projekt ekzekutues në vlerë 1.7 milion euro, kurse pastaj sërish deklaroi drejtori se edhe kjo vlerë mund të ndryshoj, do të thotë që sërish nuk keni një projekt të qartë.

z.Arjant Topanica, theksoi, sërish po tentohet të relativizohet ky Raport duke thënë se janë vetëm probleme teknike dhe që bartjet nuk janë problem nëse janë në interes të qytetarëve, askush prej neve nuk e potencoj që të mos veprohet në interes të qytetarëve, mirëpo është një ligj që duhet të zbatohet, kurse në raport kemi tejkalime ligjore, planifikimi dhe zbatimi duhet të bëhet sipas ligjit e jo sipas tekeve, për këtë arsye ekziston Ekzekutivi që bënë plane në bazë të buxhetit dhe realizon. Drejtori i DBF-së nuk u përgjigje për 12,000.00€ që janë kthim i sigurimit të tenderit, kush ka vendos të kthehen ato mjete dhe ku kanë shkuar ato mjete nëse janë kthyer jashtë ligjshëm.

z.Naim Çunaku, theksoi, për të dytën herë dëshiroj të them se po tentohet që ky Raport të vëhet në spikamë për të mos thënë me atë anën e viktimizimit duke përmendur Kontratën Kolektive e që e prek drejtpërdrejt mirëqenies, pastaj pagat, bashkëfinancimi me Organizatën Qatar Charity, borgjet, pra po tentohet që në këto 4 shtylla të preket ajo ndjenja njerëzore kinse nuk kemi pas qare pa e bërë këtë.

Te rrezikimi i pagave që e përmendi drejtori i DBF si shkak i Kontratës Kolektive, i nderuar drejtor ne të gjithë e dimë e nuk kam dyshim se ti e din më së mirë sepse e udhëheqë atë resor, që Thesari para se të bëjë pagesë në formë të dhunshme ju telefonon prej cilit kod dëshiron t'ju marrë, andaj ke mundur të mos prekësh kodin e pagave dhe të mos thoni tani do të mbeteshim pa paga.

Këtu u tha nuk ka pasë hajni, sugjeroj ta lëni letë çështje sepse nuk jemi ne ata që konstatojmë a ka pasë hajni apo jo, janë organet kompetente të bëjnë një gjë të tillë, pra nuk jemi ne ata që konstatojmë diçka të tillë, por janë organet përgjegjëse të pavarura besoj Gjykatat që e konstatojnë atë situatë, ndërsa ne në raporte kemi veç keq menaxhim dhe askund të Raport nuk mund ta gjejmë që thuhet se ka hajni, rrezik të shpërdorimit po dhe këto janë fjalitë e Raportit, por jo gjuha që përdoret në raport.

Sa i përket borxheve të qytetarëve, vërtetë e pash si situatë të rëndë dhe këtu po të apeloj dhe po ta jap një premtim publik që të shqyrtosh bazën ligjore dhe mos inkasomi i borxheve, nëse mund të gjejmë bazë ligjore unë ju premtoj këtu nga kjo foltore që në emër të Grupit të LDK-së se do të votojmë për faljen e atyre borxheve të pa inkasuara dhe që nuk mund të inkasohen, që nuk mund të kalojnë në borxhe të këqija por që vetëm po barten vit pas viti e që do të ishte mirë edhe për qytetarët edhe për pasqyrat financiare por edhe për vet gjendjen financiare të Komunës ta bëjmë njëherë e mirë një prerje / shkëputje nga këto borxhe që po përsëriten vit pas viti.

z.Bashkim Sylaj, theksoi, nuk dëshiroj të keqkuptohem nga drejtori i DBF sepse unë i gëzohem shumë faktit që Organizata Joqeveritare Qatar Charity ka dhënë shumë donacione në shumë projekte ku disa prej tyre i përmendi drejtori, mirëpo a ka mundësi të bëhen këto Marrëveshje pa ardhë pastaj ky rekomandim nga Auditori, nëse nuk ka mundësi sa më përket mua ju mund të merrni sa të doni donacione nga 1 milion e më shumë euro dhe unë asnjëherë nuk do t'ju përmend një rekomandim të tillë të Auditorit, këtë jua them pa politikë. Merruni me këto 13 rekomandimet tjera të cilat janë përmend, mirëpo sa i përket me donatorë asnjëherë nuk do t'ju përmend.

z.Naim Çunaku, theksoi, sërish i drejtohem drejtorit të DBF, përse në fillim të buxhetit nuk parashohim një kod buxhetor për bashkëfinancim ku mund të parashohim paraqitjen e donatorëve që pastaj ne të kemi drejtpërdrejt një kod buxhetor që do të mund t'i bashkë financim projektet për secilën Organizatë që vije si donatore e që disa prej tyre mund të kenë elemente që nuk do të bashkëpunoja fare, mirëpo Qatar Charity që ka kontribuar dhe ka ndihmuar zhvillimin dhe mirëqenien në Komunën e Podujevës vërtetë është për t'i përshëndetur, mirëpo do të mundnim që në fillim të buxhetit të kemi në projektion të buxhetit kod të rezervuar e që edhe në rast të mos

mundësisë së shpenzimit do të mund të bënim rialokimin e tyre në mënyrë që t'i kemi si mjete të gatshme për bashkëpunim dhe bashkëfinancim të projekteve që vijnë përmes donatorëve.

Pra vetëm një planifikim më i mirë po të ishte nuk do të vije fare kjo që e potencoj kolegu parafolës z.Bashkim Sylja.

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, theksoi, po më bie të përsërisë disa prej sqarimeve, edhe kur është votuar buxheti i Komunës për vitin 2022 ka qenë ndërtimi i objektit shëndetësor me Qatar Charity, do të thotë i përcaktuar si kod buxhetor. Për këtë çështje po shpresoj të mos na dëgjoj donatori, sinqerisht e them këtë sepse nuk është punë ashtu qysh u tha që po duam të luajmë sentimentin njerëzor në mënyrë absolute.

Po ndërlihem edhe me çështjen tjetër që po diskutohet, llogaritë e arkëtueshme, komplet nga qytetarët e Komunës së Podujevës, tatim në pronë edhe përkundër që i kemi dyfishuar të hyrat e tatimit në pronë, i realizojmë 800,000.00€, të gjithë ne duhet të paguajmë tatimin në pronë dhe duhet t'i realizojmë 800,000.00€ e që ende nuk e kemi arritur, kurse donatori (Qatar Charity) vetëm me një projekt po na i jep 1.1 milion euro, por që në të gjitha ato projekte që ka qenë donatore Organizata në fjalë janë rreth 2 milion euro, prandaj më shpjegoni ndokush mbi çfarë baze ligjore, njerëzore, menaxheriale e të tjera, të refuzohet ai donatorë. Marrëveshja është e qartë dhe nuk ka rrugë tjetër ligjore, Marrëveshja përcakton periudhat kohore se kur të ekzekutohen pagesat, dhe ndaj një donatori shumë serioz dhe shumë të vlefshëm për neve normalisht që edhe në kuptimin njerëzor dëshirojmë t'i qëndrojmë në fjalë sipas asaj që kemi lidh Marrëveshje, pra ka qenë që deri në fund të vitit 2022 Komuna e Podujevës t'i transferoj 250,000.00€ te donatori, këtë gjë e kemi bërë kurse donatori është duke realizuar projektin dhe njëmend jemi shumë krenarë që në fund të vitit qytetarët e Komunës së Podujevës nga një urgjencë që nuk e plotëson asnjë kriter do t'i marrin shërbimet në një urgjencë super moderne e cila është në hyrje të qytetit.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, konsideroj se debati për këtë pikë të rendit të ditës u përfundua, krejt qëllimi i debatit është për një punë më të mirë. Disa prej anëtarëve të Kuvendit tani veç keni shfrytëzuar mundësitë e marrjes së fjalës, por meqë po insistoni me doemos, urdhëroni shumë shkurt dhe konkret, pa i përsëritur gjërat.

z.Qëndrim Softolli, theksoi, absolutisht nga të gjitha diskutimet e parafolësve askush nuk u shpreh që është kundër këtij projekti për asnjë moment, ndërsa tani nëse ka ndodh gjetja, a ka vakum ligjor dhe a ka mundësi të bëhet ajo pagesë sipas asaj Marrëveshje në përputhje me ligjin, atëherë përse e ka gjet auditori këtë të gjetur.

Edhe për një çështje nuk pati përgjigje nga drejtori i DBF, dhe atë, a mund të na tregoni për shpenzimin e buxhetit për rrugët "Xhemajl Mustafa" dhe "Vëllezërit Frashëri" qysh arriti që 95 e ndarjes të shpenzohet diku tjetër ose që i ke bartur prej një projekti në një projekt tjetër ku jemi në dijeni që Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, e thotë ndryshme.

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, theksoi, lidhur me çështjen e Marrëveshjes, të gjitha komunat veprojnë ashtu dhe askund nuk ka të gjetura nga Auditori edhe pse nuk po dëshiroj t'i them disa teori tjera tani, madje thash shumë për këtë, më shumë se që është nevoja.

Sa i përket çështjes së konfiskimit të tenderit që është nga Zyra e prokurimit, nuk bëhet fjalë që ne i kemi transferuar mjete kompanisë por bëhet fjalë që një kompani kur vie dhe aplikon e ka edhe sigurimin e tenderit, në bazë të komisionit të vlerësimit dhe Zyrës së prokurimit thuhet që ka qenë një periudhë inflacioni ku ka pasë një rritje enorme e rritjes së çmimeve të disa produkteve dhe operatori ekonomik, sipas Zyrës së prokurimit është konstatuar se operatori është tërheqë sepse nuk ka mundësi ta realizoj atë projekt dhe rrjedhimisht nuk i është konfiskuar as sigurimi i tenderit që ka qenë.

Lidhur me ndërtimin e rr.“Xhemajl Mustafa” ne kemi pasë një kontratë ku sipas planit të prokurimit ka qenë ideja që fillimisht të ndërtohen rrugët “Skënderbeu” dhe rr.”Xhemajl Mustafa” si një projekt mirëpo në kohën kur është planifikuar buxheti dhe plani i prokurimit nuk ka qenë projekti ekzekutiv i ndërtimit të asaj rruge, ajo ka rezultuar me një kosto buxhetore më të madhe se sa ka qenë planifikimi fillestar, dhe në Kuvendin e Komunës është marrë vendim që të barten mjetet nga rruga që lidhë rr.”Vëllezërit Frashëri” te magjistratja Podujevë-Prishtinë, pra janë transferuar.

z.Naim Çunaku, theksoi, i nderuar drejtor i DBF-së, kur ka qenë kjo çështje për shqyrtim unë kam diskutuar me vërejtje këtë çështje duke ju thënë që nuk kemi të drejtë ta bëjmë një gjë të tillë, madje kemi cituar nenin 30 të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, dhe kemi thënë nuk bënë

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, u diskua mjaftë për këtë temë, shumë herë u përmend kjo “ka të drejtë nuk ka të drejtë, bënë, nuk bënë, kështu që e konsideroj të përfunduar debatin për këtë pikë të rendit të ditës.

Po vërej se ka shumë kërkesa të anëtarëve të kuvendit për një pauzë, andaj mund të shkojmë në pauzë deri në ora 13:30, kërkesë e cila mbështetet nga anëtarët e Kuvendit.

Mbështetet propozimi që Kuvendi të shkoj në pauzë rreth 1 orë, përkatësisht deri në ora 13:30

Pauza fillon në ora 12:20.

Pas pauzës, mbledhja vazhdon në ora 13:50.

Vazhdimin e mbledhjes e hapi dhe e kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, i cili fillimisht konstatoi kuorumin ku prezent janë 26 anëtarë/e të Kuvendit të Komunës.

Të pranishëm ishin anëtarët/et e Kuvendit, dhe atë:

(Nga LDK Valon Demolli; Arjeta Abazi; Edona Shabani; Arjant Topanica; Donjetë Sheqiri; Ilir Koprani; Naim Çunaku; Ekrem Rrahmani; Tringa Sfishta.

Nga LVV, Florent Hasani; Artrit Mulliqi; Kasib Bashota; Drita Pajaziti; Qëndresë Hajrizi; Ragip Fetahu; Xhevdet Maloku; Ardi Hasani; Haki Rudari; Bahri Blakçori; Lirika Maliqi.

Nga PDK, Bashkim Sylja; Mimoza Abdullahu.

Nga AAK, Mrika Thaçi; Burim Hasani; Arbnor Fazliu.

Gjithashtu të pranishëm ishin, z.Shpejtim Bulliqi Kryetar i Komunës, znj.Marigona Lahu Nënkryetare e Komunës, drejtorët e Drejtorive të Komunës, dhe atë;

(Fatlum Osmani-Drejtorja e Buxhetit dhe Financave DBF; Avni Fetahu-Drejtorja e Arsimit DKA; Leutrim Krasniqi-Drejtorja e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit DPUMM; Saranda Stublla-Drejtorja e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë DPKGJ; Pajtim Balaj-Drejtorja e Kulturës Rinisë dhe Sportit DKRS; Bahri Selimi-Drejtorja e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit DSHPMSh; Vigan Salihu-Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik DPZHE dhe i Autorizuar për Drejtorinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural DBPZHR, Adelinë Stublla-Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale DSHMS dhe e Autorizuar për Drejtorinë e Administratës DA, Alban Zeka-Drejtorja e Inspeksionit DI)

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, theksoi, vazhdojmë me rendin e ditës aty ku kemi mbet, prezent për momentin janë 19 anëtar/e të Kuvendit të Komunës por që shumë shpejt do të na bashkëngjiten edhe të tjerë sepse më lajmëruan se janë duke ardhë.

Pra jemi në pikë e 3-të të rendit të ditës dhe fjalën hyrëse e ka kërkuar drejtori i DBF.

3. Raporti Financiar i Komunës së Podujevës, për periudhën Janar – Qershor 2023

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, duke e paraqitur raportin në fjalë, theksoi, ky Raport pasqyron aktivitetet financiare që janë kryer në periudhën janar-qershor 2023 dhe ka për qëllim prezantimin e një pasqyre të aktiviteteve financiare të zhvilluar gjatë kësaj periudhe.

Shuma totale e buxhetit fillestar të aprovuar për vitin 2023 është 27,406,567.00€, prej tyre 13,041,000.00€ janë për paga dhe mëditje, 3,088,000.00€ janë për mallra dhe shërbime, 468,000.00€ janë për komunal, 1,600,000.00€ për subvencione si dhe 9,208,144.00€ për investime kapitale.

Nga kjo strukturë e buxhetit, shpenzimet për periudhën janar - qershor kanë arritur vlerën 11,425,182.00€, prej tyre 8,124,000.00€ për paga dhe mëditje, për mallra 1,502,000.00€, pastaj për komunal 172,000.00€, për subvencione dhe transfere 415,000.00€ dhe për investime kapitale janë shpenzuar 1,210,600.00€.

Gjatë kësaj periudhe sa i përket inkasimit të të hyrave vetanake janë inkasuar 1,050,136.00€ të hyra këto nga tatimi në pronë, nga lejet, nga shfrytëzimi i tokës si dhe taksat dhe tatimet tjera komunale.

z.Arjant Topanica, theksoi, sot jemi në pikën e tretë të rendit të ditës, që do të diskutojmë për raportin financiar për gjysmë vjetorin e parë të këtij viti pra janar-qershor 2023, nga raporti i auditimit që e diskutuam më herët përtej të gjeturave dhe rekomandimeve që ka nxjerrë ky raport i auditimit dhe përtej edhe pajtimit që kishin bërë zyrtarët komunal me ato gjetje sërish po vazhdohet me shkelje të njëjta që unë do ti numëroj disa prej tyre si në vijim, si pikë e parë ka të bëjë me

Kryetarin dhe kabinetin e ti, Kryetari dhe zyra e Kryetarit vazhdon edhe më tutje që kundërligjshëm buxhetin specifik të grantit qeveritar të arsimit dhe të shëndetësisë ta ndaj për anëtarët e kabinetit të tij, që si shembuj do t'i marrë tri raste por kemi edhe raste të tjera mirëpo për shkak të kohës nuk do të zgjasim shumë.

Drejtori i DKRS merr në vlerë 800 euro nga buxheti i shkollës “Aleksandër Xhuvani” për udhëtime jashtë vendit, shefja e kabinetit të Kryetarit merr avans 6000 euro nga buxheti i QKMF-së për udhëtime jashtë vendit, do të doja të dija se a është në dijeni drejtoresha për këtë edhe pse për momentin nuk gjendet këtu, sepse janë marr 6000 euro nga Drejtoria që ajo e udhëheqë për udhëtime jashtë vendit nga pjesëtarët e zyrës së Kryetarit. Punëtori i urbanizmit paguhet në vlerë prej 406 euro nga po i njëjti buxhet pra që kategorizohet në kontratë mbi vepër, që nga viti i kaluar këto shërbime të kontratës mbi vepër janë kategorizuar apo cilësuar në pasqyrat financiare si shërbime intelektuale. Kemi edhe raste të tjera që paguhen pa asnjë kontroll apo kriter sikur të ishte buxhet privat dhe të ndahej aty ku ka nevojë.

Keq menaxhimi i buxhetit te kategoria e subvencioneve, te Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit është një përfitues me inicialet Sh.A. që më 21 mars 2023 i janë paguar 1.117 euro, për çfarë subvencioni behët fjalë, pra figuron vetëm si kategori e shpenzimeve të subvencioneve që janë ndarë këtij personi fizik për mbi 1000 euro dhe nuk ka asnjë sqarim pse i ka marrë ky, por është e kategorizuar te subvencionet. Mandej Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural subvencionon OJQ UNDP-Kosova, data e pagesës është bërë më 27 shkurt të këtij viti, dhe shuma është 3.537 euro e që po ashtu e kategorizuar si subvencion. Kemi sërish pagesë të bërë në emër të Shoqatës Qatar Charity nga kategoria e subvencioneve në vlerë 6.800 euro më datë 27 mars. Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik po ashtu ka kryer disa pagesa në emër të subvencioneve që më datë 27 mars të këtij viti, pra përfitues sërish është OJQ UNDP që i paguhen 3.159 euro, sërish do të doja të dij pse janë paguar kësaj OJQ kjo pagesë dhe si janë të kategorizuar si subvencione, çfarë lloj subvencionimi është ky.

Pagesa tjera kemi më datë 27 mars të këtij viti, pastaj kemi më 26 prill ku përfitues është Nota Cake në vlerë 1.140 euro. Pagesë tjetër kemi më 28 prill të këtij viti ku përfitues është ALKO sh.p.k në vlerën e 10.000 euro, mjete këto që thesari, vlen të dëgjohet kjo, thesari ja tërheqë mjetet ALKO sh.p.k po sa ja transferon Komuna e Podujevës 10.000 euro në emër të detyrimeve që i ka kjo kompani ATK-së, pra një kompani ka aplikuar për subvencion ku ka marr subvencion dhe po sa ju kan transferuar mjetet, ATK-ja i'a tërheqë mjetet kësaj kompanie, pra Komuna i ka dhënë subvencion një kompani pa e dorëzuar vërtetimin e ATK-së që nuk ka obligime sepse nëse nuk kishte pasur obligime ndaj ATK-së, ATK atëherë nuk do t'ia kishte tërhequr parat asaj kompanie. Pastaj pagesa tjera kemi po në të njëjtën datë më 26 prill, ku përfitues është inicialet personi fizik me inicialet B.C. në vlerë 1.860 euro, pagesa e radhës është më 28 prill dhe atë 6.900 euro ku përfitues është Fresh Farm sh.p.k. pra të gjitha këto janë në emër të subvencionit pa dhënë asnjë shpjegim tjetër se çfarë lloj subvencionesh janë këto dhe pse janë shkuar këto pagesa tek këta individ ose operator ekonomik.

Pagesa e radhës është për biznesin individual B.S në shumë 2.670 euro, mandej në vazhden e këtyre pagesave është bërë edhe një pagesë tjetër për aktivitetin “promovim i trashëgimisë kulturore”, aktivitetet i para parë që të mbahet në muajin korrik pagesa për këtë aktivitet është bërë avans në Qershor e që duke e ditë për inflacionin që sot ndodhë as kompanitë private nuk po paguajnë më avans për shkak të vlerës së parasë që po lëvizë e jo Komuna të paguaj avans bizneset dhe personat fizik një apo dy muaj pa u mbajt aktiviteti, kjo është totalisht e kundërligjshme.

Drejtori i Drejtorisë së Kulturës rinisë dhe Sportit-DKRS, e keqpërdor buxhetin te kategoria e mallrave dhe shërbimeve për aktivitete kulturore. Pra i paguan artistët që janë punëtorë me kontratë të përhershme të punës në DKRS dhe Teatër si dhe bashkëpunëtorët e jashtëm nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve, që realisht pagesa për këta aktor apo individ do duhej të bëhej nga kategoria e subvencionit si përfitues individual, pra pa përfillur kategoritë bëhen pagesa. DKRS po ashtu nga kategoria e kapitaleve paguan në emër të projektit trashëgimia e objektit kulturor 9.500 euro në një pronë private, pra paguhen 9.500 euro në emër të trashëgimisë kulturore kjo është totalisht e paligjshme për arsye se investimet kapitale do të duhej të bëheshin dhe bëhen vetëm në prona të Komunës e jo në prona individuale.

Pagesat kapitale të Drejtorisë së Arsimit ku kemi një pagesë me vlerë prej 40.773 euro të ekzekutuara për shkollën “Ali Ajeti” në Balloc nga kodi përmirësim i infrastrukturës fizike shkollore, pra ndërtimin e sipërm të shkollës bëhen 40.000 euro pagesa në emër të përmirësimit të infrastrukturës shkollore, tash a është përmirësim apo ndërtim i shkollës, ne e dim që është duke u bërë ndërtimi i shkollës dhe komplet nga një kategori tjetër kryhet pagesa mbi 40.000 euro në emër të këtij shpenzimi, aq më keq lidhur me këtë nëse shikojmë raportin nuk figuron kjo pagesë fare. Pra prej 40.000 euro që është bërë në emër të shpenzimeve të ndërtimit të shkollës “Ali Ajeti” në Balloc. Po ashtu kemi edhe pagesa tjera siç është te shkolla “Ali Hadri” në Obrancë nga 167.329 euro që janë ndarë për këtë shkollë 27.400 euro janë të paguara jashtëligjshëm për një sallë sporti, dhe tash nëse keni caktuar buxhetin për ta ndërtuar një shkollë kurse e prej atij buxheti ke ndarë për një sallë sporti pa planifikim, shtrohet pyetja ku do ti marrësh 27.000 euro që ta plotësoni koston që kushton shkolla, a veç mbesim duke bartur mjetet sikur të ishte buxhet privat me logjiken “aty na duhen”.

Tek Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, në vitin e kaluar kanë mbetur shumë projekte pa përfunduar, e kemi parë së fundi që po krenohen me disa rrugica në Bradash dhe Dobratin që bëhet fjalë për projekte të vitit 2022 në vlerë 38.000 euro, pra më shumë se një vit nuk kanë mundur të realizojnë rrugica dy fshatra në vlerë prej 38.000 euro, e nuk kemi qysh t’i gjykojmë për rr.”Skënderbeu” që tani veç i ka kaluar të gjitha limitet dhe është një projekt shumë më kapital edhe voluminoz. Kur jemi tek kjo Drejtori do të doja të shtroja dy pyetje drejtorit, besojë që i dëgjon, 1-a mundeni të na jepni informatë të saktë se çka është duke ndodhur me rr.”Skënderbeu”, 2-sa ka arrit kosto totale, sa është vlera e pagesave të bëra deri më këtë datë, dhe 3-sa borxhe i kanë mbetur që të përmbillet pagesa e tërësishme për këtë rrugë dhe po ashtu edhe afatet nëse ka mundësi me na dhënë me që është stërzgatur e stërtepruar përfundimi i këtij projekti e nëse ka mundësi me na dhënë afatet e përfundimit dhe do të doja edhe informata tjera për projekte kapitale për vitin paraprak, që nuk i kemi askund të grumbulluara, cilat janë ato dhe në çfarë faze janë, kur do të përfundohen, pra një pasqyrë më të detajuar, as ne si Kuvendar nuk i kemi e lëre më qytetarët.

Për fund, kemi pesë kontrata të nënshkruara gjatë këtij viti që vlera apo kosto totale e atyre kontratave është 2,200,000.00 euro, kurse buxheti i planifikuar për këto pesë kontrata është trajtuar si tërësi, pra për pesë kontrata 2,200,000.00 të planifikuara për këto kontrata janë në buxhet veç 1 milion, do të thotë mbi 1,200,000.00 euro janë mungesë e mjeteve të zotuarra për kontratat e nënshkruara e që është shqetësim që e përmendem edhe më herët ku figuron në raportin e auditimit, pra kemi 1,200,000.00 euro kontrata të nënshkruara pa i pasur mjetet të zotuarra.

Këto ishin disa nga shkeljet e tërësishme, dhe për të mos mbetur borxh po e theksoj faktin që vërtetë më vjen shumë keq që jeni bërë si makina votuese.

Tek pika e parë që e propozova nuk e di me çfarë arsytimi e votoni kundër pikën për me dal pyetje përgjigje si pikë e parë e rendit të ditës, a po ju pengon transparenca para qytetarit apo pse

së paku një arsyetim me dhënë dikush, pse jeni kundër kësaj pike që ka të bëjë vetëm me transparencën dhe me interesin e qytetarit, asgjë tjetër.

z.Bahri Blakqori, theksoi, në emër të Grupit të LVV-së, e përkrahim raportin financiar janar-qershor 2023, i cili paraqet aktivitetet financiare të zhvilluara brenda këtij 6 mujori.

z.Bashkim Sylja, theksoi, buxheti i Komunës së Podujevës për vitin 2023 është 27,406,000.00 euro ku vetëm për investime kapitale janë paraparë 9,208,000.00 euro, në gjashtë mujorin e parë janë realizuar 1,210,000.00 euro ose 13% e buxhetit, konsideroj që është shumë e ulët e ekzekutimit të projekteve. Në subvencione janë paraparë 1,600,000.00 dhe janë shpenzuar 415,238.00 euro ose 26%. Tek të hyrat vetanake Komuna ka inkasuar për 6 muaj 1,059,000,00 euro ku 431,000.00 euro kanë qenë vetëm nga tatimi në pronë, mirëpo me miratimin e Ligjit për tatimin në pronë, për vitin e ardhshëm inkasimi i të hyrave nga tatimi në pronë do të jetë shumë i ulët dhe mendojë që duhet të pasur kujdes gjatë planifikimit të të hyrave vetanake në vitin 2024 sepse do të jetë shumë më i ulët se në këtë vit.

z.Valon Demolli, theksoi, e dëgjuam kolegun z.Arjant Topanica i cili theksoi shumicën e shkeljeve që janë theksuar në raport, por unë kam një pyetje për drejtorin e DBF apo edhe Kryesuesin e Kuvendit, dhe atë, kjo pagesa prej 180 euro - pije Kuvendi, a ka mundësi drejtor të na shpjegoni sepse këtu nuk ka as nënshkrim prej Kryesuesit të Kuvendit, andaj nëse ka mundësi këtë pagesë të na tregoni në emër të kujt është bërë, e kuptoj që ju edhe “vjedhni”, mirëpo jo edhe në emër tonë. Prandaj nëse ka mundësi të na shpjegoni këtë faturë 180 euro-pije, lëng fruta, makiato, nes kafe, në emër të Kuvendit, këtë nuk po e kuptoj.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, unë po jap përgjigje parafolësit që Kuvendi dhe unë në emër të Kuvendit asnjë kafe nuk e kam pirë, dhe as nuk e kam nënshkruar.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, në pika të shkurta i përmendi kolegu z.Arjant Topanica, por unë tani po i theksoi disa prej pikave në kategorinë e subvencioneve, andaj do të doja një sqarim prej Ekzekutivit për shpenzimet në këto kategori.

Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit e ka shpërblyer Shkëlqim Alshiqin me datë 23 mars 2023 në shumë 1.117 euro, për çfarë subvencioni behët fjalë. Pastaj Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka subvencionuar OJQ UNDP-Kosova më datë 27 shkurt 2023 në shumë 3,537.05 euro, pastaj pagesa tjetër është për Shoqatën Qatar Charity në shumë 6.809 euro dhe atë më datë 27 mars 2023, nuk e di për çka bëhet fjalë.

Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik ka bërë disa subvencione, shembull, më datë 27.03.2023 ku përfitues është sërish OJQ UNDP-Kosova dhe atë në shumë 3.159 euro, tjetër pagesë është më 26 prill 2023 ku përfitues është Nota Cake në shumë 1.140 euro, pastaj pagesë tjetër është bërë me 28 prill 2023 ku përfitues është ALKO sh.p.k. në shumë 10,000 euro e që këtij i janë dhënë këto mjete sepse ai person gjithë ditën rrinë duke na sha neve si subjekt që i takoj. Konsideroj se edhe për këto çështje do të del i kualifikuar vitin e ardhshëm raporti sepse kur ja keni jep këto 10,000 euro, nuk i janë kërkuar letrat e ATK-së se a ka borxhe apo nuk ka, në momentin që ju ja keni transferuar parat ATK-ja ia ka marr parat sepse ka pasur borxhe.

Pagesa tjetër është më 26 prill dhe përfitues është Bujar Cakiqi në shuma 1.860 euro, as te ky rast nuk dihet se për çka ju kanë jep ato para, mandej kemi pagesën tjetër më 28 prill 2023 ku përfitues është Fresh Farm për çka mendoj se nëse ka thirrja për të përfituar kompanitë prodhuese unë sot po e di se prodhon barna dikush këtu në Podujevë, nuk e di as kush është kjo Fresh Farm nuk e di as në çfarë cilësi ja keni dhënë 9.600 euro.

Pagesa e radhës është më 28 Prill 2023 ku përfitues është Bashkim Sfishta biznes individual në shumë prej 2.670 euro. Tjetra që ka qe ma interesant është se Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit e paguan Ekrem Bashoten 1.500. euro më datë 13 qershor kurse ai person aktivitetin e ka

mbajtur dje, do të thotë pa raport të punës, pa u mbajtur kjo fare, pa e ditë se a do të behet kjo fare i'a keni dhënë 1.500 euro me 13 qershor kurse ajo u mbajt dje, madje ky person nuk ka lidhje me atë aktivitet, nëse është farmacist i mirë edhe është aktivist i LVV-së nuk e di q'a ka pasur me këto artizanale, trashëgimi kulturore. Tjetër çështje që është këtu në raport nuk e di përse po i fshehni këto sepse ne kemi qasje në raport Free Balanace dhe mund t'i kërkojmë nga Ministria, shembull për dreka zyrtare për komplet vitin 2022 kanë qenë diku pak mbi 15.000 euro kurse tani e keni prezantuar që keni shpenzuar dreka zyrtare 2.874 euro për gjashtë mujorin e parë 2023, kurse realisht janë të shpenzuar 18.863 euro vetëm për këtë gjashtë mujorin e parë, dhe nëse dëshiron drejtori unë mund ti përmendi emër për emër ku janë paguar drekat, darkat, pijet dhe të gjitha sepse i posedoj komplet faturat për gjashtë mujorin e parë, mirëpo është interesante kjo ngase është shkruar vetëm 2.874 euro janë shpenzuar për dreka zyrtare, ndërsa janë shpenzuar 18.863 euro e që për këtë kush nuk beson unë mund t'ia përmendi me emër se nga kush dhe ku janë paguar, këtu diçka ka ndodhur, ose i është rritë barku ndokujt dhe dikujt dhe po ngrënë më shumë ose diçka tjetër sepse gjithë kjo drek e darkë pa asnjë marrëveshje pa asnjë faturë dhe pa listën e atyre që kanë ngrënë apo që kanë qenë mysafirë sepse ne e kuptojmë se mund të vijë ndonjë delegacion nga jashtë apo diçka të ngjashme 5-6 persona dhe që duhet t'iu jepet dreka dhe darka, por ne edhe e dimë në Podujevë e krejt Kosovën sa mund të kushtoj për një peron një drek apo darkë, madje edhe ndoshta edhe alkool po të konsumohet nuk është dashtë të shpenzohet shuma e cekur.

z.Naim Çunaku, theksoi, vërtetë nga ajo që u dëgjua kemi një rrjedhë të shpenzimit të buxhetit që për mua është shqetësuese, po e vërej që këtij krahit tjetër që është në pushtet nuk po i bënë shumë përshtypje kjo por në rregull jemi, mirëpo të paktën është premtuar diçka tjetër. Nuk dua ti përsëris ato që i potencuan dy parafolësit z.Ekrem Rrahmani dhe z.Arjant Topanica, por shqetësuese për mua dhe besoj është dashtë të jetë për krejt Kuvendin, të paktën nëse dikush mendon rreth asaj për çka është këtu ngase të raportosh diçka tjetër e në realitet të shpenzosh diçka tjetër është ose tentim për manipulim ose ashtu siç ishte në raportin e Auditorit të jashtëm, do të thotë raportim jo korrekt, për mos me thënë raportim i rrejshëm, dhe vërtetë nëse tentohet një trup i zgjedhur nga qytetari siç është Kuvendit që ka marr besimin qytetar, të mashtrohet nga Ekzekutivi në këtë formë për mendimin tim është për tu gjykuar, dikush këtu mund edhe të qesh, ndokujt edhe mund ti duket në rregull, por ju lus që për një moment të thërrasim ndërgjegjes tonë përse jemi këtu.

Nuk po merrem nga raportet prej Free Balance, por vetëm nga materiali që unë e kom marr si anëtar i Kuvendit, ajo që e përmendi z.Bashkimi Sylja është me të drejtë dhe vërtetë është shqetësuese dinamika e realizimit të buxhetit për këtë vit, sidomos të investimet kapitale ato që vërtetë e rrisin mirëqenien dhe shihet dhe prek taksapaguesi projektin apo taksën e vetë që ka paguar. Po citoj faqen 5, thuhet shpenzimet për tre mujorin e vitit 2022 e që shihet se janë duke ia huçë shumë e fort dhe kjo datë e tregon këtë, pra nuk jemi duke e trajtuar raportin e gjashtëmujor të parë të vitit 2022, por kemi në trajtim raportin financiar të vitit 2023, kurse këtë sigurisht që çdo kush e ka parë që flitet për raportin 2022.

Po provoj të shoh zhvillimet dhe diskrepancën që është krijuar në bazë të asaj që e kam para vetës, dokumentin e raportit gjashtëmujor dhe të shohim lëvizjen e shpenzimeve si kanë qenë një vit më parë dhe si jemi tani, ku dhe pse kemi ngritje e që e vërteta është se kemi edhe dy tri raste siç është shërbime të ndryshme, edhe pse shuma është e vogël por vetëm shërbime të ndryshme 375 euro, pastaj shërbime, shtypje, marketing 3.025.00 euro, mandej shërbime kontraktuale të tjera 252,210.00 euro, a do të ishte dashur ta dim se çka janë ato dhe kur ne nuk e dim si kanë mundësi ta dinë qytetarët se si jemi duke e kontrolluar menaxhimin e buxhetit, një buxhet që e kemi miratuar vetë ne si Kuvend. Kemi edhe shërbime dhe kontraktime tjera dhe sërish shuma 252,000.00 euro, dhe tani për diçka që nuk po mund ta kuptoj dhe që kërkoj sqarim është mobile

më pak se 1,000.00 euro e që në këtë gjashtëmuor kemi shumën 96,001.00 euro dhe a e merrni me mend këtë shumë, sikur të kishim kushedi çka të kompletim, të njëjtën periudhë të vitit të kaluar e kemi pasur 15.500.00 euro. E kam pranuar edhe këtu në foltore që nuk jam shumë i zoti në matematikë, me përqindje nuk di të shpjegoj siç duhet, por po e vëreni se sa është shumëfishuar shuma për këtë çështje. Pastaj kemi pajisjet tjera, çka nënkuptojmë me pajisje tjera, nuk është vlerë për tu nënçmuar 84.000.00 euro, edhe pse është më pak se vitin e kaluar që ka qenë 144.000.00 euro. Mandej në një situacion kemi shumën për dru 289.000.00 euro kurse në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar kemi pasur 55.000.00 euro, pse ky ndryshim a është dimri më i fortë apo është ajo që dikush përmendi “stomakët e rritur”, mirëpo drutë nuk kanë të bëjnë me ngrënie e stomak, prandaj do të ishte mirë të na sqarohet kjo përse ky ndryshim.

Kemi goxha shpenzime të mëdha edhe me karburant të veturave ku vlera është 50.000.00 euro, pastaj për mirëmbajtjen e ndërtesave 25.000.00 euro, mirëmbajtjen e rrugëve lokale 144.000.00 euro e që unë pyes këtu sepse vijmë nga mjedise dhe lokalitete të ndryshme, a i kemi parë ndokush ku është zhvilluar kjo mirëmbajtje, të paktën të dimë të arsyetojmë këtë shifër. Kemi një pozicion tjetër që për mua është e pakuptueshme mirëmbajtje rutinore, kujt, çka, kur, pse. Vazhdojmë tutje me shpenzimet e vendimeve të Gjykatës ku kemi 46.000.00 euro, pagesa e përfitueseve individual 89.000.00 euro, objektet kulturore 9.500.00 kurse vitin e kaluar 29.000.00 euro, do të thotë kemi kursim në këtë. Diçka që besoj se dëshironi të shikoni të gjithë sepse të paktën do ta prekni të gjithë në meset ku frekuentojmë janë trotuaret për çka deri në këtë periudhë raportuese kemi shpenzim 129,945.00 euro dhe atë pa një specifikë ose orientim se ku janë të shtruar këto trotuare. Nëse marrim në krahasim rregullimin e shtratit të lumenjve si problem akut që e kemi e që vetëm vitin e kaluar tri herë në vërshimet që kanë ndodh e që nëse do të pyetesh pyetet qytetari apo në qoftë se do të kishte një diskutim të mirëfilltë publik me qytetarin sigurisht që investimeve për trotuare do t’iu nderohet vendi me rregullimin e lumenjve e që ishte në shumë vetëm 12.000.00 euro, pra do të thotë një problem akut që rëndon dhe rrezikon të mirat materiale, ekonomitë familjare, ekonomitë biznesore, operatorët ekonomik etj, kemi vetëm 12.000.00 euro për këtë gjashtëmuor, ndërsa për trotuar 130,000.00 euro. Te mirëmbajtja e investimeve nuk po kuptojmë këtë dhe kërkoj një sqarim ngase kemi një ngritje që sërish matematika e jem nuk e kapë, vitin e kaluar për këtë periudhë kohore ishin 3.590.00 euro, ndërsa këtë vit kemi 114,990.00 euro, pra një rritje e shumëfishuar.

Nuk dua të zgjas më shumë por besoj që pas shpjegimeve të drejtorit të DBF që sigurisht do t’i jap do të sqarohemi më mirë për këto çështje, mirëpo po e mbyllë me atë që e fillova, shqetësuese janë investimet kapitale dhe dinamika e realizimit të investimeve kapitale në këtë masë kaq të ulët.

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, theksoi, u shtruan shumë çështje por po bëjë përpjekje që në formë të përmbledhur të jepi përgjigje për këto që u cekën sepse këtu u përmenden shumë gjëra teknike që mund të ofrohen sqarime në forma të tjera.

Po filloj nga një element shumë i vogël që u përmend por që u cek nga z.Valon Demolli për një faturë të Kuvendit Komunal, ajo vetëm emërimin e ka nga operatori ekonomik i cili shërben, pa mbajtur mend çdo faturë të cilën e ka Komuna e Podujevës, që i shërben Komunës kur vijnë delegacionet me makiato, pije etj. e që normalisht t’u mos e pas njohurin e saktë që i drejtohet institucionit i’u ka drejtuar si Kuvend Komunal, pra bëhet fjalë për administratën dhe nuk bëhet fjalë për Kuvendin e Komunës, epitetin që e përmendi ishte shumë i rëndë po si do që të jetë mbetet në ndërgjegjen tënde.

Tjetra që është më e rëndësishme dhe që u cekë lidhur me trendin e investimeve në Komunën e Podujevës e që normalisht në bazë të shifrave flitet për një përqindje të ulët të investimeve kapitale, mirëpo e vërteta është si çdo herë që tremujori i parë dhe tremujori i dytë i investimeve

kapitale është trend më i ulët për arsye se tremujori i parë është edhe moti jo i përshtatshëm për investime dhe rrjedhimisht investimet kryesore fillojnë në tremujorin e dytë mirëpo shpenzimet dhe pagesat kryesisht kryhen në tremujorin e tretë dhe në të katërtin, por e mira është që trendi i investimeve tani është në ngritje dhe pjesa dërmuese e kontratave janë në procedurat e prokurimit por janë në fazën e lidhjes së kontratave ose janë lidhur kontratat dhe tani ka filluar implementimi, por normalisht pagesat ekzekutohen në periudhën e mëvonshme.

U cekën edhe disa udhëtime zyrtare po normalisht këto janë në bazë të procedurave që janë për çështjen e udhëtimeve zyrtare dhe janë 1.243.00 euro njëra, dhe është afër 800 euro për një udhëtim tjetër që bëhet fjalë për shuma minimale të udhëtimeve zyrtare.

Disa subvencione të cilat u cekën dhe disa marrëveshje me UNDP do të thotë një marrëveshje bashkëfinancimi në mes Komunës së Podujevës dhe UNDP për disa grante të cilat janë në fusha të ndryshme. Tjetër u cekën edhe disa investime dhe pagesa që janë bërë në kategorinë e subvencioneve nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, ku madje u cekën edhe emrat e operatorëve ekonomik, të gjitha këto pagesa janë në bazë të thirrjes publike e cila ka qenë për mbështetje të bizneseve prodhuese në fushën e zhvillimit ekonomik që janë subvencione direkte të cilët janë bërë në bazë të thirrjes së kësaj Drejtorie ku Komuna e Podujevës i ka mbështetur me 30% investimet për makineritë prodhuese këto biznese dhe secila është në bazë të investimit 30% të vlerës janë me nivele të ndryshme, disa janë 10.000.00 euro disa janë 3.000,00 euro dhe disa 1.000.00 euro, pra janë të kësaj fushe.

Lidhur me një pagesë që u cek për trashëgimi kulturore ku u cek edhe emiri i personit, dihet që ajo është realizuar në bazë të thirrjes publike për mbështetjen e aktiviteteve kulturore ku disa kanë qenë për aktivitete kulturore, mbështetje direkte që i'u ka bërë individëve edhe normalisht për personat të cilët u cek pagesat kryhen momentin kur janë përfitues, ndërkohë në fund barazohet me raportin narrativ të cilin përfituesit e sjellin në përfundim të aktivitetit, normalisht jo vetëm atij personi por të gjithë ata që kanë përfitues në mbështetjen për aktivitete kulturore pagesa është bërë në muajin qershor dhe ato tani i realizojnë aktivitetet kulturore, e që në rastin që u cek është realizuar në korrik, disa janë realizuar më herët e që kështu është e rregulluar proceduralisht se qysh realizohen këto aktivitete kulturore.

Lidhur edhe me disa çështje që u cekën për shpenzimet midis kategorive ishte edhe për lëndët djegëse, aty ka qenë një obligim afër 100,000.00 euro të cilët kanë rrjedhë nga viti i kaluar dhe pagesa është bërë këtë vit, për arsye se fatura ka ardhur në fund të muajit dhjetor, rrjedhimisht në kohën kur vjen në fund të dhjetorit pagesa nuk mund të procedohet për arsye se më 24 dhjetor mbyllet sistemi i pagesave, dhe ky obligim është shpenzuar pastaj në vitin 2023 mirëpo gjithashtu jemi të njoftuar të gjithë që tek lëndët djegëse ka një rritje të çmimit ku me këtë kod ekonomik që është për dru, paguhen drurët dhe peleti e që për peletin jemi në dijeni se si qytetarë që çmimi është katërfishuar dhe rrjedhimisht për këtë kemi një rritje të shpenzimeve në kodin e këtyre lëndëve djegëse. E mira është që në këtë raport dihet çka është keq klasifikimi, pra keq klasifikim i bie kur me mjete të mallrave paguhen subvencionet ose e kundërta dhe rrjedhimisht nga këto që u cekën nuk bëhet fjalë për asnjë keq klasifikim.

z.Leutrim Krasniqi, drejtor i DPUMM, theksoi, meqë nuk isha këtu prezent por më njoftuan se është përmendur projekti i rr."Skënderbeu", fillimisht ju njoftoj dhe besoj që e dini se ky projekt ka qenë në vlerë 1,300,000.00 euro, prej që ka filluar prej vitit 2022 kemi vazhduar me punët shtesë shkaku i gërmimit dhe pjesës së zhavorrit që ka qenë i nevojshëm në fraksion më të madh që të jetë pjesë e kësaj rruge, ka pasur pak vonesa mirëpo që të gjitha këto vonesa janë shkaktuar shkaku i gërmimit, përveç kësaj trafiku ka qenë shumë i dendur dhe lëvizjet e qytetarëve të cilët nuk kan shfrytëzuar mundësitë tjera alternative gjatë lëvizjes si dhe ka pasur edhe pengesa të tjera

prej banorëve të cilët i kanë pasur pronat direkt në rrugë, për shkak të qasjes së tyre direkt në rrugë apo formave të tjera të cilët ata e kanë konsideruar, mirëpo për neve si Komunë kan shkaktuar vonesa, pastaj edhe një vonesë është shkaktuar prej KEDS të cilët momentalisht janë duke e shtrirë rrjetin nëntokësor të energjisë që është prej shkollës “Ibrahim Rugova” deri te i ashtuquajti rrethi i Kërpimehut e që në afat prej 10 ditëve do të përfundohet rruga në tërësi prej magjistrales deri te shkolla “Ibrahim Rugova” kurse pjesa tjetër do të vazhdohet pas përfundimit të ekzekutimit të projektit që ka KEDS për shtrirjen e rrjetit nëntokësor, arsyeja kryesore ka qenë edhe pse është shkaktuar një vonesë e tillë e konsiderojmë të arsyeshme sepse nuk do të duhej që më vonë që pas një viti të intervenohet përsëri nga ana e KEDS për shtrirjen të infrastrukturës nëntokësore por me këtë rast që është duke u punuar rruga, atëherë të vazhdohet edhe pjesën tjetër KEDS-i që tashmë e ka në proces të ekzekutimit dhe të përfundimit.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, kërkoj që edhe për projektet tjera që u përmenden, drejtorët e Drejtorive përkatëse t’i arsyetojnë secili projektet e tyre ngase për këtë janë këtu dhe në ato pozita.

z.Avni Fetahu, drejtor i DKA, theksoi, një plotësim sqarimi kam tek çështja e masës drunore konkretisht sa i përket çmimit që u parashtrua pyetje, i nderuari z.Naim Çunaku, vlen të potencohet që Komuna e Podujevës ka lidhë një kontratë me çmimin me të ulët në nivel të Kosovës, e dim që çmimi i masës drunore ka qenë ekstrem i rritur në vitin e kaluar, megjithatë kemi qenë si Komunë që kemi lidh kontratë me çmimin me të ulët.

z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSH, theksoi, mora shënime për gjithë ato që u përmenden sa i përket Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, u përmend ndërtimi i trotuareve nga z.Naim Çunaku duke theksuar se janë bërë shumë pagesa e që janë paksa mbi 100.000.00 euro për këtë gjashtëmuor, edhe te rregullimi apo mirëmbajtja e shtretërve të lumenjve duke shtruar pyetje përse janë vetëm 12.000.00 euro, sa i përket ndërtimit të trotuareve, për njohurinë e juaj ju them që në këtë vit nuk kemi pasë kontratë fare për ndërtim të trotuareve, kontrata është e vitit të kaluar që ka qenë kontratë dy vjeçare dhe arsyeja është kjo pse ka arrit operatori të kryej punë më shumë edhe t’i bëhet pagesa më shumë, kjo kontratë ka filluar muajin e kaluar, madje më duket që nuk janë bërë edhe shumë, vetëm pak mbi 100.000.00 euro që u përmenden sepse puna është në fazën përfundimtare, ndërsa ajo brenga që pse tek lumenjtë vetëm 12.000.00 euro të paguara për këtë gjashtëmuor, unë e kamë sqaruar edhe më parë këtë çështje, kontratat për rregullimin e shtretërve të lumenjve dhe mirëmbajtjen e tyre i kemi të ndara, kontrata e cila është për mirëmbajtjen e shtretërve të lumenjve është një kontratë e cila ka vlerë prej 55.000.00 euro dhe që kontrata është në ekzekutim e sipër, madje ai që e bëri këtë pyetje e di sakt ku është ka punohet edhe sot që po punohet me atë kontratë. Është arritur që deri më tani t’i sjell faturat në vlerë prej 12.000.00 euro dhe ia kemi bërë ato pagesa, ndërsa në fund të kontratës kur përmbillet kontrata ai operator do t’i merr 55.000.00 euro edhe del vlera që e ka marr, nuk kemi mundësi t’i paguajmë operatorë ekonomik para se t’i kryejnë punët, pra njëherë kryhen punët e pastaj pagesat.

Ndërsa sa i përket asaj përse janë kaq pak mjete të ndara për rregullimin e shtretërve të lumenjve, kjo ishte mirëmbajtja 55.000.00 euro, ndërsa jeni në dijeni shumë mirë sepse e keni votuar vetë dhe e kemi biseduar paraprakisht këtë çështje që rregullimi i shtretërve të lumenjve këtë vit dhe vitin e ardhshëm sepse edhe kjo është kontratë 2 vjeçare dhe do të kushtoj pak mbi 800.000.00 euro, punë kjo e cila ka filluar dhe është duke u punuar dhe besoj që të gjithë e keni parë sepse kaloni andej, dhe në momentin që kryhet situacioni i parë dhe ta sjellë faturën atëherë keni për t’i parë të raportuar mjetet që janë paguar, por pa e kryer puna nuk mund të bëjmë pagesa as këtu.

Brenga është për të gjithë besoj sa i përket rregullimit të shtretërve të lumenjve, së fundi jeni të njoftuar edhe nëpërmes mediave që është bërë një kontratë e re në bashkëpunim MAPL-në në vlerë

157.000.00 euro, ku 85.000.00 euro janë të ndara nga Ministria, ndërsa pjesa tjetër është e Komunës e që jemi në pritje të na dërgohet zotimi që të filloj të nisë kontrata e re që do të jetë edhe kjo në funksionim të rregullimit të shtretërve të lumenjve, prandaj nëse i mbledhim të gjitha këto që i kemi bërë deri tani, te rregullimi i shtretërve të lumenjve po na del se po investojmë në këtë vit në vlerë afër 1 milion euro, nuk ka kapacitete më shumë Komuna, këto i kemi edhe me ndihmën e Ministrisë së cekur, ndërsa për projektet e tjera të radhës jemi në diskutime dhe do të njoftoheni me kohë për secilin projekt që vije nga niveli qendror për rregullimin e shtretërve të lumenjve. Besoj se isha i qartë në sqarimet dhe përgjigjet e dhëna, por nëse ka diçka të paqartë mund të diskutojmë sërish.

z.Vigan Salihu, drejtor i DPZHE, theksoi, lidhur me subvencionet në Drejtorinë që unë e udhëheqë sikurse ju njoftoj drejtori i DBF z.Fatlum Osmani, ka qenë thirrja publike 30% e mbështetjes së kapaciteteve prodhuese për kompanitë, gjitha kompanitë që kanë blerë pajisje prodhuese ne jua kemi subvencionuar 30% të kostos së blerjes së pajisjes, do të thotë aty janë shpenzuar ato mjetet për të cilat më është bërë pyetje nga ju.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, ishin tri katër pyetje për Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, mirëpo për dy sërish dua përgjigje sepse përgjigja ishte shumë e pështjelltë dhe shkurt. Përfituesi ALKO sh.p.k 10.000.00 euro, përse nuk i'a keni kërkuar certifikatën e ATK-së, mirëpo posa i'a keni transferuar mjetet, prej thesarit i janë tërheqë mjetet sepse ka pasur borxhe në ATK, pras a e keni subvencionuar për t'i ndihmuar për kamata të kredisë apo për t'ia paguar borxhin ATK-së, ju ja keni ekzekutuar 10.000.00 euro, ndërsa shteti ja ka marr, kurse pyetja tjetër është se kush është Fresh Farm, çfarë kompanie prodhuese, çka prodhon ky në Podujevë, a ka mundësi të na tregoni me emër edhe për të parin se kush është ALKO sh.p.k që i'a keni dhënë 10.000.00 euro pasi është hyrë borxh, si dhe Fresh Farm kush është emrin dhe mbiemrin.

z.Vigan Salihu, drejtor i DPZHE, theksoi, Fresh Farm është kompani prodhuese e vezëve, do të thotë e pulave vjose, është në fshatin Gllamnik me mbiemrin Sylja nëse nuk gaboj kurse emrin e pronarit nuk e di. Kurse ALKO sh.p.k. është prodhimtari e këpucëve, do të thotë e tekstitit e cila i ka sjell komplet dokumentacionin e plotë sipas ftesës publike që kërkohet, dokumentacione të cilat mund të vini në zyrë dhe t'i merrni për secilin nëse veç keni ndonjë dyshim për diçka tjetër, pra mund t'jua ofroj dokumentacionin dhe dosjet komplet në mënyrë shoqërore nëse veç keni ndonjë dyshim, ndërsa për t'jua jap emrat e të gjithëve nuk jam i obliguar.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, lus anëtarët e Kuvendit që mundësisht të mos i përsëritin gjërat, pyetjet dhe sqarimet e njëjta sepse mjafton njëherë të kërkohen.

z.Arjant Topanica, theksoi, po ndërlihem me atë që drejtori i DBF e potencoj se te udhëtimet e planifikuara janë të natyrshme dhe nuk është shumë e madhe dhe nuk është diçka që është shqetësues, unë po besoj që është shqetësuese sepse shuma që e përmenda më herët është paguar nga buxheti i shkollës "Aleksandër Xhuvani" dhe i QKMF-së, nëse janë të natyrshme dhe të planifikuar duhet me pas buxhet të caktuar për udhëtime jashtë vendit e jo mi marr prej shkollës e QKMF-së e pastaj të thoni është e natyrshme.

Te DPUMM ku drejtori e tha që në rr."Skënderbeu" kemi vonesa për shkak të gërmimeve dhe lëvizjes së qytetarëve, po mendoj që gërmimet është dashtë të analizohen me plan të fizibilitetit dhe të realizueshmërisë, e jo t'i arsyetoni mbi bazën e gërmimeve vonesat tejkaluara ku tani po shkojmë afër për një vit vonesë, kurse për lëvizjen e qytetarëve ka mundur me qenë plani kohor kur ka më pak lëvizje por është filluar në pikun e lëvizjes së qytetarëve vitin e kaluar në kohën kur kanë ardhur mërgimtarët e që janë lëvizjet më të mëdha, me 9 qershor 2022, kurse te 1.2 milion euro që e potencuat janë të paraparë, do të doja të dija a u rritë kjo shumë, sa janë bërë pagesa deri më tani edhe sa kanë mbetur pa u paguar dhe a e dini koston totale të rr."Skënderbeu".

Drejtori i DSHPMESH u arsyetua duke thënë se pa u kryer punët nuk mund të bëhen pagesat, po bie menjëherë në kundërtënie me drejtorin e DBF i cili tha se nuk ka problem nëse i qesim pagesat në qershor për do punë që do të kryhet korrik, ashtu e potencoj dhe kjo është e evidente, pra drejtori tha se pagesa që është bërë është e evidente në muajin qershor që i janë paguar personit fizik për aktivitetin që është mbajtur në të kaluarën.

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, theksoi, kur bëhet fjalë për subvencionet ato janë ndarë në bazë të thirrjes publike edhe në momentin kur janë përfituesit individual për organizimin e aktiviteteve kulturore paraprakisht subvencionohen me mjete monetare, organizohet aktiviteti kulturor dhe e sjellë raportin narrativ për kryerjen e atyre punëve, tjetër logjik është të investimet kapitale e tjetër është të subvencionimi për aktivitete kulturore sportive, kur subvencionohet një klub sportiv e mira është të subvencionohet në fillim të vitit dhe ai klub aktivitetin e zhvillon gjatë vitit për komplet shpenzimet të cilat i ka lidhur me raportin të cilin e sjellë, e njëjta vlen edhe të subvencionet të cilat i ndanë shembull Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ta zëmë subvencionon Shoqatën “Hendikos” me 12.000.00 euro që do të thotë se ajo Shoqatë nuk i ka shfrytëzuar paraprakisht ato mjete por subvencionohet për aktivitetet e saj që e bënë në interes publik, në këtë rast aktivitet shëndetësor, andaj e njëjta vlen edhe të aktivitetet kulturore.

Sa i përket çështjes së përmendur rreth DPUMM lidhur me rr.”Skënderbeu”, ajo është bashkëfinancim me Ministrinë dhe tani në kohën e fundit janë duke u kryer pagesat të cilat kanë të bëjnë me rr.”Skënderbeu”, të gjitha në vitin 2023 i ka kryer Ministria e Infrastrukturës, ndërsa tek çështja e vlerës së kontratave të nënshkruara janë 2.2 milion euro ndërsa për këtë vit ka buxhet 1.2 milion euro, bëhet fjalë për kontrata dy vjeçare që normalisht në këtë vit janë 1.2 milion euro, mirëpo bëhet fjalë për kontratë dy vjeçare të cilat janë të planifikuar në kornizën buxhetore për vitin 2024 edhe do të planifikohen tash në projektbuxhetin e vitit 2024 që do të sjellët në muajin shtator në mënyrë që të mbulohet financiarisht projektet.

z.Arjant Topanica, theksoi, sa i përket asaj që e potencoj drejtori i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, rreth subvencionet e ndara janë bërë për kompani prodhuese 30% të makinerisë që e përmendi drejtori, ndërsa te po kjo Drejtori pagesë nga kategoria e subvencioneve ekziston shembull për OJQ UNDP dhe atë në vlerë 3.159.00 euro, çfarë prodhimi bënë UNDP që e ka subvencionuar DPZHE.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, ju dëgjoj shumë me vëmendje edhe mirë është që po sqarohen këto gjëra si dhe shumë mirë që po kërkoni sqarime sepse fundja jeni anëtar të Kuvendit dhe duhet t’i keni të qarta të gjitha këto transaksione që janë bërë.

Çdo pagesë e bërë, tani më duket se është transparente këtu dhe për këtë unë jam në dijeni se është një “mini zyre e LDK-së” në Drejtorinë e Buxhetit dhe Financave që i përcjellë dokumentacionet jashtë, kah kohë që e kamë të qartë këtë punë dhe nuk ka dilemë, por nuk jemi duke fsheh asgjë ne, madje nëse dëshironi dhe ju nevojiten, herëve tjera i marrim të gjitha faturat dhe jua sjellim që t’i keni në dispozicion, por unë mendoj që nuk është për mbledhje të Kuvendit kjo çështje ngase po ti shikosh të gjitha faturat që janë bërë janë me qindra e mija pagesa, mirëpo e qartë është se po dëshironi të bëni politikë urdhëroni bëjeni, fjala e urtë popullore thotë; “me kan lehtë me mbajt shtëpi Kola jem i kish mbajt dy”.

Pra drejtorët e Drejtorive e kanë për obligim t’ju japin sqarime sepse jeni opozitë edhe detyrat e juaja janë këto gjëra dhe tani jeni para televizionit e që tjetër mundësi nuk keni që t’i thoni këto gjëra që thoni, mirëpo drejtorët e Drejtorive janë për t’i mbrojtur punët e veta ngase këtu nuk punohet fshehtë por me dokumente punohet.

A ka logjik të bëhet pyetje për subvencionimin e UNDP-së kinse i jepet subvencion UNDP, jo nuk i jepet mirëpo UNDP financon projekte për interes të bizneseve ndërsa Komuna ka një pjesë të

participimit dhe kjo është nuk ka tjetër filozofi këtu, mirëpo këtë duhet t'ju tregojnë drejtorët e Drejtorive që i kam emëruar, pra këta duhet t'ju tregojnë që UNDP-në nuk e kemi subvencionuar ne sepse kjo Organizatë merr por jep subvencione pavarësisht që emërtohet si subvencion ngase janë mjete nga subvencionet që jepen për participim me UNDP e cila financon 10 projekte ta zëmë si shembull, dhe jep 70.000.00 euro kurse Komuna i jep 5000-6000 euro, prandaj ky është subvencion që lidhet me UNDP për të arrit tek projekti konkret që e financon UNDP në këtë rast, andaj nuk ka kurrfarë dileme.

Këto janë mjete buxhetore të Komunës dhe askush nuk mund t'i përvetësoj, në qoftë se janë marrë avans për udhëtime, janë evidentuar që janë marrë, por përse nuk po e potenconi sa janë kthyer prej asaj shume apo sa janë shpenzuar, mirëpo ju tregoj unë se nga ajo shumë prej 6000.00 euro që janë marrë nuk janë shpenzuar më shume se 500 euro, e them këtë ngase u përmend nga një prej parafolësve se janë marrë 6000.00€ avans, prandaj ju them që ta shikoni shumën që është kthyer e jo vetëm shumën që është marrë, normale është që kur udhëton duhet me pas para me vete sepse nuk mund të shkosh me duar në gjepa askund ngase situata të llojllojshme mund të ndodhin, udhëtim është ka obligime edhe dalin obligime, madje edhe një kurorë me lule nëse është dashtë ta dërgoj në Zagrep tek busti i Nënë Terezës, duhet të blihet me para, prandaj e them se duhet pasë para me vete, besoj që po e kuptoni tani, të paktën ju të subjektit LDK ngase keni dijeni dhe keni provojë në këto gjëra e që aq shumë po i shikoni në hollësi dhe në detaje e gjëra të imta, por në rregull është kjo dhe sërish po ju them që keni arsye të plotë ngase këta (drejtorët e drejtorive) nuk po flasin e që janë po këta që duhet t'ju japin sqarime juve, por që nuk po flasin e po detyrohem të flas unë vet, ndoshta drejtorët po harrojnë që duhet me fol, ky është problemi, kështu që ju opozita shumë mirë po e shfrytëzoni këtë situatë, prandaj mendoj se këtu ka më shumë se transparencë se çdo kund tjetër, "mini zyrën e LDK-së e keni tek pagesat, transparencë më të madhe nuk ka, ata zyrtarë tërë ditën dalin marrin dokumente drejtorit të DBF-së dhe jua sjellin juve jashtë, madje madje disa prej tyre vijne në mbledhjet e juaja të kryesisë së partisë edhe raportojnë, ne jemi në dijeni për këtë kështu që po edhe të donim të fshehim diçka nuk mundemi sepse i kemi anëtarët e juaj këtu që na i keni lënë e që tani ne jemi duke punuar me ata persona, ne jemi të vetëdijshëm se kemi telashe, prandaj ju mirë po bëni sepse duhet të bëni opozitë dhe duhet t'i thoni këto dhe është mirë kjo ngase ne krejt pa dobësi nuk jemi, por jo në këtë formë qysh po mundoheni për çdo gjë, përndryshe drejtorët e Drejtorive mund t'ju paraqesin të gjitha pagesat në një listë të vetme, jua japin dhe mund ta shpenzoni tërë kohën duke i lexuar që të gjitha me specifika përkatëse sa i përket shumave, emrave dhe të gjitha, e pastaj thoni po bëjmë opozitë e nuk mendoj se kjo është opozitë bërje sepse të bëhet opozitë është të gjeni defektet që kemi e që absolut që mund të kemi, prandaj e potencova dhe po e ri përsërisë se do të ishte mirë që drejtorët e Drejtorive për punë të veta të japin përgjigje dhe sqarime ngase unë nuk mund t'ju mbrojnë punët e tyre, drejtori përkatës e din kujt i është dhënë subvencion edhe pse përfituesit nuk zgjedhën nga drejtorët, unë nuk e di edhe pse të gjitha i kam nënshkruar sipas rekomandimeve që më janë sjellë nga komisionet përkatëse që janë enkas për sektorë të ndryshëm, jeni në dijeni për këtë besoj që bëhet një rekomandim prej një komisioni profesional, i dërgon te Zyra e Kryetarit e pastaj merret vendim nga Kryetari, mirëpo nuk është drejtorit i drejtorisë i obliguar t'ju tregoj tani me emër e mbiemër përfituesit e subvencioneve, nëse ju duhen emrat mund të shkoni në zyrë dhe ju tregohen emrat sepse jeni anëtar të Kuvendit dhe keni të drejtë për qasje në dokumente, e jo të merreni me çështje të tilla siç ishte ajo rreth ATK-së që gjoja i ka marrë mjetet një operatori që komuna e ka subvencionuar, t'i lëni këto gjëra sepse nuk janë për një mbledhje të Kuvendit.

Unë e kam parasysh që ju të gjitha i dini sepse janë peronat nëpër pika të caktuara që jua japin të gjitha informatat kush do që ka interesim i merr, nuk është problem kjo sepse të gjitha janë

transparente dhe se ne nuk po fshehim asgjë, as nuk jemi duke punuar natën por në orarin zyrtar nga ora 08:00 deri në orën 16:00, kurse ju mund të bëni opozitë por është mirë të dini me çfarë të bëni opozitën e që keni shumë pika për çka mund të bëni opozitën, por jo me fatura sepse buxheti është për tu shpenzuar dhe për pagesa për t'u kryer shërbimet për qytetarët e që për atë jemi ne si qeverisje për t'i kryer shërbimet, prandaj po e them këtë sepse më duket që tepër jeni ka mundoheni, madje disa nga ju keni qenë këtu kurse disa janë ardhur më vonë, këto gjëra gjithherë janë bërë, nuk jemi duke bërë diçka të re këtu, as nuk jemi duke e zbuluar ujin e nxehtë, ato punë që i keni kryer ju dikur po i kryejmë edhe ne tani, vetëm pak më mirë se ju, kështu që ju mund të bëni opozitë por bëjeni pak më me mjeshtri.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, në emër të subjektit që përfaqësoj LDK, më duhet t'i përgjigjem Kryetarit i cili ndoshta u ngut paksa kur e tha se ne marrim informacione nga DBF.

Kryesuesi i Kuvendit, ndërhynte parafolësit duke i kërkuar që t'i përmbahet rregullores së punës për shkak se ka marr fjalën disa herë për këtë pikë të rendit të ditës.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, të respektohet Rregullorja e punës sepse për ju është më mirë, nuk kryhet krejt diskutimi në këtë formë, kërkoj falje Kryesuesit mirëpo tani jemi në përfundim të kësaj pike dhe e rrugës do të ishte që drejtori apo Kryetari ta ketë fjalën përfundimtare si rumbullaksim të kësaj teme dhe nuk ka diskutime më pastaj, por bëjeni në rregull është vetëm po e humbni kohën e juaj kot, diskutoni sa të dëshironi nëse ju lejon Kryesuesi mirëpo problemi është që nuk është duke u mbajtur rendi e që do të duhej të mbahej sepse është interes i të gjithëve të kursehet koha.

Sërish e them diskutoni sa të dëshironi dhe çka të dëshironi, në fund drejtori apo drejtorët e japin raportimin e fundit dhe mbyllet si pikë apo si temë, por jo të përplaseni me drejtorët të Drejtorive ju si anëtarë të Kuvendit ngase ne jemi Ekzekutiv, mes vete përplasuni nuk ka problem, mirëpo këto janë pasojat e mos menaxhimit të mirë të seancës sepse po shkelen rregullat dhe po shkaktohen telashe e vonesa për të gjithë ngase vetëm po përsëriten të njëjtat gjëra, prandaj i nderuar Kryesues kërkoj të mbani rregull.

z.Ekrem Rrahmani, vazhdoi, i nderuar Kryetar, unë kam kërkuar qasje në dokumente publike në Ministrinë e Financave edhe i kam marr dokumentet prej Thesari, mund t'ju jap gjitha dokumentet sepse unë nuk i kam shpikë. Në atë minutë që ju i'a keni transferuar ALKO sh.p.k. shumë 10.000.00 euro, Thesari i'a ka marr sepse ka pas borxh ATK-së kjo kompani apo operator, nëse del e kundërta unë mund t'ju kem borxh çfarë të doni.

Nuk e them diçka pa qenë i sigurt, kam kërkuar dokumentet e që mund t'i pyesësh edhe drejtorët përkatës të Drejtorive, pra nuk kërkoj dokumente nga punëtorët e Komunës por kërkoj qasje në dokumente zyrtare në nivel qendrorë, kjo ka ndodh kështu.

Ndërsa shuma që u përmend për 6.000.00 euro për udhëtim zyrtar, e di shumë mirë edhe sa janë marrë edhe sa janë kthyer, mirëpo ato mjete janë marrë nga buxheti i QKMF-së. Unë mendoj se Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, dhe ajo e Arsimit janë paksa më të mbrojtura në këtë aspekt, andaj nuk jam i sigurt a e din drejtoresha e DSHMS që i janë marr mjetet për udhëtime zyrtare prej buxhetit të QKMF-së, përndryshe askush nuk e tha që të shkoni jashtë shtetit të bëni Marrëveshje pa para apo me para tuaja personale, mirëpo të merren pak më me ren.

Edhe drejtori i DKRS i ka marr 800.00 euro prej buxhetit të Gjinnazit, por që është dashtë të udhëtoj jashtë vendit me para të drejtorisë që e udhëheqë. Pra askush nuk kërkoj që të mos shkoni jashtë shtetit dhe mos të lidhni Marrëveshje, por parat të merrni dhe shpenzoni ashti siç duhet me rregulla.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, nuk po dua që sërish t'ju zë në gojë emrat sepse po dua të jem më racional, parat ashtu siç u cek edhe mund të janë marr e që nuk janë në rregull nëse veç janë marr ashtu, edhe unë po pajtohem sepse drejtori i Drejtorisë së Buxhetit duhet t'i bëjë këto planifikime më mirë andaj theksojeni këtë por mos e ekzagjeroni këtë çështje. Drejtori i DBF e din shumë mirë që Kuvendi dhe Ekzekutivi i Komunës kanë nevojë për udhëtime andaj me kohë duhet të parashihet kategoria e mjeteve buxhetore, e qartë është kjo.

Vërejtjet që than rreth keq klasifikimeve që janë bërë, plotësisht keni të drejtë t'i cekni sepse është dashtë të bëhen planifikimet, mirëpo ka qenë një arsye më e madhe apo nëse mund ta them "Vis Major" në këtë rast, pra a më interes do të ishte që 2.5 ose 3 milion euro të kthehen suficit buxhetor dhe mos të shfrytëzohen në vitin 2022 e pastaj të mbeten borxhe, apo më mirë ta bëjmë një keq klasifikim të mjeteve edhe të paguhen ato borxhe që do të mbeteshin për vitin e 2023 dhe të realizohen ato projekte.

Ne kemi pasë parasysh keq klasifikimin dhe e kemi pritur një gjë të tillë, por nuk është diçka e madhe kjo sepse 80% të Komunave të Kosovës janë me raport të kualifikuar, madje janë edhe disa që ju i keni për qejfi e që i'u ka ndodh kjo, por qëllimi ka qenë i mirë. Keq klasifikimi nuk është keqpërdorim por është planifikim jo i mirë, ndoshta është dashtë me një seancë të jashtëzakonshme të Kuvendi të bëhen bartje e mjeteve buxhetore, mirëpo i kemi paguar ato dhe nuk kemi lënë borxhe, përndryshe do të kishim probleme siç i kemi tani në këtë fazë me arsimin sepse janë shpenzuar shumica e mjeteve buxhetore të këtij viti si pasoj që është dashtë të bëjmë pagesa me vonesë në fillim të këtij viti e që domosdo do të jemi të obliguar të bëjmë lëvizje të buxhetit për të krijuar mundësi për pagesën e lëndëve djegëse për këtë vit, prandaj unë nuk po e them se që nuk ka lëshime, janë lëshime por nganjëherë disa lëshime bëhen me qëllim të mirë për të hapë mundësi për të mbuluar diçka dhe për të mos lënë keq diçka, kjo ka qenë esenca.

Këtë vit nuk besoj se do të ketë nevojë të bëhen pagesa nga një kod apo kategori në një kod apo kategori tjetër buxhetore sepse janë të planifikuara mirë, nëse jo do të planifikohen me kohë, për këto çështje është Kuvendi i Komunës e cila merr vendime të tilla në propozime të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave e cila është e detyruar të rregulloj planifikimet buxhetore, këto punë i ka kjo Drejtori nuk ka punë tjera dhe nuk ka përse të merret me punë tjera.

Komunën e Podujevës nuk besoj se e doni më shumë se ne, edhe pse ju jeni opozitë të gjithë po mundohemi dhe po punojmë për qytetarët, unë e theksova edhe më parë se nuk jemi pa gabime as ne por e rëndësishmja është që gabimet nuk bëhen me qëllim dhe duhet të arsyetohen kështu siç i arsyetova e që unë besoj që në këtë interes jeni edhe ju si opozitë (në këto pika jemi të gjithë) ngase edhe ju jeni për interes të këtyre qytetarëve, përveç asaj që jeni paksa më të zëshëm që është normale sepse jeni opozitë.

Sa i përket dokumenteve nuk është me rëndësi, ju them këtu se asgjë nuk jam duke fshehur asgjë sepse nuk kemi çfarë të fshehim prej anëtarëve të Kuvendit ngase jeni përfaqësues të qytetarëve dhe duhet të jeni në dijeni për këto gjëra, nëse drejtorët nuk ju japin informata mund të më drejtoheni te unë si Kryetar i Komunës dhe unë shumë seriozisht ju them se do t'ju jap dhe nga këtu për këtë shpreh gatishmëri të merrem me juve qoftë 1 apo 2 ditë që t'ju siguroj ato që kërkoni, nuk ka problem për këtë sepse e përsërisë që nuk jemi duke fsheh asgjë, jemi transparent pavarësisht që mund të ketë ndonjë gabim por që nëse ka këta (drejtorët) duhet të tregojnë gabimin, shkakun dhe pasojat e gabimit. Unë ju mirëkuptoj sepse njerëz jeni, por unë besoj që këtu në Kuvend nuk mund të diskutojmë në këtë duke u bërë secili më i mençur se tjetri ngase të gjithë pothuajse jemi të të një kategorie sa i përket problemeve.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, konsideroj se të gjitha sqarimet pothuajse i dha Kryetari i Komunës në mënyrë konkrete.

z.Naim Çunaku, theksoi, fillimisht zotëri Kryesues sa i përket mbarëvajtjes së mbledhjes mendoj se më nuk jemi për herë të parë në seanca si anëtar të Kuvendit e lëre më për disa që kemi përvojë më të gjatë në Kuvend e dim që për çdo pikë të rendit të ditës kemi mundësi të diskutojmë dy herë, mirëpo kur është në pyetje replika (kur përmendet emri) diskutimi nuk kufizohet, pra mund ta konsultoni Rregulloren dhe ta shohësh që sa herë përmendet emri mund të merret fjala për replikë, kurse ajo që kryesuesi e potencoj replikë mbi replikë është fazë tjetër e diskutimit, prandaj të mos pretendojmë diçka sepse ne jemi në rolin tonë që na kanë caktuar qytetarët kurse ju si Ekzekutiv jeni në rolin tuaj.

Unë pak më parë diskutova në bazë të Raportit që është sjellë nga Ekzekutivi i Komunës dhe poenta ime kryesore ishte te prioritetet dhe dinamika e shpenzimit të buxhetit, pastaj parashtrova disa pyetje për të cilat dua sqarime sepse nuk jam duke kuptuar diçka këtu dhe nuk e di se çka është e lëre më t'ju tregoj ndokujt jashtë nëse më parashtron pyetje, pra kërkova sqarim dhe një prej sqarimeve që u dha është për shpenzimet e lëndës drunore ku ishte një ndryshim shumë i madh dhe u tha se është pagesë e vitit të kaluar, në rregull është. Tek trotuaret që diskutuam me drejtorin e DSHPMSh, duke pas parasysh sipas mendimit tim gjithnjë sepse për ju mund të mos jetë ashtu ngase ju i paraqitni prioritetet e jo unë, mirëpo këto kalojnë përmes Kuvendit i cili vendos për ato prioritate, do të ishte mirë të thirrej edhe një fazë e diskutimit publik sepse për mendimin tim është shumë e rëndësishme momentalisht sepse për 6 muaj kemi pasur tri herë vërshime dhe unë kur e rendita prioritetet për trotuar dhe prioritetin për rregullimin e shtretërve të lumenjve unë i jap përparësi rregullimit të shtratit të lumenjve ngase po atakohet ekonomia dhe shumë gjëra tjera, pra këtu ke poenta jo pse janë 129,000.00 euro për trotuare por pse nuk është më shumë tek lumenjtë.

Ndërsa nuk mora sqarim për shumë gjëra tjera, shembull, ky raport është i publikuar dhe mund të hyjë çdo kush ta lexoj, dhe në këtë aspekt kur dikush e sheh një ndryshim bukur të madh që është shuma mbi 100,000.00 euro për mobile e që duhet ditur përse ka ardh deri te kjo, jo vetëm ne por të gjithë dhe se prioritet i kujt ka qenë.

Pika tjetër që ishte për mirëmbajtjen e rrugëve lokale me një shumë 141,000.00 euro, pra këto ishin interesimet që kisha e që është e drejtë e imja themelore ta di se ku është shpenzuar, prandaj jam edhe këtu. Lirohuni prej kompleksit që nëse këtë e bënë Naimi ta zëmë tani duhet ta sulmojmë Naimin, ngase kur unë e shohë këtu diçka dhe nuk e di e kam të qartë se çka është siç është rasti ku thuhet toka dhe figuron shuma 280,000.00 euro por që sqarohet a është për shpronësim apo është blerë tokë apo çka është. Po ashtu është e pakuptueshme, të paktën për mua, kur në raport shohë Mirëmbajtja e parkut nacional Podujevë, por që nuk ka park nacional Podujeva, prandaj këtë është dashtë ta përmirësoni dhe mos më merrni këtë si sulm apo diçka të ngjashme.

I nderuar Kryetar i Komunës, lirohu prej ekspertëve që nëse e ka bërë ai gabim tani duhet të përsëritet ai gabimin, jo duhet të përmirësohet sepse pastaj mund të del diçka banale nëse e sheh ndokush siç është rasti me mirëmbajtjen e parkut nacional në Podujevë, kur s'ka park të tillë fare.

Pastaj nuk mund ta anashkalosh problemin ku thuhet raporti financiar për vitin 2022, kurse në fakt bëhet fjalë për raportin e vitit 2023, të paktën ta pranoni që është gabim teknik sepse raportet janë për tu sqaruar në mes punëve të kryera dhe rrjedhjen e parasë, prandaj i nderuar Kryetar duhet të heqim këtë formë sepse ka kaluar koha kur kemi bërë garë politike, këtu jemi për qeverisje dhe kemi edhe dy vite mandat, është normale sepse ne jemi opozitë dhe nuk mundemi ta lavdërojmë punën, dhe për fund ajo që harrova t'ju them më herët për çka tani edhe dua t'ju përgëzoj për shtrimin e disa rrugëve me asfalt në shumë 3000 euro, për çka edhe ju parashtroj pyetje tani se qysh mund të shtrohet me asfalt disa me shumë 3000 euro.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, nëse vërtetë figuron vitin 2022 në këtë Raport kurse tema është për vitin 2023, mund të them se është skandaloze dhe këtë është dashtë të shikoj paraprakisht drejtori i DBF. Ka kohë që i kam thënë drejtorit të DBF që ata persona/zyrtar të Drejtorisë nuk janë duke e kryer punën mirë, por drejtori po i mbron dhe po thotë se janë të mirë, kurse tani ky lëshim është produkt i tyre, aq të mirë që janë sa që lëshojnë gabime të tilla duke shkruar vitin 2022 në vend të vitit 2023, ose nuk e dinë as vitin as asgjë ose po duan të bëjnë shaka gjë që nuk kanë drejtë, përgjegjësia është e drejtorit të DBF në këtë rast sepse drejtori është dashtë ta shikoj atë.

z.Haki Rudari, theksoi, duke dëgjuar kolegët nga opozita unë parimisht jam për debat pa asnjë problem, por vazhdimisht edhe ne kur kemi qenë opozitë me të vërtetë është respektuar Rregullorja e punës së Kuvendit, e që në nenin 41 paragrafi 2 thuhet, pas fjalës hyrëse Kryesuesi i Kuvendit fillimisht i'ua jep fjalën shefave të Grupeve të këshilltareve në kohëzgjatje prej 10 minuta, pastaj fjala i'u jepet këshilltareve përkatësisht pjesëmarrësve në kohëzgjatje prej 5 minutave, mandej paragrafi 4 i të njëjtit nen thuhet se sqarime plotësuese apo diskutim për herë të dytë në kuadër të një pike të rendit të ditës lejohet vetëm kur përfundojnë paraqitjet për diskutim edhe në kohëzgjatje prej 3 minutave, pra nuk e kam shpik unë po kjo Rregullore ka dal nga një Kuvend Komunal.

Sa i përket asaj që u tha lidhur me replikat, neni 44 i kësaj Rregullore pika 1 thuhet, në rast se gjatë debatit përmendet në mënyrë të drejtpërdrejtë emiri i ndonjë diskutuesi atëherë është e lejuar replika në kohëzgjatje prej 3 minuta, ndërsa replika ndaj replikës është e lejuar prej 2 minuta.

Jam ithtar 100% i zbatimit dhe respektimit të kësaj Rregullore për të gjithë pa anime dhe pa dallime, në rast se ndryshon Rregullorja për mua nuk ka problem.

Meqë e mora fjalën dëshiroj të diskutoj paksa edhe për raportin financiar edhe pse diskutoj në emër të grupit kolegu im.

Kryesuesi i Kuvendit, ndërhynë duke i'a bërë me dije se deri tani vetëm z.Ekrem Rrahmanit i'u dha fjala për herë të tretë, dhe atë për shkak se Kryetari i Komunës i'u drejtua atij.

z.Haki Rudari, vazhdoi, ne kemi një raport financiar, e kemi në faqe të 5 ku thuhet, progres i shpenzimeve, pra nuk kemi progres të kursimeve por vetëm të shpenzimeve që nënkupton të gjitha punët që kryhen duhet me pas mjete, unë për shkak të kursimit të kohës nuk po dua tani të hyjë detaje por për krejt këto projekte / kode nevojiten mjete buxhetore, ndërsa nëse ka pas diçka që nuk është në rregull unë pajtohem por realisht e them se nuk duhet t'i marrim këto dhe t'i vëm në një tabor politik dhe jo në interes të qytetarëve, për arsye se asnjë vizitë në emër të Komunës nuk mund të shkohet pa pasë harxhime, ne kur kemi qenë opozitë kemi përkrah vizitat e pushtetit, pastaj ne patëm një vizitë në Shqipëri vitin e kaluar dhe në përgjithësi kushdo qoftë edhe Ekzekutivi edhe Kuvendi Komunal kur del në vizita jashtë vendit normalisht që nevojiten mjete financiare dhe kjo nuk është diçka politike.

z.Naim Çunaku, theksoi, me vie keq që parafolësi nuk e lexoi takstativisht Rregulloren, mirëpo ato fjalë i thash unë dhe po e lë me kaq sepse u teprua kjo punë.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, besoj që secili prej juve e din Rregulloren, por ku po na konvenon për interes ton krejt po e këqyrin me shkelë, këtu është problemi sepse krejt e dim Rregulloren.

Edhe z.Arjant Topanica i cili po e kërkon fjalën njëherë ka folur në emër të Grupit dhe njëherë pastaj, andaj i nderuar Topanica për këtë pikë të rendit të ditës e ke përfunduar diskutimin.

z.Arjant Topanica, theksoi, për çështjen e Alko sh.p.k. dëgjova Kryetarin që tha “ja ka marr mjetet ATK dhe nuk kemi çka bëjmë”, në fakt ju nuk keni çfarë të bëni në këtë aspekt që ta parandaloni këtë, por operatori kur aplikon për subvencion duhet me sjellë vërtetimin e ATK-së pa borxhe, pra duhet me padit Alko sh.p.k. që e paska bërë falsifikim sepse në rast se nuk ka pasur borxhe qysh ka mundur të ndodhë kjo.

Gjithashtu Kryetari e tha që drejtorët e Drejtorive nuk janë që të konfrontohen me anëtarët e Kuvendit sepse këta e bëjnë punën e vet, por unë e them se tek që e bëjnë punën e vet e ekzekutojnë atë që na e miratojmë, unë mendoj se duhet të konfrontohemi me ata nëse nuk janë duke e paraqitë atë që duhet dhe këta duhet të na japin përgjigje, pra konfrontim në kuptimin e përgjigjeve. Po ashtu drejtori i DBF ende nuk e ka shpjeguar për 12.000.00 euro që janë kthyer sigurim i tenderit,

Po kthehem edhe njëherë tek çështja paraprake, nëse një operator ka aplikuar dhe është përzgjedhë për çfarë do arsye, përse nuk kthehen ato mjete.

Sa i përket keq klasifikimit, i nderuar Kryetar t'i e theksove që duhet të merremi me atë se çka është e arsyeshme dhe çka është evidente. Të gjitha këto që i thash janë evidente shembull, për rr."Vëllezërit Frashëri", 61,000.00 euro janë paguar në emër të asaj rruge kurse rruga nuk është askund, prandaj duhet ta dim ku kanë shkuar parat sepse nuk po cekët ku janë paguar, andaj arsyeja e kësaj është se ne po i ngritim shqetësimet e nuk jem duke bërë politik por shqetësimet që na preokupojnë neve dhe qytetarëve.

Edhe te çështje që u theksua rreth mjeteve buxhetore që barten, e që Kryetari e ceku se është më mirë me zgjedhë të keqën ma të vogël, edhe unë këtu pajtohem, nëse shkojnë suficid e që mund të shkojnë më mirë të shkojnë diku tjetër apo më mirë të keq klasifikohen se sa të kthehen, por të paktën me dhënë sqarime me argumente përse janë bërë këto në mënyrë që ne pastaj të dimë t'ia argumentojmë qytetarëve dhe ta dimë se çka po bëhet me mjete.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, kemi qenë në dijeni se do të ketë keq klasifikim dhe e kemi bërë me vetëdije sepse janë rrezikuar të na humbin mjete buxhetore, të shkojnë suficid.

Pra e kam ditë se ky raportim vie kështu por shumë e rëndësishme është që nuk ka keqpërdorim, keq klasifikim po, por e kemi bërë me vetëdije edhe kemi pritë që do të atakohemi në këto pika.

Unë jam i kënaqur që nuk i kam lërë 2 milion euro të shkojnë suficid, por i kam futë në punë, jua kemi dhënë qytetarëve dhe operatorëve ekonomik që i kanë kryer punët, kështu që në këtë duhet të na përkrahni edhe neve.

Sipas informatave që i kam nga drejtori i DBF, kualifikimi i tillë i Raportit të Auditorit, është se problemi kyç ka qenë problemi i mjeteve financiare që janë marrë prej projekteve kapitale dhe janë shpenzuar për paga sipas kontratës kolektive, ne një pjesë të atyre mjeteve financiare i kemi paguar prej buxhetit të kategorisë së pagave e që është në rregull, por kur janë shpenzuar pjesët tjera prej kategorisë së pagave (nga *Thesari sipas vendimeve të Gjykatave*) mjetet i kanë marrë ku i kanë gjetë, në këtë rast prej ndonjë projekti kapital, dhe kjo është thënë që është problemi kyç pse është sjellë raport i kualifikuar, unë nuk jam ekspert i asaj fushe por jam i thirrur t'i besoj drejtorit të DBF sepse për këtë është drejtori dhe unë i besoj punës së tij, madje madje unë as që do ta dija se çfarë është ky term dhe përse cilësohet kështu sepse nuk jam financier mirëpo për këtë arsye i kemi vendosur personat profesionist në fusha të caktuara për t'i kryer punët e tyre dhe për të na dhënë sqarime e ndihmë.

z.Vigan Salihu, drejtor i DPZHE, theksoi, përveç dokumentit që e posedoj këtu dhe që ju tregova më herët tani më dërguan edhe email-in ku tregohet se i ka kthyer ATK mjetet për të cilat po diskutohet, po e citoj, i nderuar tatimpagues mjetet që janë ndaluar nëpërmes thesarit janë në proces të kthimit vlëra prej 1,617.67 euro janë procesuar në TVSH muajin e tretë 2023, ndërsa vlëra tjera të biznesit në momentin që këto mjete procesohen atëherë përgatisim dokumentin për kthim të mjeteve, do të thotë u bë një gabim në ATK.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, do të thotë thesari ja ka marr parat, nuk e di a gabim a nuk është gabim ndoshta mund të jetë gabim por këtë kërkoja sqarim, jam i obliguar të kërkoj sqarim.

z.Vigan Salihu, drejtor i DPZHE, theksoi, pa pasë dokumentacion të kompletuar ne nuk e kalojmë asnjë aplikues për subvencion, nuk kam përgjegjësi unë e as komisioni.

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, theksoi, arsyeja përse bëhet raporti financiar dhe përse ekziston profesioni i kontabilitetit është grumbullimi i informacioneve që i paraqet në formë të përmbledhur, nuk bëhet përmbledhje në formë të shkoqitur, Komuna e Podujevës i ka afër 4000 transaksione financiare në vit, edhe nëse në fund të vitit të kërkohet sqarim për çdo transaksion, në rregull është mund ta bëjmë, mirëpo raporti financiar kur paraqitet në Kuvendin Komunal paraqitet në formë të përmbledhur dhe paraqiten zërat në bazë të planit kontabël edhe komplet këto tabela i gjeneron sistemi free balance ashtu siç evidentohen edhe gjenerohen nga zyrtari i cili merret me raportin financiar, pra nxirren raporte nga free balance dhe aty nuk mund të ndryshohet.

E përgjithshmeja është se sa i takon raportit financiar janar-qershor 2023 nuk ka asnjë keq klasifikim, (keq klasifikim është kur nga subvencionu paguhet mallra ose nga mallrat paguhet kapital), në qoftë se e marrim në raport me vitin e kaluar ashtu siç e sqaruam, arsyeja kualifikuese është për shkak të keq klasifikimit në kategorinë e pagave që janë marr nga kapitalet edhe një vlerë të caktuar të cilën e kemi bërë keq klasifikime për arsye të ndryshme sepse ta zëmë vie fatura krijohet shpenzimi për gjatë vitit dhe në fund të vitit operatori ekonomik mund të shkoj te përmbartuesi e që sërish mund të ndodh keq klasifikimi, ndodhin shpenzime përmbartimore, ndodhin dënimet, dhe në një formë është dëmtim i buxhetit.

Sa i përket pyetjes specifike që u parashtrua lidhur me pagesën që është kryer në shumë 67,000.00 euro për rrugën përgjatë brezit të lumit Llap, dihet se kur është ndërtuar rruga nga udhëkryqi i Kërpimehut janë bërë shpronësime të pronave, Komuna e ka bërë elaboratin e shpronësimit normalisht që si procedurë është Ministria e Financave që bënë vlerësimet e pronave përmes një akti të vlerësimit, disa pronar të pronave që i'u janë shpronësuar për atë rrugë, nuk e kanë pranuar vlerësimin financiar që e ka bërë Ministria e Financave dhe janë ankuar në Gjykatë dhe tani gjykata ka marrë vendim dhe në disa raste është rritë vlera e shpronësimit (shembull vlerësimi është bërë 20,000.00 euro kurse tani gjykata e rritë atë shumë në 32,000.00 euro), pra janë vendime të prera të gjykatës dhe duhet të ekzekutohen.

Tani sa i përket shpronësimit nuk ka më kod ekonomik edhe projekt që lejohet në mënyrë specifike për shpronësim, kodi është për projektin e rrugës e cila do të ndërtohet dhe ne fatmirësisht kemi 1,250,000.00 euro të planifikuara sepse bëhet fjalë për vazhdimin e asaj rrugës deri te magjistranja Podujevë-Prishtinë, dhe ai ka qenë pothuajse projekti më adekuat nga ku i kemi rekomanduar Thesarit t'i merr mjetet, pra bëhet fjalë për vendime të Gjykatës.

Unë edhe në fjalën hyrëse i sqarova një nga një çështjet, nuk është e pamundur që në fund të vitit të paguhet çdo faturë por bëhet fjalë për raport të përmbledhur financiar ku paraqiten kategoritë dhe sërish po e përsërisë se deri në muajin qershor të këtij vitit nuk kemi asnjë keq klasifikim, pra zero keq klasifikime. Për çdo gjë dhe për çdo faturë unë ju ftojë personalisht që ta shikoni dhe t'ju jap sqarime, madje para rreth një muaji dy anëtar të Kuvendit nga radhët e LDK-së kanë kërkuar fatura dhe menjëherë atë ditë i'a kemi jep në kopje, prandaj për këtë dhe për çdo tjetër jeni të mirëpritur kurdo në DBF për marrjen e kopjeve të pagesave, mirëpo kur diskutohet këtu në Kuvend për raportin financiar ndërlidhen edhe pozicionet brenda faturave e që bëhet fjalë për një numër shumë të madh të pozicioneve për të cilat bëhen pagesa, dhe këtu mund të diskutojmë pozicion për pozicion, sërish po e them se mund të diskutojmë.

Sa i përket subvencioneve të cilat i cekët me emra një nga një, ju them se janë në bazë të thirrjes publike edhe janë të bazuar në Rregulloren komunale për ndarjen e subvencioneve, apo në Rregulloren qeveritare për subvencionimin e OJQ-ve e cila është nxjerrë para shume viteve dhe për çdo gjë veprohet sipas procedurave për dhënie e subvencioneve, u bë temë kjo e që ndoshta

nuk është në rregull të përmenden emra të përveçëm të bizneseve, dihet ato kanë qenë publike se kush ka fituar subvencione. Te çështja e UNDP sërish bëhet fjalë për marrëveshje bashkëfinancimi në mes UNDP dhe Komunës në bazë të cilës janë realizuar projektet.

Prandaj e them se ndoshta u bë shumë zhurmë për asgjë, mirëpo me raportin financiar deri tani jemi në rregull dhe në përputhje me gjitha çështjet që parashihet ligji për financa publike, rregulloret për raportim financiar dhe jemi pa keq klasifikime meqë sot u bë temë sa i përket raportit të auditorit të jashtëm lidhur me çështjen e keq klasifikimeve.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, konsideroj që për këtë pikë të rendit të ditës debati u shterën andaj e konstatojmë të përfunduar dhe vazhdojmë me pikate radhës.

4. Propozim Vendimi për transferim të buxhetit të komunës për vitin 2023

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, e paraqiti fjalën hyrëse rreth këtij propozim vendimi, theksoi, këtu bëhet fjalë për vendimin e transferimit të buxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2023, në bazë të Ligjit për vetëqeverisje lokale dhe Ligjit për financa publike ne kemi të drejtën deri në 5 % të vlerës së buxhetit ta ndryshojmë, pra bëhet fjalë për transferim brenda projekteve dhe disa kategorive të cilat janë të përcaktuara në Qarkoren buxhetore dhe rrjedhimisht edhe në planifikimin buxhetor për vitin 2023. Arsyeja e sjelljes së këtij propozimi për transferimin e këtyre mjeteve është për shkak të asaj që e ceku edhe më herët e që ka të bëjë me sektorin e arsimit për shkak të lëvizjes shumë të madhe të çmimeve, kryesisht të lëndës djegëse dhe të ushqimit, tani veç vetëm kemi filluar të përballemi me mungesë të buxhetit dhe në bazë të analizës që kemi bërë është e pamundur që shpenzimet në kategoritë e mallrave të mbulohen deri në fund të vitit nga buxheti i cili ka qenë i planifikuar në sektorin e arsimit, prandaj kemi propozuar transferimin e mjeteve buxhetore nga disa projekte të cilat kanë një dinamikë më të vogël të shpenzimeve dhe në disa projekte të cilat kanë tepruar mjete buxhete sipas kontratave të lidhura në këtë pjesën e parë të vitit, të transferohen në kategorinë e mallrave në programin e arsimit fillor të Komunës së Podujevës. Për shkak të kohës nuk po i cekë me emra të gjitha projektet nga të cilat alokohen mjetet ngase i keni në materialet e dërguar, mirëpo ju ta mbështesni këtë propozim vendim meqë bëhet fjalë për një sektor shumë jetik së Komunës së Podujevës që është arsimiti.

z.Naim Çunaku, theksoi, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës që është propozim për transferim të buxhetit të Komunës për vitin 2023, një gjë që u cek gjatë diskutimit dhe që tani u cek që kur bëjmë transferime apo lëvizjet prej një kodi buxhetor, të paktën do të ishte mirë që investimet kapitale të lëvizin brenda investimeve kapitale, por nuk jam ithtar që të bartën investimet kapitale për mallra dhe shërbime, ndërsa me këtë propozim vendim që kemi para vetës gjithë kjo shumë buxhetore të bartet nga kategoria e investimeve kapitale në kategorinë mallra dhe shërbime, për çka dëgjuam disa arsytetime që ka mungesë të fondeve për mallra dhe shërbime në Drejtorinë e Arsimit, mirëpo vërtetë gjatë gjitha prononcimeve publike kam dëgjuar drejtorin i cili theksonte se kemi shumëfishim të buxhetit në arsim si kurrë më parë, andaj kur i kemi gjitha ato mjete e të merren edhe mjete nga investimet kapitale nuk po më duket shumë e arsyeshme.

Ku e them që nuk më duket shumë e arsyeshme ky transferim e që për këtë e dëgjova drejtorin e DBF kur e përmendi që nëse ndokush ka ndonjë prioritet që mendon që është më i arsyeshëm edhe mund ta propozojmë, dhe mbi këtë deklaram unë do të propozoj diçka që shpresoj që do ta marr mbështetjen e juaj, nëse jo jemi këta që jemi dhe mund të vazhdojmë.

Ndoshta te vërshimet u përmend shumë here një problem jetik që të paktën kësaj vere në këtë gjashtë mujor, goxha e ka bërë të padurueshëm jetën e atyre që jetojnë buzë lumenjve gjegjësisht

atyre që i kemi pasur më shumë se tri vërshime dhe konkretisht mendoj që nga këto mjete të parapara për rialokim të paktën një pjesë e tyre të kalon në kodin buxhetor rregullimi i shtretërve të lumenjve dhe atë në ato pikat që po atakojnë dhe rrezikojnë qytetarët e që në shumë raste kemi pasë rastin t'i shohim dhe identifikojmë edhe me drejtorin e DSHPMSH i cili paraprakisht më njoftoj se në këtë vit kemi një shumë të konsiderueshme që do të investojmë për lumenj, mirëpo unë propozoj që të paktën 150,000.00 euro nga kjo shumë e transferimit të ndahen në kodin rregullim i shtretërve të lumenjve, pra besoj që nëse nuk e rrezikojmë shumë arsimin, do të ishte mirë që si propozim një shumë 100,000.00 euro deri 150,000.00 euro nga kjo shumë e propozuar për transferim të kalojnë në kodin për rregullimin e shtretërve të lumenjve.

z.Haki Rudari, theksoi, në emër të Grupit të LVV-së e përkrahim propozim vendimin për transferimin e buxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2023, respektivisht këto mjete që u ceken nga ana e drejtorit të DBF të transferohen në Drejtorinë e Arsimit për arsye se është një Drejtori që ka shumë shpenzime, personel, numër të madhe të nxënësve, prandaj meqë në disa kode ka tepriçë të mjeteve ne mendojmë që është shumë mirë që këto mjete të kalojnë në Drejtorinë e Arsimit, prandaj do të ketë edhe përkrahjen e Grupit tonë.

z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSH, theksoi, meqë propozimi i z.Naim Çunakut u lidh konkret me Drejtorinë që unë e udhëheqë dhe me projektet për rregullimin e shtratit të lumenjve, normal që janë të mirëseardhura secila shumë e mjeteve buxhetore që ndihmon rregullimin e shtratit të lumenjve që po besojë të gjithë jemi pajtuar se kemi vërshime dhe jemi në një situatë të keqe, por unë besojë që sa i përket kësaj ndarje ne përveç atyre që i përmenda më herët jemi edhe në fazën e inicimit të projekteve të reja që kemi bërë bashkëfinancim me Ministrinë përkatëse dhe jemi në pritje edhe të një projekti që është shumë më madhor prej Ministrisë së Infrastrukturës që realisht ka kaluar por jemi në fazën përgatitore për nisjen e një projektit shumë të madh që si projekt do të bëjë zgjidhjen e problemit të shtratit të lumenjve, prandaj do të thoja që këto 150,000.00 euro jo që nuk janë të nevojshme por nuk janë të mjaftueshme për problemet që i kemi.

Meqë po presim prej atyre, ndoshta është më mirë që këto mjete të transferohen të gjitha në Drejtorinë e Arsimit kurse për hapat e mëtutjeshëm jemi në fazën e përgatitjes së projektit sipas instruksioneve të Ministrisë, mandej të bëhet ndarja e buxhetit për çka do të njoftoheni çdonjëri sepse sigurisht se do të sjellët përmes Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, mendoj që drejtori z.Bahri Selimi e dha një arsyetim, propozimi i z.Naim Çunakut besoj që ishte me vend por nuk e di se ajo shumë e mjeteve a mund të kryej punë nëse veç i bartim sot.

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, theksoi, sigurisht siç e ceku edhe parafolësi z.Bahri Selimi, investimet në rregullimin e shtratit të lumenjve janë shumë të nevojshëm mirëpo këtu bëhet fjalë për afërsisht 270,000.00 euro, të them të drejtën janë minimumi që na nevojitet për përfundimin e vitit arsimor 2023, kështu që nga këto mjete është e pamundur që të alokohen diku tjetër jashtë sektorit të arsimit, do të thotë është nevojë e pa diskutueshme për këto mjete buxhetore, madje edhe në propozim vendim është i shkruar arsyeshmëria për këtë çështje ku bëhet fjalë për lëndë djegëse dhe ushqim për përfundimin e vitit arsimor.

z.Naim Çunaku, theksoi, i nderuar Kryesues të jeni të bindur se unë personalisht nuk bie në asnjë pozitë të pa lakmueshme nëse nuk mbështetet propozimi im nga ky Kuvend, unë jam këtu për të dhënë propozime ashtu qysh unë mendojë kurse është krejt në dorën e secilit prej anëtarëve të Kuvendit që ta mbështes ose ta refuzoj për çka nuk ndjehem keq, mirëpo u mundova të arsyetoj sepse e kemi lehtë të flasim sidomos ata që nuk atakohen nga vërshimet, por do të doja që vetëm për 5 minuta t'i mendojnë të gjithë të mirat e tyre materiale, të gjithë ekonomit familjare dhe të gjithë ato të mbjella që kanë bërë, i rrezikojnë vërshimet, vetëm 5 minuta dilni në vendin e tyre dhe

atëherë e shihni. Unë vije nga një mes i tillë ku i shoh të atakuar, pa dashtë asnjë milimetër të ulë relevancën se për ku kanë menduar t'i dërgojnë, mirëpo mendova që sado pak ato mjete ta ndihmojnë këtë problematikë, madje ndoshta po e kthejmë krejt në personale këtë por kemi qenë dëshmitarë ku me mua ka qenë edhe drejtori i DSHPMSH, por ku te shikosh që dikujt i ka hyr uji në shtëpi me një masë deri në gjunjë dhe të mos mund t'i përgjigjesh fare dhe të veprosh asgjë është një situatë jo e lehtë, prandaj duke u nisë nga kjo unë propozova që të paktën gjysma e atyre mjeteve të ndahen për rregullimin e shtretërve të lumenjve.

Dëgjova që u cekë se janë të pamjaftueshme, jam në dijeni se që tre lumenjtë që e përshkojnë Komunën e Podujevës që të tria ndoshta kanë nevojë për investime të shtretërve të lumenjve, mirëpo nuk mund të barazohen me ata që atakohen e që më 16 qershor i kanë pasur shtëpitë e tyre të mbushura me ujë, e kam fjalën për hapësirat e brendshme ku banojnë dhe kjo më bënë obligues moral dhe njerëzor të ngris atë që e ngrita. Zotëri Kryesues unë kërkojë që propozimi im të hidhet në votim për miratim, pastaj është në dorën e anëtarëve të Kuvendit se si votojnë, nuk më mbetet hatri aspak nëse ata votojnë kundër.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, e di dhe besojë të gjithë e kemi bashkëndjer me ato familje që ju ka ndodhë një situatë e tillë, ngase në oborre të të kaloj uji është dëm e lëre më të hyjë nëpër shtëpi, andaj e kemi parë që janë bërë dëme të mëdha në këtë aspekt.

Pra e hedh në votim propozimin e z.Naim Çunakut.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 22 anëtar sa ishin prezent për momentin në sallë, 6 vota janë Për, 9 vota Kundër, 7 vota të Përmbajtura, nuk mbështetet propozimi i z.Naim Çunakut që nga shuma e propozuar për transferim të buxhetit, 150,000.00 euro të ndahen për rregullimin e shtretërve të lumenjve.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim propozim vendimin për transferimin e buxhetit të Komunës për vitin 2023 sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 22 anëtar sa ishin prezent për momentin në sallë, me 16 vota Për, asnjë votë Kundër dhe asnjë votë të Përmbajtur, (të tjerët nuk morën pjesë në votim), miratohet propozim vendimi për transferim të buxhetit të komunës për vitin 2023 sipas materialit të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

5. Propozim Vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri buxhetor për projektin

“Furnizim me mekanizëm bujqësor”

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, e paraqiti fjalën hyrëse rreth këtij propozim vendimi, theksoi, bëhet fjalë për shtimin e buxhetit i cili vjen nga participimi qytetarëve për projektin furnizim me mekanizëm bujqësor, qytetarët të cilët merren me bujqësi përfitues të këtij projekti duhet të participojnë me 30% të vlerës së projektit dhe nga vlera totale prej 134,550.00 euro, 94,185.00 euro janë fonde të Komunës ndërsa 40,365.00 euro janë mjete buxhetore nga participimi i qytetarëve dhe për këtë vlerë duhet shtuar ky buxhet dhe e kemi obligim ligjor nga Ministria e Financave për realokim të këtyre mjeteve.

z.Valon Demolli, theksoi, ne Grup i LDK-së mendojmë dhe propozojmë që përderisa në çdo propozim të Ekzekutivit është trumbetuar që kemi rritje të mjaftueshme buxhetore, përse duhet që bujqit në këtë gjendje të vështirësuar që janë nga shtrajtimit e imputeve për mbjellje, vërshimet që

na ndodhen më shumë se tri herë gjatë këtij viti, pra në mes të çmimit të mbjellurave dhe të korrurave shtrohet pyetja përse duhet bujqit të participojnë në subvencione.

Pasi që jemi duke folur për subvencionet pyes ndonjërin prej Ekzekutivit se a mund dikush të na paraqes një raport se si qëndron puna me subvencionet që u dhanë gjatë këtyre viteve, kush përfitojë, sa herë përfitojë dhe a e ka ne shfrytëzim subvencionin e marr nga Komuna, a kemi të dhëna se sa prej tyre janë shitur nga përfituesit e subvencioneve. Si Grup propozojmë që në të ardhmen bujqit e Llapit të lirohen nga participimi prej 30% në të gjitha subvencionet në Bujqësi.

z.Xhevdet Maloku, theksoi, në emër të Grupit të LVV e përkrahim këtë propozim vendim për shtim të buxhetit dhe krijimit të kodit të ri buxhetor për projektin furnizim me mekanizëm bujqësor në kategorinë subvencione dhe transfere.

z.Burim Hasani, theksoi, edhe ne si AAK e përkrahim propozim vendimin për shtimin e buxhetit në kod të ri buxhetor për projektin furnizim me mekanizëm bujqësor.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, është mirë me përkrah propozimin për furnizim me mekanizma bujqësor, sepse më herët e keni bërë përrallë punën e dhënies së një multikultivatori një personi që jeton në banesë, nëse pushteti i kaluar i ka dhënë mekanizëm bujqësor ndokujt që jeton në banesë, ju i keni jep, e përmendi edhe me emër se nuk e kam problem këtë punë z.Hamdi Jahës, i cili banesën e ka në Dardani -Prishtinë dhe familjen në Zvicër, kurse i keni ndarë mekanizëm bujqësor.

z.Naim Çunaku, theksoi, jeni në dijeni se edhe vitin e kaluar kur kemi pas propozime të tilla kam qenë kundërshtues për arsye që përse në qoftë se hyjmë me 30% participim faktikisht një pjesë e bujqve që e kanë të konsoliduar një ekonomi bujqësore edhe e përballojnë pjesëmarrjen me 30%, por kemi një kategori tjetër të bujqve që e kanë vështirë të përballojnë qoftë edhe këtë 30% participimi, andaj për mos me përsëritë atë që e tha shefi i Grupit, unë mendoj që të paktën të reduktohen subvencionet në bujqësi por të hiqet 30%-shi me arsyetimin që po i'a mundësojmë një kategori e cila nuk e ka konsoliduar ende bujqësinë, të jetë përfitues i këtyre subvencioneve, ndërsa shqetësuese është i nderuar drejtor që nëse mendojmë ta përparojmë bujqësinë në Komunën e Podujevës, nuk do ta përparojmë duke dhënë subvencione kurse pas një viti pa pasur asnjë mekanizëm e kontroll për mbikëqyrje të gjendjes së atyre subvencioneve se ku janë dhe çka ka ndodh me to.

Sigurisht që e dimë të gjithë pothuajse që një pjesë e mirë e atyre subvencioneve janë duke u keqpërdorur dhe pas një viti nuk i gjen ata përfitues me ato mjete, qoftë mekanizëm, qoftë projektin për mëshqerra nuk i gjen sepse i kanë tjetërsuar dhe ndoshta njëra prej arsyeve e që nuk dua të cekë me emër, thekson se unë i kam marr hua shumë prej 30% kur e kam marr mëshqerrën dhe nuk kam pasur mundësi t'i kthej parat dhe e kam kthyer mëshqerrën, andaj për t'i ikur kësaj unë edhe njëherë po e potencoj që nëse është nevoja të zvogëlohet numri i përfitueseve, por të lirohen bujqit nga 30% e participimit, dhe të forcohet mekanizmi i kontrollit për ata që kanë përvetësuar subvencionin.

Po i referohem nenit 2 të këtij propozimi për kod të ri, *projekti mund të krijohet nga mjetet e participimit të qytetarëve bazuar në marrëveshjen e mirëkuptimit në mes së Komunës dhe përfitueseve të subvencionit*. Çka kuptojmë me këtë, në një formë vullnetshëm përfituesit e subvencioneve po hyjnë në 30%, e nuk është ashtu si e cekët ju, sepse në rend të parë ti nuk e din se kush janë përfituesit ose paraprakisht janë zgjedhur fituesit.

z.Ragip Fetahu, theksoi, sa i përket 30% për participim unë mendoj që kjo në asnjë mënyrë nuk duhet të largohet për shkak se atë e paguajnë ata individ të cilët ja dinë vlerën bujqësisë dhe punojnë me bujqësi, në qoftë se e largojmë 30% dhe japim falas gjithçka atëherë i bie "sallamadi" ku çdo së cili merr çka don sa don edhe bënë çka don ai, se çka ndodh me to pas marrjes së produktit nga bujku atëherë është detyrë e institucionit dhe sa e di unë secili bujk e nënshkruan një

marrëveshje me institucionin që për një periudhë të caktuar do ta ketë produktin dhe secili prej këtyre bujqve që nuk e respektojnë atë marrëveshje ata duhet të jenë të obliguar, pra do të thotë që të ketë një mbikëqyrje më të madhe të institucionit në mënyrë që këto subvencione nga institucionet të jenë sa më produktive, mirëpo asesi nuk bënë që të largohet kjo për shkak se rritë bashkëpunimin dhe eficienten ndërmjet bujkut dhe institucionit.

z.Burim Hasani, theksoi, unë do të doja të japi një sqarim lidhur me përfituesit e subvencioneve pavarësisht në aspektin me mekanizëm bujqësor apo me mëshqerra ose raste tjera, te përfituesit e patëm rastin te kolegu z.Ekrem Rrahmani i cili ceku përfituesit në banesa, unë kam hasë në shumë probleme lidhur me listat e subvencioneve ku ka raste kur ka bujq të cilët i punojnë tokat i kanë emrat e tyre por ai nuk do të thotë që jeton banës, ai njëkohësisht jeton në banesë por e ka fermën e vet, punishten e vet, pra nuk mund të ndalosh të drejtën e përfitimit të asnjë fermeri sepse nuk mund ta obligosh ku të jetoj sepse mund të jeton njeriu në banesë por e ka fermën në fshat.

Pika e dytë, edhe pse për momentin nuk kem drejtor adekuat në fushën e Bujqësisë, do të doja që kontrollet pas subvencionimit të jenë kontrolle të jashtëzakonshme sepse po ka raste kur po keqpërdoren mjetet, shembull te furnizimi me mekanizëm bujqësor ka raste që e përfiton mekanizmin bujqësor dhe pas një periudhe shumë të shkurtë 1-2 muaj, po shoh shumë femër të Podujevës, mekanizmat të cilët i kanë përfituar nga Komuna e Podujevës ata po i vendosin për në shitje, andaj propozoj të formohet një komision që pas një periudhe të aplikimit të dalin në teren dhe të shikojnë fermerët të cilët janë përfitues a i posedojnë ato pajisje dhe në rast se nuk i posedojnë të ndëshkohen dhe t'i ndalohet aplikimi për subvencione për projekte të tjera.

Për fund, sa për sqarim, te furnizimi me mekanizëm bujqësor në kohën e fundit jemi lodh multikultivator, serë, mëshqerrë, do të thotë nuk jam duke parë tjera produkte që po plasohen nga Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, pra ka mekanizma tjerë të ndryshëm në fushën e bujqësisë që mundemi me përdorë edhe ka mungesë shumë, kështu që kisha kërkuar që kur bëhet planifikimi të bëhet një ndryshim apo ndërhyrje që mos të mos aplikohet vetëm për projekte të njëjta pavarësisht situatës ku me vite të tëra është e njëjta: serë, kultivator, mëshqerrë.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, zakonisht pa e njohur dikë dhe pa e ditë një gjë nuk e përmendi, jo që nuk jeton ai person në Podujevë por jeton në lagjen Dardani në Prishtinë, kur do që doni i nderuar kolegë z.Burim Hasani ju dërgoj atje dhe nëse mund të gjejsh që ka specat të mbjellur ai në Komunën e Podujevës, unë ju kam borxh.

z.Burim Hasani, theksoi, sinqerisht e them që nuk e bëjë as private as asgjë sepse nuk kam asgjë të lidhur me personin e cekur që po përmendet e as me z.Ekrem Rrahmanin, por në mënyrë kolegjiale po diskutojmë, mirëpo personin që e përmendi parafolësi zotëri Rrahmani ky është një fermer i madhe edhe e kultivon një sipërfaqe prej 5 hektar pemishte, për çka mund të adresoheni dhe të kërkonin në emër të tij dhe e gjen pa problem.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim këtë propozim vendimin për shtim të buxhetit dhe kod të ri buxhetor për projektin furnizim me mekanizëm bujqësor.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 20 anëtar sa ishin prezent për momentin në sallë, me 15 vota Për, asnjë votë Kundër dhe asnjë votë të Përmbajtur, (të tjerët nuk morën pjesë në votim), miratohet propozim vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri buxhetor për projektin "Furnizim me mekanizëm bujqësor".

6. Propozim Vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri buxhetor për projektin “Furnizim me sera”

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, e paraqiti fjalën hyrëse rreth këtij propozim vendimi, theksoi, bëhet fjalë për projektin në fushën e bujqësisë është e njëjta arsye, pra duhet shtuar mjete financiare të cilat janë nga participimi i qytetarëve.

z.Valon Demolli, theksoi, siç e ceka edhe në pikën paraprake, ne Grup i LDK-së, nuk e mbështesim asnjëherë ngarkesë shtesë për bujqit Llapjan.

znj.Drita Pajaziti, theksoi, në emër të Grupit të LVV e përkrahim propozim vendimin për shtim të buxhetit dhe kod të ri buxhetor për projektin furnizim me sera.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, **urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse atëherë e hedh në votim këtë propozim vendim.**

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 21 anëtar sa ishin prezent për momentin në sallë, me 15 vota Për, asnjë votë Kundër dhe asnjë votë të Përmbajtur, (të tjerët nuk morën pjesë në votim), miratohet propozim vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri buxhetor për projektin “Furnizim me sera”

7. Propozim vendim për kompensimin e anëtarëve të komisionit për koordinimin e procesit të zgjedhjes së këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane në territorin e Komunës së Podujevës

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, e paraqiti fjalën hyrëse rreth këtij propozim vendimi, theksoi, lidhur me procesin e zgjedhjes së këshillave të fshatrave ne kemi pas dhe ka qenë rekomandim i KPF-së që të merret një vendim lidhur me kompensimin e anëtarëve të këtij komisioni duke u bazuar edhe në praktikën e komunave tjera si dhe në mundësitë tona buxhetore.

Ne propozojmë që pagesa të jetë 40 euro për takim ku zgjedhet kryetari dhe këshilli përkatës, dhe normalisht kompensimi të bëhet në mënyrë retroaktive për mbledhjet të cilat janë mbajtur.

z.Naim Çunaku, theksoi, rreth propozim vendimit për kompensimin e anëtarëve të komisionit për koordinimin e procesit të zgjedhjeve të këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane në territorin e Komunës së Podujevës, po përmendi që një prej propozimeve të që kam bërë ish drejtoreshën e Drejtorisë së Administratës, kur është paraqitur propozimi për ngritjen e këtij komisioni i kam theksuar drejtoreshës që krahas konstituimit të këtij komisioni duhet të paraqitësh edhe koston financiare, për çka kam edhe njërin prej drejtorëve këtu nëse veç ai dëshiron ta pranoj, ngase është i detyrues që asnjë projekt nuk mund të realizohet pa kosto financiare, me përjashtimin e atyre punëve në mënyrë vullnetare që bëhen.

Procesi i konstituimit të këshillave të fshatrave është shumë i vonuar, shumë i diskutuar dhe vërtetë edhe kur e kemi futur si pikë të rendit të ditës na ka bërë që të jemi në rrugën e drejtë të konstituojm atë që na mundëson Ligji i vetëqeverisjes lokale, si organizim i nivelit nën komunal dhe organizim i celulës së parë gjegjësisht afrimit të qytetarëve në vendimmarrje, çka do të ishte shumë me rëndësi veçanërisht kur kemi të bëjmë me hartimin e projekteve prioritare, gjegjësisht Kornizës Afatmesme Buxhetore dhe projektbuxhetit. Jeni dëshmitarë të gjithë se ky proces ka filluar dhe e vërteta e madhe është që ka hasë në vështirësi dhe kur kemi folur për këtë kemi thënë na që për jetësimin e këtij projekti para së gjithash na nevojitet një vullnet qytetarë dhe gjithë grupimeve politike sepse fundja po ndërtojmë një celulë organizative që të paktën në bazë të Udhëzimit Administrativ dhe normave tjera në fuqi nuk kanë të drejtë të jenë akterët e politikës.

Në mbledhjet e kaluara tani e një muaj të KPF-së nga sugjerimi anëtarëve të komisionit në fjalë, unë në KPF që ta trajtojmë gjegjësisht ta fusim në rend të ditës në përmbledhjen e kaluar por duke parë që ishim të papërgatitur ishte një marrëveshje e të gjitha grupimeve politike që ajo të ndodhë në një mbledhje të ardhshme dhe kjo mbledhje është sot dhe këtë propozim vendim ne e mbështesim, por çka mund të jetë e diskutueshme është se anëtarët e atij komisioni nuk e kanë të drejtën të jenë prezent në sallë të Kuvendit dhe të votojnë për një propozim vendim të tillë për shkak të konfliktit të mundshëm të interesit, mirëpo e vërteta tjetër është që në bisedë me ata anëtarë dhe bazuar në arsyeshmërin ndoshta te shuma e kompensimit do të ishte mirë të jetë varësisht mundësive buxhetore por të paktën shuma për një konstituim të një këshilli qoftë lagjes urbane apo lokaliteteve të ndryshme të jetë 50 euro, dhe kjo të vlejë në mënyrë retroaktive prej ditës kur ka filluar të punoj ky komision.

z.Haki Rudari, theksoi, ne Grup i LVV e përkrahim këtë propozim vendim që ka ardhur nga Drejtoria përkatëse për kompensimin e anëtarëve të komisionit në fjalë, realisht edhe këtu në propozim vendim shkruan që pagesa bëhet për takim pune ku zgjedhet këshilli dhe kryetari i këshillit përkatës e që konsideroj se shumë mirë është e specifikuar, do të thotë në atë takim ku zgjedhet këshilli dhe kryetari llogaritet takim e që edhe paguhet, përndryshe e ceku edhe drejtori i DBF-së që pagesa do të bëhet në mënyrë retroaktive prej fillimit kur ka filluar procesi.

z.Ragip Fetahu, theksoi, siç e thanë edhe parafolësit këtu që inicimi i kësaj çështje është thjeshtë për bashkëpunimin zingjiror ndërmjet qytetarëve dhe institucioneve së Komunës së Podujevës dhe asgjë më shumë. Komisioni që ka për obligim dhe që ka marr përsipër të formoj këshillat e fshatrave natyrisht që ka edhe një pagë bazë. Ajo që unë do të sugjeroja është që të mos kemi përzierje të grupacioneve apo të individëve politik në këto këshilla për shkak se në shumicën e rasteve edhe po devijon pastaj, do të thotë si qëllim i kësaj çështje, ndërsa sa i përket kompensimit të tyre unë mendoj që shuma prej 40 euro për secilin anëtarë të këtij komisioni është më se e arsyeshme për shkak që siç e cekëm edhe më herët, është një pagë bazë dhe çdo kompensim më i madh për këtë komision natyrisht që do t'i irritonte edhe qytetarët sepse në këtë formë ne po rrisim beneficionet për ne duke tentuar të krijojmë diçka një lidhje me qytetarin, për këtë arsye shuma më e lartë se 40 euro mendoj që është e tepërt dhe është irrituese dhe dërgon drejt dështimit të tërë procesit.

Nga anëtarët e Kuvendit të pranishëm në sallë, mbështet propozimi i Kryesuesit të Kuvendit për një pauzë të shkurtër brenda ambienteve të Komunës,

Pauzë nga 16:10.

Pas pauzës mbledhja vazhdoi në ora 16:25.

Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se prezent në sallë janë 21 anëtar/e të Kuvendit, kuorumi ekziston dhe mund të vazhdohet me punë.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, vazhdojmë aty ku mbetëm, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim propozim vendimin sipas materialit të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje përfshirë edhe propozimin për rritjen e shumës së kompensimit nga 40€ sa është propozuar në 50€.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 21 anëtar/e të Kuvendit sa ishin prezent në sallë, me 17 vota Për, asnjë votë Kundër dhe asnjë votë e Përmbajtur (të tjerët nuk morën pjesë në procesin e votimit duke i'u shmangur konflikt të mundshëm të interesit), miratohet propozim vendimi për kompensimin e anëtarëve të komisionit për koordinimin e procesit të zgjedhjes së këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane në territorin e Komunës së Podujevës, me të vetmin ndryshim, dhe atë në nenin 2 të propozim vendimit ku figuron shuma 40€, vendoset të jetë 50€.

8. Informatë e Drejtorisë së Arsimit për vitin shkollor 2022-2023

z.Avni Fetahu, drejtor i DKA, duke e paraqitur Informatën në fjalë, theksoi, aktivitetet e planifikuara dhe të realizuara gjatë kësaj periudhe kohore në aspektin statistikor i kemi të bashkëngjitura me notë mesatare në të gjitha për së cilin nivel, si Drejtori Komunale e Arsimit kemi realizuar bursa për studentë në bazë të rregullores që e kemi votuar këtu, ku kanë qenë përfitues 265 studentë në shumën 350 euro, në fushën e investimeve të projektit të efijencës kemi shkollën “Shaban Shala” që ka përfunduar, “Shefki Kuleta”, “Enver Maloku”, “Luigj Gurakuqi”, paralelja e ndarë fizike në Gërdoc dhe janë në procedurë edhe shkollat sikur se është paralelja e ndarë në Lladoc në kuadër të shkollës “Ali Ajeti”, paralelja e ndarë në Pakashticë dhe shkolla “Shefki Kuleta” në Tërnavë.

Gjithashtu si Drejtori Komunale e Arsimit kemi realizuar një varg projektsh të cilat po i citoi radhazi,

-furnizimi i të gjitha shkollave me pajisje me kompjuterë janë në fazën finale të njoftimit pra të shpalljes së kontratës është një vlerë e projektit prej 200,000.00 euro,

-furnizimi me kabinete muzikore, ku ky projekt do ti kushtojë Drejtorisë Komunale të Arsimit në shumë prej 10,000.00 euro,

-furnizimi me rekuizita sportive, kemi nënshkruar sikur se e kemi pa së fundi me organizatën e IOM-it një bashkëfinancim për furnizim me kabinete dhe pajisje në fshatrat Orllan dhe Sfeqël,

-jemi në procedurë në një prej projekteve kapitale më të mëdha në Drejtorinë e Arsimit është faza për furnizim me tabela digjitale ku për këtë projekt janë planifikuar 300,000.00 euro,

-furnizimi me kabinete të gjeografisë dhe matematikë, është nënshkruar kontrata ku vlera e këtij projekti është 48,681.00 euro,

-instalimi i kamerave në ato shkolla të cilat nuk kanë qenë të instaluar është duke u vazhduar, -furnizimi me inventar në çerdhe, është fjala për çerdhen e re këtu në qytet e cila e ka inventarin e vjetërsuar, në të njëjtën kohë inventarin në çerdhen që do të finalizohet në fshatin Sfeqel dhe në fshatin Lluzhan,

-kemi inauguruar qendrën e parë të karrierës në Podujevë e cila funksionin në kuadër të shkollës “Fan S Noli”,

-në kuadër të kapitaleve kemi inauguruar masat e efijencës që ka një vlerë prej 730,000.00 euro nëpër shkollat që janë në nevojë dhe janë në fazën e vlerësimit pesë llotot e projektit të infrastrukturës shkollore ku për këtë projekt kemi planifikuar 500,000.00 euro, janë duke u vlerësuar ofertat nga komisioni përkatës lidhur me ndërtimin objektit të shkollës së mesme ekonomike projekt ky i cili komunës do ti kushtojë 2,000,000.00 euro, është lidhur kontrata për ndërtimin e shkollës fillore në Dumosh dhe sikurse jeni në dijeni që ka filluar aktiviteti të realizohet atje, mandej kemi disa projekte në realizim siç është salla e edukatës fizike në shkollën “Enver Maloku”, ndërtimi i sipërm i objektit të shkollës në Obrançë, salla e edukatës fizike në

shkollën fillore “Naim Frashëri” e cila është projekt me Ministrinë e Arsimit, gjithashtu edhe çerdhja më e madhe publike në kuadër të Komunës të Podujevës ku edhe ky projekt është i Ministrisë së Arsimit, në kuadër të projekteve në shkollën fillore “Shaban Shala” kemi edhe një donacion nga Bashkimi Europian në vlerë prej 150,000.00 euro ku parashihet të vendoset edhe një ashensorë për shkollën “Shaban Shala” kryesisht për fëmijët me nevoja të veçanta,

-kemi rritur shërbimin psikologjikë dhe pedagogjikë që ka qenë nevojë e madhe për shkolla, ku tani i kemi dhjetë psikologë dhe tre pedagogë, gjithashtu nga një numër prej 3 asistentëve për fëmijë me nevoja të veçanta që i kemi pasur, tashmë i kemi gjithsej 13,

-kemi në fazë të prokurimit sigurimin e transportit për vitin që do të hyjmë pra vitin akademik shkollorë si dhe ndërtimin dhe renovimin e objekteve shkollore, -rrethojat në kuadër të objekteve shkollore.

Natyrisht që jemi ballafaquar edhe me sfida në kuadër të Drejtorisë Komunale së Arsimit, që janë zënkat në mesë nxënësve, dëmtimet e objekteve shkollore, lokalet afër shkollave, qenët endacak, komunikacioni, këto që u diskutuan edhe më herët në pika tjera, ka pasur edhe organizime të garave të nxënësve ku në këto gara nxënësit tanë kanë korrë suksese e disa prej tyre kanë dalë edhe jashtë vendi, ku dhe i ka financuar Kryetari i Komunës duke u bazuar në Rregulloren në fjalë.

Meqë nga Kryesuesi është kërkuar që materialet të dërgohen deri më datën 17, kurse më datën 18 na janë sjellë rezultatet me përqindje për secilën shkollë, andaj nëse ndokujt i intereson specifiku për secilën shkollë se çfarë suksesi ka, ne mund t’ju dërgojmë.

z.Valon Demolli, theksoi, mbi 4000 euro mjete financiare janë mbledhë nga prindërit në shkollën “Naim Frashëri” në Podujevë për nevojat e shkollës, andaj pyes se ku janë ato mjete financiare.

Po krenoheni që është rritur buxheti në arsim kurse në anën tjetër nuk keni kontratë as për material higjenik, shembull kemi shkollën fillore “Xheladin Rekalii” ku punëtorit teknik që e lajmërojë këtë dukuri, i jepet vërejtje dhe kërcënime nga Drejtoria e Arsimit që do të largohet edhe nga puna, pra vetëm së kërkon material higjenik për pastërti, për fëmijët tanë që të mos marrinë ndonjë sëmundje në shkolla, Drejtoria e Arsimit fillon që të merr masa ndaj punëtorit teknik në fjalë dhe gati me përjashtim nga puna për çka opinionin dhe qytetarët nuk e dinë që po sa ka lajmëruar rastin ka filluar linçimi publik nga Drejtoria dhe ka marrë masa nga komisioni për disiplinor dhe që në një formë njëkohësisht që t’iu jepet porosi edhe punëtorëve tjerë që pa marrë parasysh se çka ndodhë në shkollat tona nuk bënë të lajmërohen rastet, pra është suspenduar punëtori Ilmi Tahiri vetëm se ka kërkuar material higjenik e kjo nuk ka ndodhë as në kohën e xhaxhit Enver.

Pastaj u përmenden kabinetet e ndryshime në shkolla, kurse të gjithë jemi dëshmitarë se në vitin 2022 kemi qenë pranë dështimit të mbajtjes së testit PISA ku për shkak se në të gjitha shkollat e Komunës së Podujevës nuk kemi pasur mundësi të sigurojmë një kabinet funksional që i plotëson kushtet për mbajtjen e testit të cekur. Ju e dini drejtor (i drejtohet drejtorit të DKA-së) dhe këtë e dimë edhe ne se në vitin e kaluar disa nxënës e kanë përsëritur testin për shkak të kushteve në Arsim, fundja krijimi i kushteve më të mira është obligim ligjor i Komunës.

Kur jemi te buxheti i arsimit, është normale që të ketë rritje të buxhetit sepse edhe buxheti i Komunës shënon rritje çdo vit, pra kjo nuk është ndonjë arritje. Nuk mohohet fakti se në disa shkolla edhe keni bërë punë, bile bile i keni cilësuar edhe punë të mëdha sikur se janë lyrja me polikollor e që besa shkollës “Enver Maloku” edhe ja keni trash izolimin stiropoll mbi stiropoll e fasadë mbi fasadë dhe nuk është çudi kjo mburrje ku për të njëjtën mburrje e kemi parë edhe nga shefi yt i cili proklamonte projektin madhor shënjimi horizontal me vija të verdha në shtegun e biçikletave, zaten këto janë projekte madhore që do të mbahen në mend. Përveç kësaj mos të harrojmë t’i bashkëngjisim edhe suksesin të stazave të gjelbëruara në rrugën “Skënderbeu”.

Drejtorit të DKA-së unë po dyshoj që i është prishur droni sepse po mungojnë ato fotot e bukura që vetëm ai dinë ti bëjë.

Sa konkurse i keni shmangë me dhjetë orë, ndërsa kontratë keni nënshkruar që paguhet me 20 orë, ka edhe raste me tri orë kurse në kontratë për 20 orë, ndërsa ju e dini që ligji nuk e lejon që të nënshkruaj kontratë nëse personi i ka më pak se 10 orë, por me rëndësi dy palët e kënaqura e për cilësi në arsim nuk brengosesh sepse besojë që ti (drejtori i DKA-së) ka brena edhe më të mëdha.

z.Ragip Fetahu, theksoi, para vetës kemi një informatë të Drejtorisë së Arsimit, një informatë që mund të thoja shumë voluminoze dhe në të paraqiten punë dhe angazhime konkrete që janë kryer gjatë kësaj periudhe për të cilën tregon edhe raportit. Vizitat e shpeshta nëpër shkolla që kanë për qëllim përmirësimin e cilësisë në shkolla, pastaj transportimi i nxënësve të cilët kanë distancë të largët, se ku ata jetojnë dhe se ku ata e ndjekin shkollën, angazhimi i DKA për transportin e nxënësve me nevoja të veçanta, rritja e numrit të psikologëve në shkolla, rritja e stafit pedagogjik, angazhimi i përmirësimit të kushteve teknike për nxënësit si dhe të gjithë mësimdhënësit.

Pra këto janë të arritura konkrete të Drejtorisë së Arsimit, përveç kësaj më lejoni të theksojë faktin se në këtë Drejtori falë punës dhe angazhimit të drejtorit është rritur edhe shuma e buxhetore për subveçionimin me bursa për student dhe nxënës Llapian, e që nuk është një e arritur e vogël duke e ditur se në vitin e kaluar sa ishte kjo shumë. E gjithë puna, angazhimi dhe përkushtimi i drejtorit të arsimit dëshmon dhe tregon përkushtimin e ti ndaj arsimit me qëllim që të kemi gjenerata më të mira. Detyrë dhe obligim i Ekzekutivit është që të krijojë kushte për secilin nxënës Llapian, kushte të tilla në atë mënyrë që të mos e braktisin shkollën për këto çështje, e që unë mendojë që për kohën që ne po flasim nuk besojë që ka raste se në praktikë ndodh braktisja e shkollës për shkak kushteve të këqija apo për shkak të një mësimdhënësi të dobët apo për shkak të cilësisë së dobët në arsim, mirëpo janë çështje tjera rrethana të cilat ne po jetojmë, rrethana tjera globale të cilat ne po i jetojmë, fatkeqësisht na kanë prekur edhe neve, rrethana të tilla që e zbehin interesimin e përgjithshëm të nxënësve në shkollë por çka duhet ne të bëjmë në këtë rast apo institucionet e nivelit qendrorë është që përmes metodave bashkëkohore dhe përmes digjitalizimit të librave dhe të shkollave të ngrisim interesimin e nxënësve për shkollën me qëllim që t'iu përshtatëm kushteve dhe rrethanave aktuale globale në të cilën ne gjendemi.

z.Naim Çunaku, theksoi, nga të dhënat statistikore që i lexova në raportin apo informatën e paraqitur në Kuvend, nuk kam vërejtur dhe jam i interesuar nëse posedoni ndonjë statistikë, sa nga nxënësit që e kanë braktisur procesin arsimor, qoftë për arsye të migrimit, qoftë prej arsyeve tjera, thjeshtë më intereson se sa është zvogëluar numri, sa kemi rënie prej vitit në vit, nëse posedoni këtë statistikë na tregoni. Kjo kishte me qenë gjëja për të cilën jam kureshtar të dijë, sepse kur e patëm Strategjinë zhvillimore të Komunës unë gjatë hulumtimit të saj nuk kam gjet më shumë se 2000 nxënës prej ciklit se kur kanë filluar deri në maturan, dhe thjeshtë kam interes të dijë se sa po bije numri i nxënësve sepse ky numër tregon pastaj edhe për migrimin që kemi si dhe gjendjen për ndërtimin e kapaciteteve në shkolla, qoftë personelit arsimor e tutje.

z.Haki Rudari, theksoi, të nderuar kolegë para vetës kemi një informatë nga Drejtoria e Arsimit për vitin 2022/2023, informatë në të cilën kemi aktivitetet e planifikuara dhe të realizuara gjatë kësaj periudhe kohore dhe më lejoni t'i përmendi disa prej tyre; në bashkëpunim me MASHT dhe DKA është bërë organizimi i trajnimeve që për mësimdhënësit është shumë me rëndësi, pastaj është bërë transportimi në mënyrë të organizuar i nxënësve të cilët kanë deri 4 km lartësi, po në të njëjtën kohë tash është përfshirë edhe bartja e nxënësve me nevoja të veçanta, po ashtu është bërë një kombinim me Policinë rreth sigurisë në shkolla e sidomos në shkollat e mesme që mendojë që është një elemente që pak a shumë ndikon në mbarëvajtjen e procesit mësimor, funksionalizimi i ekipit komunal përkatës që merret me fëmijët me nevoja të veçanta, hartimi i planit komunal për

parandalimin e braktisjes së nxënësve në shkolla, krijimi i bashkëpunimit për cilësinë që vinë nga fusha e arsimit, po ashtu kemi edhe ndarjen e bursave për student dhe nxënës.

Në të njëjtën kohë më lejoni që t'i përmendi disa projekte të cilat janë proceduar për vitin 2023; furnizimi i të gjitha shkollave me kompjuterë që është shumë me rëndësi, furnizimi me kabinete muzikore, furnizimi me rekuizita sportive, furnizimi me tabela digjitale, furnizim me kabinete për lëndët e gjeografisë, instalimi i kamerave nëpër vendet shkollore që është shumë me rëndësi, si dhe në të njëjtën kohë e diskutuam edhe në pikën që ishte për KKSB e që realisht siguria është më e madhe aty ku ka të vendosura kamera.

Kemi edhe disa investime kapitale të cilat janë bërë në këto objekte shkollore, dhe kur të përfundosh, realisht kjo informatë tregon se ka pasur punë dhe me rëndësi është që kjo është në interes të të gjithëve për arsye se e gjithë kjo infrastrukturë që është bërë, duke i përmendur disa fshatra ku ndër ato ishin fshatarat Obrancë, Dumosh, Llugë dhe vendet e tjera ku vërtetë ndikon në cilësinë e arsimit.

z.Avni Fetahu, drejtor i DKA, theksoi, falënderoj parafolësit për diskutimet, sugjerimet dhe vërejtjet lidhur me Drejtorinë e Arsimit, po e shohë si të nevojshme t'iu përgjigjem anëtarit të Kuvendit Komunal nga radhët e LDK-së, ku e potencojë një vlerë financiare prej 4000 euro të mbledhura në shkollën "Shaban Shala", këto mjete financiare nuk janë të mbledhura nga nxënësit apo mësimitdhënësit, por është një vlerë financiare e cila është trashëguar nga drejtori i mëhershëm tek drejtori aktual, pra nga shitjet që i kanë bërë me komision për disa gjësende që nuk kanë qenë të nevojshme për shkollën në fjalë. Në vazhdimësi keni kërkuar që t'iu jepet mundësia të kenë autonomi shkollat në aspektin financiar, unë jo vetëm në këtë shkollë por në asnjë shkollë tjetër nuk jam i përfshirë në këtë pjesë, për arsye se ata i kanë të mbuluara me komision, me fatura çdo investim që e kanë bërë në shkollë.

Sa i përket materialit higjienik, sa për njoftimin e juaj, kontrata është ende valide dhe është një inicim i procedurës për kontratën e re për material higjienik, kur lidhet kontrata lidhet për Shëndetësi, Arsim dhe Administratë dhe kjo është në procedurë edhe pse në të njëjtën kohë kemi kontratë valide që është në përfundim. Të merret si shembull personi në fjalë që e përmendët me inicialet I.T, është paksa e çuditshme sepse këtë person realisht ish qeverisja e kaluar e ka sjellë nga pozita e mësimitdhënësit ku ka qenë në fshatrat e largëta të Komunës së Podujevës, e vendosin si punëtorë teknik, dhe si të tillë e njohë prej kohësh që asnjëherë rehat nuk është bërë.

Të jesh mësimitdhënësi dhe të kalosh në punëtor teknik ka qenë e vështirë, është dashtë të inkurajohet sepse ka një vullnet të mirë për poezi, është dashtë t'i thuhet qartë që ta përfundoj shkollimin dhe do ta ketë vendin aty ku e meriton, edhe nga vetë forma se si është manifestuar ai aty, nuk është që ka mungesë të mjeteve higjienike dhe nuk do ta besoja se dikush bie pre e veprimit të ti se çka ka vepruar.

Te kabinetet në shkolla, asnjëherë më mirë nuk ka qenë, e përcjell gjatë kohën e arsimit, ndërsa testi PISA as nuk ka dështuar dhe as ka qenë afër të dështojë, kanë ardhur nxënësit nga shkolla e Dobratinit në shkollën "Shaban Shala", dhe kur kanë ardhur ata kanë pasur një sistem tjetër operativ që është dashtë të instalohet e që krejt kjo periudhë kohore ka zgjatur 40 minuta derisa e kanë bërë instalimin dhe ka vazhduar testimi i këtij programi.

Te shkolla "Enver Maloku" sa për njohurin e juaj projektet e efijencës i kanë standardet e veta, gjithashtu i kanë inicimin e procedurës së prokurimit që i bëjnë vetë ata, i kanë zhvilluar procedurat dhe e kanë vlerësuar se duhet të ndërrohen edhe dritaret dhe të bëhet fasadim mbi atë pjesë që ka qenë keq për fat të keq, pra kështu ka qenë dhe keni mund edhe ju të jeni nxënës i asaj shkolle dhe e dini, është bërë fasadim i duhur që është për lakmi, mjafton kjo, pra është sikurse me

çështjen e shkollës “Shaban Shala”. Çështja tjetër, ju them se nuk ka mësimdhënës me më pak se 10 orë, mund të ketë orë zgjedhore, por me më pak se 10 orë nuk ka shanse të lidhet kontrata.

Rreth pyetjes për dron, atë e kam pasion unë, dal e bëjë kur kam kohë të lirë, kur t’ju nevojitet që t’ju incizoj edhe juve ndonjë pjesë me rëndësi, nuk ka problem ju incizoj.

Parafolësi z.Naim Çunaku pati një kërkesë për çështje statistikore, aktualisht kemi një numër prej 15131 nxënës, është një rënie që është duke ndodhur në nivel Kosove çdo kund, nga dita e hënë është hapur projekti SMIA, për shkak të vonesës së grevës që ka ndodh sepse zakonisht këto janë kryer më herët, edhe të gjitha shkollat ose sekretarët apo vet vet drejtorët e shkollave i vendosin në sistem çdo braktisje që ka ndodhur prej janarit e tutje ku pasqyrohet gjendja reale ne Komunën e Podujevës, tash aktualisht nuk e kam shifrën e sakt, por besoj që në seancën e ardhshme ku edhe do të raportojmë për fillimin e vitit shkollor dhe do t’ju ofrojmë një informatë të tillë për gjendjen e këtyre nxënësve. Duke ju falënderuar për sugjerimet dhe vërejtjet, pres edhe pyetje tjera të mundshme.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, falënderoj drejtorin për sqarimet dhe përgjigjet e dhëna, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e konstatojmë të përfunduar edhe këtë pikë të rendit të ditës.

9. Propozim Plani komunal për ri integrimin e qëndrueshëm të personave të riadhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Podujevës 2023 – 2025 **- Raporti nga konsultimi publik**

znj.Marigona Lahu, Nënkryetare e Komunës, e paraqiti Planin në fjalë, theksoi, para vetes keni draft planin komunal për integrimin e qëndrueshëm të personave të riadhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Podujevës për vitet 2023-2025 si dhe raportin nga konsultimi publik, plan i cili është hartuar në bazë të Strategjisë për migrim 2021-2025, Rregulloren nr.22/2020 për integrimin e personave të riadhesuar si dhe bazuar në Rregulloren për integrimin e të huajve me nr.09/2019, e cila është miratuar në mbledhjen e 110 të Qeverisë së Kosovës.

Ky plan i veprimit në nivel shtetëror është në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Punëve të Brendshme si institucion përgjegjës për integrim në nivel nacional dhe në vete ngrëthen strukturën e sajë, mirëpo duke e pasur parasysh se ka të bëjë me nevojat e personave të riadhesuar në Komunën e Podujevës përmban edhe aktivitete specifike për vetë komunën dhe është e bazuar në të dhënat e siguruar nga Zyra Komonale për Komunitete dhe Kthim, kështu që në këtë plan është mundësuar integrimi maksimal i të gjithë aktiviteteve për arritjen e ri integrimit të qëndrueshëm të personave të riadhesuar si dhe integrimin e të huajve në Komunën e Podujevës.

Plani i veprimit përmban objektivat, aktivitet konkrete dhe masat për arritjen e objektivave, përcakton institucionet përgjegjëse dhe mbështetëse për arritjen e së cilit objektiv, saktëson kornizën kohore për realizimin e secilit aktivitet, koston e përafërt financiare si dhe zhvillimin e aktiviteteve. Kështu që ju ftoj që të përkrahni këtë plan.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, në emër të Grupit të LDK, këtë propozim plan komunal për integrimin e qëndrueshëm të personave të riadhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Podujevës 2023-2025, e përkrahim.

znj.Lirika Maliqi, theksoi, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës që po diskutojmë i posedojmë të dhënat përfshirë edhe ato nga diskutimi publik përmes raportit përkatës si dhe draft planin komunal për ri integrimin e qëndrueshëm të personave të riadhesuar dhe integrimin e tyre.

Në lexim të parë duket si diçka shumë e thjeshtë dhe shumë e lehtë për t'u bërë, por në realitet ka shumë vështirësi sepse kemi të bëjmë me rifillimin e jetës së qytetarëve tanë, të cilët për arsye të ndryshme do duhej të riatdhesohen në vendlindjen e tyre. Është jetike për qytetarët tanë të riatdhesuar të sigurojmë strehim, punësim, apo më mirë të themi të kujdesimi për gjendjen e tyre socio ekonomike, t'iu ofrojmë trajnime profesionale, shkollim dhe shumë gjëra tjera të nevojshme për rifillim të jetës. Ky është plani edhe ky plan duhet sa më parë të hyjë në fuqi sepse na duhet t'ju dalim në ndihëm qytetarëve tanë. Prandaj si LVV e mbështesim këtë raport dhe këtë plan.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri me 20 vota Për nga anëtarët e Kuvendit sa ishin prezent në sallë, miratohet Plani komunal për ri integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Podujevës 2023 – 2025, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

10. Propozim Plani i veprimit për integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian 2023 – 2026 në Komunën e Podujevës **- Raporti nga konsultimi publik**

znj.Marigona Lahu, Nënkryetare e Komunës, e paraqiti Plani në fjalë, theksoi, drafti i planit të veprimit për integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Komunën e Podujevës 2023-2026, ka ardhur në Kuvend pas përfundimit të procedurës një mujore në konsultim publik, për realizimin e planit të veprimit Komuna e Podujevës, do të kujdeset Zyra Komonale për Komunitete dhe Kthim në bashkëpunim me Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim European OSBE, me pjesëmarrjen e të gjithave Drejtorive komunale, Institucioneve të sigurisë dhe Organizatave joqeveritare që veprojnë në Podujevë të cilat janë edhe hartuese të këtij plani.

Ky plan ruan strukturën organizative të planit të veprimit të qeverisë së Kosovës, rrjedhimisht ky plan është hartuar duke u bazuar në planin qeveritar duke gërshetuar të dhënat dhe specifikat që i ka Komuna e Podujevës. Kështu që edhe për këtë plan kërkojë votën dhe miratimin e Juaj.

z.Valon Demolli, theksoi, ne Grup i LDK-së, e përkrahim këtë propozim plan të veprimit për integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Komunën e Podujevës.

znj.Qëndresë Hajrizi, theksoi, meqenëse ky plan ka si synim kryesor integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në shoqërinë Kosovare duke i'u mundësuar, punësim arsimim dhe vendbanime më të mira si dhe qasje institucionale, duke siguruar edhe mundësi më të mira të pjesëmarrjes së tyre në vendimmarrje, Ne Grupi i LVV-së e përkrahim propozim planin e veprimit për integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian 2023-2026 në Komunën e Podujevës.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri me 20 vota Për nga anëtarët e Kuvendit sa ishin prezent në sallë, miratohet Plani i veprimit për integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian 2023-2026 në Komunën e Podujevës, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

11. Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Lokal afariste në qytet rr. “Skënderbeu”
- Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim sipas këtij propozim vendimi

znj.Saranda Stublla, drejtoresh e DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera theksoi, me lejoni që në bazë të ligjit nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim si dhe Rregullores nr.09/2020 për përcaktimin e procedurës së dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme, të paraqes propozimin për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme ku është e përfshirë parcela me nr.244 P1 ZK Podujevë, ku në këtë parcelë janë të përfshira dy lokale afariste.

Në këtë propozim gjithashtu përfshihet propozimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme, andaj në propozim të Kryetarit të Komunës nga radhët e Ekzekutivit kemi dy drejtorë të Drejtorive Komunale për anëtar të këtij komisioni z.Fatlum Osmani dhe z.Pajtim Balaj, ndërsa sa i përket shoqërisë civile kemi propozimin që ka aplikuar e që është znj.Arbenita Hyseni, prandaj pres nga Kuvendi i Komunës të bëjë propozimin e emrave dhe që të dal në miratim.

z.Valon Demolli, theksoi, nga Grupi i LDK-së e përkrahim këtë propozim dhe njëkohësisht për anëtar në komisionin vlerësues e propozojmë z.Ekrem Rrahmanin.

z.Haki Rudari, theksoi, ne fillimisht e përkrahim propozim vendimin për miratimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme dhe në të njëjtën kohë për këtë komision nga Grupi LVV-së propozojmë z.Ragip Fetahun.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo e vë në votim këtë pikë të rendit të ditës.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri me 20 vota Për nga anëtarët e Kuvendit sa ish in prezent në sallë, miratohet propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Lokal afariste në qytet rr. “Skënderbeu”, sipas propozim vendimit përkatës.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, tani e vë në votim formimin e komisionit përkatës sipas propozimeve të paraqitura. Vlen të cekët se për këtë komision dhe për komisionet pasuese në këtë mbledhje secili prej të propozuarve të shmangët nga konflikti i interesit qoftë në procesin e votimit qoftë në aspekte tjera.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri me 20 vota Për nga anëtarët e Kuvendit sa ish in prezent në sallë, miratohet propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim 2 Lokalet afariste në rr. “Skënderbeu” në qytet, sipas propozim vendimit përkatës, në këtë përbërje:

-Fatlum Osmani, nga Ekzekutivi i Komunës

-Pajtim Balaj, nga Ekzekutivi i Komunës

-Ekrem Rrahmani, nga Kuvendi i Komunës

-Ragip Fetahu, nga Kuvendi i Komunës

-Arbenita Hyseni, nga sektori joqeveritar lokal

12. Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës – Prona e Paluajtshme tokë bujqësore nr.00495-4 Lupç i Poshtëm

- Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim sipas këtij propozim vendimi

znj.Saranda Stublla, drejtoresh e DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera theksoi, pra si propozim vendim kemi parcelën me nr.00495-4 tokë bujqësore që është në Zonën kadastrale Lupç i Poshtëm. Edhe për këtë parcelë duhet të formohet komisioni vlerësues e që nga radhët e Ekzekutivit në propozim të Kryetarit të Komunës janë drejtorët e Drejtorive komunale janë z.Vigan Salihu dhe z.Leutrim Krasniqi, ndërsa nga shoqëria civile si propozim kemi znj.Dea Stublla e cila ka aplikuar për të marr pjesë në këtë komision.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, kërkojë që me rastin e propozimeve dhe formimit të këtyre komisioneve të respektohet kuota gjinore.

z.Naim Çunaku, theksoi, në emër të LDK-së, e përkrahim këtë propozim vendim për miratimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës, tokë bujqësore Lupç i Poshtëm, ndërsa për anëtar në komisionin vlerësues propozojmë znj.Edona Shabani.

z.Burim Hasani, theksoi, edhe ne anëtarët e Kuvendit nga radhët e AAK-së e mbështesim këtë propozim vendim dhe njëkohësisht për anëtar në komisionin përkatës propozoj z. Arbnor Fazliun.

z.Haki Rudari, theksoi, duke e marr për bazë që e kemi AAK si Grup në këtë Kuvend, ne në këtë komision tërhiqemi nga propozimi i jonë dhe duam të lirojmë vend që përfaqësuesi i AAK-së të jetë në komision, ndërsa si pikë të rendit të ditës e përkrahim.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo e vë në votim këtë pikë të rendit të ditës.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri me 20 vota Për nga anëtarët e Kuvendit sa ishin prezent në sallë, miratohet propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës-Prona e Paluajtshme tokë bujqësore nr.00495-4 Lupç i Poshtëm, sipas propozim vendimit përkatës.

Kryesuesi i Kuvendit, tani e vë në votim formimin e komisionit përkatës sipas propozimeve të paraqitura.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri me 20 vota Për nga anëtarët e Kuvendit sa ishin prezent në sallë, miratohet propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim pronën e Paluajtshme tokë bujqësore nr.00495-4 në Lupç i Poshtëm, sipas propozim vendimit përkatës, në këtë përbërje:

- Vigan Salihu, nga Ekzekutivi i Komunës*
- Leutrim Krasniqi, nga Ekzekutivi i Komunës*
- Edona Shabani, nga Kuvendi i Komunës*
- Arbnor Fazliu, nga Kuvendi i Komunës*
- Dea Stublla, nga sektori joqeveritar lokal*

13. Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës – Prona e Paluajtshme tokë bujqësore nr.00202-1 Lupç i Poshtëm

- Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim sipas këtij propozim vendimi

znj.Saranda Stublla, drejtoresh e DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera theksoi, po ashtu kemi propozim vendimin për dhënie në shfrytëzim të parcelës me nr.002202-1, tokë bujqësore në Zonën kadastrale Lupç i Poshtëm, dhe po ashtu edhe formimin e komisionit vlerësues e që nga radhët e Ekzekutivit të Komunës në propozim të Kryetarit të Komunës kemi drejtorin z.Bahri Selimi dhe drejtoreshën znj.Adelinë Stublla, ndërsa nga shoqëria civile si propozim kemi znj.Shqipdon Rushiti, e cila ka aplikuar për të marrë pjesë në këtë komision.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, në emër të Grupit LDK-së, e përkrahim këtë propozim vendim dhe për anëtar të komisionit e propozojmë z.Arjant Topanicën.

znj.Drita Pajaziti, theksoi, në emër të Grupit të LVV-së e përkrahim këtë propozim vendim dhe për anëtar në komisionin përkatës propozojmë z.Bahri Blakçorin.

Kryesuesi i Kuvendit, duke i'ua rikujtuar sërish të pranishmëve që jemi të obliguar të respektojmë kuotën gjinore në çdo komision andaj është mirë që propozimet të jepen në këtë kontekst.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, meqë po kërkohet përfaqësimi gjinor në këto komisione, në emër të Grupit të LDK-së e tërheq propozimin e z.Arjant Topanica edhe në vend të tije propozoj znj.Arnisa Sylejmani.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo e vë në votim këtë pikë të rendit të ditës.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri me 20 vota Për nga anëtarët e Kuvendit sa ishin prezent në sallë, miratohet propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës – Prona e Paluajtshme tokë bujqësore nr.00202-1 Lupç i Poshtëm, sipas propozim vendimit përkatës.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, tani e vë në votim formimin e komisionit përkatës sipas propozimeve të paraqitura.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri me 20 vota Për nga anëtarët e Kuvendit sa ishin prezent në sallë, miratohet propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim - Prona e Paluajtshme tokë bujqësore nr.00202-1 Lupç i Poshtëm, sipas propozim vendimit përkatës, në këtë përbërje:

-Bahri Selimi, nga Ekzekutivi i Komunës

-Adelinë Stublla, nga Ekzekutivi i Komunës

-Arnisa Sylejmani, nga Kuvendi i Komunës

-Bahri Blakçori, nga Kuvendi i Komunës

-Shqipdon Rushiti, nga sektori joqeveritar lokal

14. Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës – Prona e Paluajtshme tokë bujqësore nr.00209-0 Lupç i Poshtëm

- Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim sipas këtij propozim vendimi

znj.Saranda Stublla, drejtoresh e DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera theksoi, gjithashtu kemi propozim vendimin për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme me numër të parcelës 00209-0 në Zonën kadastrale Lupç i Poshtëm, dhe gjithashtu edhe për këtë komision në propozim të Kryetarit të Komunës nga Ekzekutivi kemi drejtorin z.Fatlum Osmani dhe drejtoreshën znj.Adelinë Stublla, kurse nga shoqëria civile si propozim kemi znj.Rahime Cakolli e cila ka aplikuar të jetë pjesë e komisionit vlerësues.

z.Arjant Topanica, theksoi, në emër të Grupit të LDK-së e përkrahim propozim vendimin për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës së Podujevës, pronë e paluajtshme tokë bujqësore me nr.00209-0 Lupç i Poshtëm, kurse për anëtar në komisionin vlerësues nga radhët e Grupit të LDK-së propozojmë z.Naim Çunakun.

z.Florent Hasani, theksoi, në emër të Grupit të LVV-së e përkrahim këtë propozim vendim, ndërsa për anëtar të komisionit e propozojmë znj.Drita Pajaziti.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo e vë në votim këtë pikë të rendit të ditës.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri me 20 vota Për nga anëtarët e Kuvendit sa ishin prezent në sallë, miratohet propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës – Prona e Paluajtshme tokë bujqësore nr.00209-0 Lupç i Poshtëm, sipas propozim vendimit përkatës.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, tani e vë në votim formimin e komisionit përkatës sipas propozimeve të paraqitura.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 20 anëtarët sa ishin prezent në sallë, me 18 vota Për, (2 anëtarë nuk morën pjesë në proces të votimit), miratohet propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim - Prona e Paluajtshme tokë bujqësore nr.00209-0 Lupç i Poshtëm, sipas propozim vendimit përkatës, në këtë përbërje:

-Fatlum Osmani, nga Ekzekutivi i Komunës

-Adelinë Stublla, nga Ekzekutivi i Komunës

-Naim Çunaku, nga Kuvendi i Komunës

-Drita Pajaziti, nga Kuvendi i Komunës

-Rahime Cakolli, nga sektori joqeveritar lokal

15. Propozim Vendimi për vënie në konsultim publik

- Draft Statuti i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare QKMF- Komuna e Podujevës

znj. Adelinë Stublla, drejtoresh e DSHMS, e paraqiti fjalën hyrëse rreth këtij propozim vendimi, ndër të tjera theksoi, kjo pikë e rendit të ditës është sipas planit së punës së Kuvendit, e cila ka të bëjë me vënien në diskutim publik të draft Statutit të QKMF-së. Diskutimi publik propozojmë të zgjatë 30 ditë dhe atë nga data 07.08.2023 deri 06.09.2023, kurse data e debatit publik me qytetarët të mbahet me datën 15.08.2023 në ora 10:00 në sallën e mbledhjeve të Kuvendit, kështu që të gjitha idetë, sugjerimet apo kritikak eventuale mund të adresohen në e -mailin zyrtar të zyrtarit për shëndetësi z.Halit Vërshefci.

z.Valon Demolli, theksoi, në emër të Grupit të LDK-së e përkrahim këtë propozim vendim për vënie në konsultim publik të draft Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare.

z.Artrit Mulliqi, theksoi, në emër të Grupit të LVV-së e përkrahim këtë propozim vendim.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo e vë në votim këtë pikë të rendit të ditës, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje dhe propozimeve të paraqitura nga drejtoresha e DSHMS në fjalën hyrëse rreth diskutimit publik.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri me 19 vota Për nga anëtarët e Kuvendit sa ish-in prezent në sallë, miratohet propozim Vendimi për vënie në konsultim publik - Draft Statuti i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare QKMF - Komuna e Podujevës, me plotësim të nenit 1 të propozim vendimit, dhe atë që kohëzgjatje e konsultimit publik të jetë 30 ditë, prej 07 gusht 2023 deri më 06 shtator 2023 kurse 15 gusht 2023 duke filluar nga ora 10;00.

16. Të Ndryshme

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, do të doja që edhe njëherë të dëgjoja drejtorin e DPUMM rreth rr. Skënderbeu” sepse e bëri shumë të lehtë më herët kur theksoi se është vonuar pak, ndërsa unë e them se nuk është vonuar pak sepse kontrata është lidhur me 09.06.2022, diku me 6 ose 7 janar është dashtë të prehet shiriti dhe të përurohet, ka qenë afati fiks 205 ditë e që janë edhe 210 ditë tjera deri sot, mirëpo ajo që është më interesantja në projekt edhe në faqen e Komunës – Kryetarit të Komunës që kur e ka marrë tenderin ai operator edhe pse i është dhënë punë shtesë, ku është staza për biçikleta në mesë hapësirave të gjelbërimit, mandej ka qenë trotuari për këmbësor e që nuk ekziston, andaj në çfarë mënyre është heq unë nuk e di, por gjelbërimi në mesë trotuarit dhe stazes nuk gjendet. Pastaj diku trotuari është bërë 30 cm, diku 2 metra, prandaj a ka mundësi ta dimë datën se kur përfundon ajo rrugë sepse është bërë film.

Ndërsa pyetja tjetër është për drejtorin e Drejtorisë së Kulturës Rinis dhe Sport, dhe ka të bëjë me listën e përfitueseve të subvencioneve që i ka zgjedhë, pyetja është për OJQ, klubet e futbollit apo shkollat e futbollit që janë paksa si të njëjta, por ka klub që i janë ndarë 5000 euro, ka klub qe i janë ndarë 1000 euro, nuk e di përse keni bërë këtë dallim, si dhe rasti tjetër është ku një klub qe nuk është i regjistruar askund, (basketboll i rrugës) dhe ia keni dhënë 2000 euro, mandej përse i keni dhënë subvencion klubit të karatesë Podujeva ku kryetari i klubit është babai yt drejtor, është z.Nexhmi Balaj ish drejtor i DKRS, pra ia ke ndarë 2000 euro, a është konflikt interesi apo jo.

znj.Edona Shabani, theksoi, së pari i drejtohem Kryetarit të Komunës, a mund të na tregosh se deri kur do të vazhdoj me transfere dhe hakmarrje ndaj punëtorëve të administratës komunale, për kundër faktit se krejt ato vendime që keni nxjerrë janë anuluar nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës.

Tani cili është problemi yt Kryetar me zyrën ligjore, qysh njëherë nxjerrë vendim për transferim të zyrtares së vetme të arsimit, në zyrën ligjore për shkak të mungesës së punëtorëve, kurse ku kalon ai afat i transferit zyrtaren e arsimit nuk e kthen në punën e vet por bënë shkelje ligjore duke transferuar zyrtarin e zyrës ligjore, në Drejtorin e Arsimit.

Ti drejtor i DKA-së z.Avni Fetahu pse bënë kërkesë te Kryetari i Komunës për tu transferuar dikush nga zyra ligjore në Drejtorin e Arsimit dhe atë madje me emër të përveçëm, përse nuk bënë kërkesë që të kthehet zyrtarja kompetente në Drejtorinë e Arsimit, pse ajo jashtëligjshëm të kryej detyrën në zyrën ligjore. Pastaj ti e nderuar drejtoresh e DSHMS znj.Adelina Stublla, pse jepni pëlqim për transferim të jashtëligjshëm si dhe kush ta japi pikërisht emrin e zyrtarit Osman Bajrami, ku është problemi këtu, dua përgjigje.

Të mos harrojë se këto ditë kam takuar shumë qytetarë prej shumë lokaliteteve pikërisht prej nga jemi unë dhe ti zotëri Fetahu, dhe a e dini se çfarë kanë thënë për këtë rast, “qe e bjen punën Avni Fetahu me i’a ndrru punën Osman Vuçës kurrë nuk e kemi besu. A pak kanë vuajtur ata si familje prej komunizmit, madje a e din se çka më tha një familjar shumë i afërt me Osmanin e që ti drejtor e njeh shumë mirë e që të ka ndihmuar ty personalisht shumë në të kallurën, prej atyre që ju ndihmon më së shumti pa marr parasysh pozitat që i mbajnë ata, prej tyre kurrë ditë të bardh nuk pritët. Turpi nuk hahet me bukë, dhe nuk po e zgjas më shumë, por këto fjalë po i them sepse njihemi mes vete unë me drejtorin e DKA-së dhe me zyrtarin në fjalë dhe familjen e tij dhe gjithë familjen Vuça prej fshatrave Balloc, Miroci e Shtedim, prandaj e thash në shenjë respekti për krejt familjen Vuça, që shumica prej tyre zyrtarisht mbajnë mbiemër të ndryshëm. Nuk është dashur t’i ndrrohet vendi i punës sepse i ka djegur pushteti i komunizmit mjaft, përndryshe kanë mund të mos ekzistonin fare si familje, besojë qe e kuptuat këtë që e thash dhe pres përgjigje.

z.Arjant Topanica, theksoi, unë i kam shkurt 2 pyetje për drejtorin e DSHPMSh, i kam parë në rrugë të fshatit Sfeçël se ndriçimi ka filluar të dëmtohet dhe me sa kujtoj keni lidhur kontratë me një kompani për mirëmbajtjen e shtyllave ndriçuese dhe i pash që dy shtylla ditëve të kaluara kanë filluar të dobësohen, ku njëra nuk u ndezët fare, ndërsa tjetra ndezët me ndërprerje gjatë natës e që përveç tjerave pengonte edhe në sy.

Pyetja tjetër e që e kemi diskutuar edhe në të kaluarën, bëhet fjalë për rrugën e ashtuquajtur “ruga e Polonicave”, nga mulliri Vllaznimi në Surkish që del në Sfeçël dhe mandej lidhet deri në fshatin Siboc, e kemi sqaruar një herë nëse e ki të qartë se për cilën rrugë bëhet fjalë, pra është rrugë që lidhë komplet këto fshatra dhe që do të shkarkonte rrugën Shajkoc-Sfeqël-Podujevë dhe është rrugë shumë më e shkurt e që nuk besoj se ka probleme me shpronësim, por që e kemi parë në KAB që nuk përmendet, andaj a ka ndonjë plan për të për të ardhmen, e them këtë sepse është prej rrugëve të vetme që ka mbetur e pa shtruar dhe që ka një gjatësi rreth 1.6 km, prandaj nëse nuk ka asgjë konkrete për atë rrugë, të fillohet të merret në konsideratë dhe të diskutohet me personat kompetent që të fillohet me asfaltim në atë rrugë.

z.Naim Çunaku, theksoi, kësaj radhe, dua t’ia drejtojë një pyetje Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale apo edhe Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit.

Jeni në dijeni se në këta muaj të verës janë sigurisht me një aktivitet të shtuar insektet, në veçanti, ndoshta jam bërë i tepërt duke i përmend lumenjtë dhe hapësirat që ishin të vërshuar, dhe ju e dini kur vërshojnë në mënyrë të pakontrolluar lloj-lloj gjithë ato ujëra të zeza dhe ato kimikale shpërndahen gjithandej, pyetja ime insiston në këtë, a kemi në perspektivën e afërt apo kemi kompani të kontraktuar qoftë për dezinfektim, dezinfektim, deratizim, vërtetë është bërë e

padurueshme, sidomos në mbrëmje nëse nuk mbyllen dyert dhe dritaret nga insektet që atakojnë drejtpërdrejt.

Për të mos hyrë më shumë te ndotja e puseve që edhe ato me një përkushtim sa do të vogël ka mundur të kloritizohen ato puse por nuk jemi duke u furnizuar me ujë të pijshëm nga pusët, andaj mundet edhe të kalohet kjo, mirëpo te kjo situata e rënduar prej insekteve vërtetë është një situatë e rëndë e krijuar dhe nëse keni perspektivë se kur do të bëhet e që këta dy muaj janë kur më së shumti atakohen nga insektet.

z.Ardi Hasani, theksoi, pyetje për drejtorin e DSHPMSh, po e adresojë një kërkesë të banorëve të lagjes Haxhiu në rr."vëllezërit Frashëri" për ndriçim, dhe po ashtu një pjesë me kubëza apo kocka ngase një pjesë e konsiderueshme po mënoj qe një dekadë, prej që kanë qenë qeveritë e kaluar, mungon një pjesë e trotuarit, andaj pyes nëse janë në projekt këto më trego se kur.

z.Valon Demolli, theksoi, një pyetje për drejtorin e DPUMM, një shqetësim i qytetarëve në rr."Rapsodi" në fshatin Obrançë, duket se është rruga e vetme e pa asfaltuar në atë pjesë, do të doja të dija se a është e planifikuar dhe a ka gjasa të shtrohet kjo rrugë.

z.Ardi Hasani, theksoi, kam edhe një pyetje për drejtorin e DPUMM, duke pasur parasysh që ka një kohë të konsiderueshme që ka filluar projekti i fasadimit dhe investimit në banesat kolektive, që është projekt shumë i mirë që i ka munguar qytetit të Podujevës që një dekadë edhe që ja ka kthyer imazhin qytetit, pyetja ime është kështu, objekti banesor që gjendet te banka BKT, a është në projekt dhe nëse është, kur pritet të fillojnë punët në atë objekt.

z.Avni Fetahu, drejtor i DKA, theksoi, e respektuara bashkëvendëse znj.Edona Shabani, duke të përgëzuar për qëndrimin stoik deri në fund të seancës për këtë çështje të pyetjes që shtrove, fillimisht duhet të sqaroj se këtu bëhet fjalë për një transferim për një periudhë kohore 3 mujore, krejt ligjore dhe nuk ka asgjë fare të bëjë me Kryetarin e Komunës në këtë rast, përndryshe është iniciuar një kërkesë nga DKA për shkak të vëllimit të punëve dhe është dhënë një pëlqim nga U.D. drejtoresha e Drejtorisë së Administratës dhe është nxjerrë një vendim nga menaxheri i personelit dhe, jo nga Kryetari i Komunës që e theksuat se i janë refuzuar vendimet Kryetarit të Komunës.

Kështu që nëse personi në fjalë është i pakënaqur atëherë normal ka të drejtë që të bëjë ankesë, dhe shqyrtohet nga organet tjera, përndryshe ai sot ka ardhur në DKA dhe ne nuk kemi ndonjë raport personal dhe asgjë me të, urojë që t'i shkoj puna mirë për këtë periudhë kohore, pra nuk ka asgjë personale as me atë e as me familjarët e ti, gëzojmë respekt për secilin prej tyre dhe ta dini që kjo se si po e përshkruani ju nuk është sikur me ndodh ndonjë krim mbi të, dhe nuk e ka larguar nga puna askush atë dhe as nuk mund të largoj pa pasë ndonjë vepër penale, mirëpo është bërë një transferim që ndodh rëndomtë varësisht prej nevojave dhe kërkesave që i kanë Drejtoritë.

znj.Adelinë Stublla, drejtoresh e DSHMS, lidhur me çështjen e ngritur nga anëtarja e Kuvendit znj.Edona Shabani, theksoi, unë si e autorizuar për ushtrimin e detyrave të Drejtorisë së Administratës fillimisht e kam pranuar kërkesën nga drejtori i Drejtorisë së Arsimit z.Avni Fetahu ku i kemi zhvilluar procedurat tutje. Transferet nuk janë të paligjshme, transferet mund të behën brenda Drejtorive, unë vetë personalisht nga DSHMS e kam dërguar një transfer në Qendrën për Punë Sociale, kështu që brenda për brenda Komunës nuk është absurditet, pastaj në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare bëjmë ndërrime të vendit të punës, kështu që nuk është absurditet, e kemi pa të arsyeshme që personi në fjalë është person i zellshëm që kryen punët mirë meqenëse ka vëllim të madhe të punëve në DKA.

znj.Edona Shabani, theksoi, më falni qe po ju pyes, tani unë nuk e di se si behen transferet në Komunë, mirëpo a behen transferet veç në qoftë se juve ju duhet dikush, apo behët duke pyetur ndoshta personin në fjalë sepse ndihet shumë më mirë në punën që është duke e bërë se sa në at punën që ju e keni transferuar për 3 muaj, apo juve ju pëlqen që ai me dal andej, vetëm të mos jetë

në at pozitë ku është. Unë nuk e di këtë por besojë që as ati zyrtari nuk i ka pëlqyer përderisa jam duke fol dhe nga ajo që kam pasë kontakt, edhe pse i nderuari drejtor z.Avni Fetahu unë asgjë personale nuk kam as me ty e as me z.Osman Bajramin dhe as me familjen e Osmanit, por ta them të drejtën që në momentin që ne jemi këtu jemi dalë prej atyre vendeve Balloc, Miroc Livadic Shtedim, ato vende neve na kanë ngritur për me ardhur deri këtu sepse nuk kemi pikur prej qiellit, prandaj unë kam të drejtë që pakënaqësitë e qytetarëve apo bashkëvendësve tonë t'i shfaq dhe do ti shfaq deri sa unë jam këtu ulur në këtë ulëse, jo veç atyre por krejt qytetarëve.

z.Pajtim Balaj, drejtor i DKRS, theksoi, lidhur me pyetjet që janë bërë për subvencionet, fillimisht ju rikujtoj se subvencionet ndahen nga komisioni, vendimin për themelimin e të cilit nuk e nxjerrë unë, dhe as nuk mund të imponoj. Së dyti, pyetja lidhur me klubin e karatesë Podujeva, në fakt këtij klubi në vitin e kaluar i kemi hi në hak sepse nuk kemi mund t'i ndihmojnë fare për arsye se i ka ikur thirrja dhe kanë dështuar të marrin pjesë në disa gara evropiane, ndërsa prindi im ndoshta në vitin e parë pas pensionimit ka qenë me kërkesën e themeluesve të klubit si kryetar i klubit, nëse nuk gabojë sepse ka 10 vite që nuk ka të bëjë asgjë me atë klub çështje kjo e cila mund të verifikohet, madje mund të konsultoheni me klubin e karatesë dhe mund ta përcillni veprimtarinë e tyre. Jo vetëm prindi im por asnjë familjar i imi nuk ka të bëjë me këtë klub dhe asnjë klub tjetër. Ndërsa në lidhje me organizatën OJQ LLAPI 01, nuk është klub sportiv, është organizatë që merret me organizimin e aktiviteteve sportive, rrjedhimisht subvencionet në sport nuk janë vetëm për klube, në fakt janë për projekt propozime të cilat synojnë zhvillimin e sportit, OJQ në fjalë është bërë për organizimin e streetballit ku një edicion është mbajtur mbrëmë dhe deri në fund të verës pritet të mbahet edhe një tjetër, pra mbrëmë për shkak të reshjeve të shiut është dashtë të zhvendosemi në palestrën sportive dhe nuk ka pasur mundësi të arrijë efektin e vetë të cilën e ka pasur, rrjedhimisht do të zhvillohet edhe një edicion tjetër deri në fund të verës.

Këto janë vlerësime të komisionit për të cilat jeni të mirëseardhur të kërkonti dokumentacionin të verifikoni nëse kanë qenë në rregull apo nuk kanë qenë në rregull, dhe fundja këto i ka bërë komisioni, kurse përgjegjësia ime si drejtor është vetëm nënshkrimi i kontratës i cili bëhet pas nxjerrjes së vendimit nga komisioni dhe Kryetari i Komunës, për çka do tjetër ju lutëm urdhëroni.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, e potencova edhe më herët rreth dallimeve në ndarjen e subvencioneve për disa shkolla të futbollit dhe klubeve sportive, nëse paraqitet nevoja unë mund t'i përmendi me emra dhe nuk e kom problem fare, mirëpo ka shkollë të futbollit që është më e dobët dhe me më pak nxënës dhe ka marr 5000 euro, kurse tjera kanë marrë nga 1000 euro dhe disa tjera nga 2000 euro, përse kjo laramani kështu.

Sa i përket prindit që e përmende ti drejtor i DKRS-së, unë nuk kam shpikë asgjë, por vetëm e potencova atë që i figuron emri si drejtor e që kushdo që ka facebook mund ta shoh këtë që z.Nexhmi Balaj në CV e vet, në rreshtin e parë shkruan kryetar i klubit të karatesë Podujeva, pra këtë mund ta shihni kushdo që dëshironi, madje edhe në këtë moment, por unë në fakt nuk e di a punon aty a jo, vetëm e di çka shkruan në CV e t'i në facebook.

z.Pajtim Balaj, drejtor i DKRS, theksoi, po e përsëris sërish që vlerësimi është bërë nga komisioni përkatës në bazë të rezultateve të klubeve, e di që mund të ketë lëshime ndoshta, kanë hyrë në hak ndokujt, mirëpo ne e kemi edhe një thirrje të dytë dhe në bazë të rezultateve sigurisht se gabimet do të korrigjohen.

Sa i përket pozitës që prindi im e ka pasur në klub ju tregova më herët, mund të vini ta shikoni dokumentacionin, mund ta konsultoni klubin, ka ndoshta 9 ose 10 vite që nuk është në atë pozicion, por që mund të mbetet në rrjetet sociale ashtu ndoshta, i ka mbetur që është edhe drejtor i DKRS-së por nuk është më. Pra kjo çështje është lehtë e verifikueshme, mundesh edhe vetë me ardhë në DKRS me pa dokumentacionin e klubit, por edhe ta konsultoni klubin dhe ta pyesni nëse

ka ndonjë rol prindi im në atë klub. Unë me përgjegjësi të plotë publikisht e them që nuk ka asnjë rol në atë klub që ndoshta 9 ose 10 vite, dhe që roli i tij aty ka qenë shumë i shkurt dhe është bërë me kërkesën e themeluesve të klubit, ndoshta me besim që ka qenë drejtor i DKRS dhe me mendimin që mund t'i ndihmoj diçka, madje nëse nuk gaboj është tërheq prej atij pozicioni kur ka filluar të ndëshkohet prej subvencioneve në atë kohë, dhe për të mos e dëmtuar klubin për shkak të rrethanave politike është tërheq, sa kujtoj ky ka qenë arsyetimi edhe pse kurrë nuk pas ndonjë rol të rëndësishëm aty.

z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSH, theksoi, janë pyetje për të cilat nuk kërkohet shumë sqarim dhe po mundohem shkurt të jap sqarime dhe përgjigje. Te ndriçimi publik, në rrugët e fshatit Sfeçël, jo vetëm ajo që e ceku z.Arjant Topanica, ka edhe disa defekte në rrugë tjera sepse ne e dimë që këto dritat Lled e kanë njëfarë qëndrueshmërie dhe kërkojnë një mirëmbajtje më të theksuar përkundër asaj të mirës që e kanë se janë eficiente apo më të kursyeshme, por e kanë problemin që e kanë afatin kohor të qëndrueshmërisë së tyre, mirëpo ju them që kontrata për mirëmbajtjen e ndriçimit publik por edhe zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik janë në procedura dhe sipas informacioneve nga zyra e prokurimit më thanë që sot kalon afati i ankesave, janë shpallur fituesit por janë 6 ditë kohe ankesë, e di që deri në ora 3 nuk ka pasur ndonjë ankesë siç më thanë zyra e prokurimit por që zakonisht ankesat behën në kohë të fundit, shpresojë që nuk është bërë asnjë ankesë dhe nëse nuk ka ankesë për këto dy kontrata edhe mirëmbajtja dhe zgjerimi prej nesër janë të gatshme të lidhen me operator të cilët janë shpallur fitues dhe kjo e mirëmbajtjes do të filloj menjëherë me gjitha problemet ku janë gjithandej Komunës, me renovimin dhe rregullimin e tyre si dhe kjo e ndriçimit publik janë pozicionet të caktuara se ku do të behët zgjerimi publik i secilës sipas kësaj kontrate.

Për rrugën që diskutuam dhe që u përmend si kërkesë për asfaltim, po e lë drejtorin e DPUMM sepse asfaltimet janë kompetencë e kësaj Drejtorie dhe nuk po e marr primatin për tu përgjigjur.

Ishte edhe njëra prej pyetjeve për Dezinfektim, Dezinsektim dhe Derratizim - DDD, kontrata e cili ka qenë e lidhur tash e 3 vite për DDD ka përfunduar më 29 qershor, ne brenda kësaj kontrate kemi arritur që një herë të bëjmë dezinfektimin, por kjo çështje kërkon që të bëhet në dy faza, është ashtu e rregulluar ashtu që faza e parë nuk është që eliminon të gjitha dhe fatkeqësisht kemi mbetur pa e bërë edhe fazën e dytë për shkak të përfundimit të kontratës. I kemi filluar menjëherë procedurat për iniciimin e kontratës së re, është shpallur në prokurim për kontratë e re dhe kjo është kontratë që përfshin 3 drejtori, DSHPMSH për dezinfektim të hapësirave të jashtme, DA për administratën e komunës dhe DSHMS për objektet shëndetësore, dhe tan jemi në pritje të përfundimit të procedurave dhe shpresojmë që shumë shpejt do të lidhet si kontratë e që në momentin e lidhjes do të fillohet me fazën e dytë të DDD në mënyrë që të mos bëhet vonë pastaj një gjë e tillë e që ndoshta duhet ta pranojmë tani se mund të jetë pak vonë për fazën e dytë të DDD sepse për këtë është një afat se kur duhet të ndodh për të qenë efikas si proces në dy faza.

Edhe pyetja për rr."vëllezërit Frashëri", për ndriçimin publik dhe trotualet, këtë çështje e kemi diskutuar edhe njëherë në Kuvend që ndriçimi publik nuk është bërë deri tani për shkak se nuk ka pasë shtylla të KEDS- it në atë pjesë, ne zakonisht kontratat po i lidhim për vendosjen e ndriçimit publik në shtylla për shkak të kostos më të lirë, pra po bëjmë vendosjen e ndriçimit në shtylla sepse kemi kontratë me KEDS-in për këtë punë, përndryshe nëse e bëjmë me shtylla të Komunës është një kosto tepër e madhe dhe nuk do të mund ta zgjerojmë shumë rrjetin, mirëpo në bazë të nevojave dhe kërkesave mund edhe të bëjmë edhe pse rruga e cekur është në qytet ne e kemi futë në projekt dhe ndriçimi do të bëhet me shtylla të metalit e jo në ato të KEDS-it sepse nuk ka mundësi që KEDS t'i vendos aty, pra parashihet në kontratën e re e cila pritet të lidhet shpejt.

Po ashtu edhe për trotuaret në atë rrugë kemi pranuar shqetësim nga ana e juaj edhe më herët, dhe tani jemi në fazën e ndërtimit të trotuareve, pra e kemi paraparë edhe këtë pjesë për lidhjen e atij trotuari ku ka shkëputje sepse aty është veç një shkëputje.

z.Leutrim Krasniqi, drejtor i DPUMM, theksoi, u përmend disa herë projekti i rr.“Skënderbeu” ndoshta nuk është deri në këtë formë siç u cek sepse unë e konsideroj që është një kohë optimale për të cilën është përfunduar dhe do të përfundojë kjo rrugë. Sa i përket gjelbërimit nuk është hequr gjelbërimi mirëpo duke marr për bazë një numër të madhe të bizneseve të cilat operojnë në atë rrugë, ka qenë një pengesë e madhe një shirit i tillë gjelbërues që do të pengonte edhe lëvizjen edhe qarkullimin e këtyre bizneseve përgjatë rrugës, dhe në vend të shiritit gjelbërues janë zëvendësuar drunj të, pra do të vendosen drunj dekorativ në tërësi në të dy anët e rrugës.

Siç e përmenda edhe paraprakisht plani dinamik është ekzekutuar në tërësi, ka pasur një shtyrje të saj shkaku i mërgimtareve gjatë periudhës së vitit të kaluar, pra ka filluar afërsisht në majin gusht për shkak të qarkullimit të madhe, përveç arsyeve që përmenda edhe KEDS është njëri prej faktorëve të cilët kanë shkaktuar vonesa në ekzekutimin e projektit të rrugës në fjalë.

Sa i përket pyetjes lidhur me rr.“Rapsodi” në Obrancë, në këtë vit nuk parashihet në projektbuxhet për tu asfaltuar, kanë qenë disa rrugë të cilat kanë një kontratë tjetër, mirëpo ajo rrugë nuk figuron, kurse në vitin e ardhshëm mbetet të shihet në kuadër të buxhetit që do të miratohet.

U përmend edhe meremetimi i objekteve banesore si një ndër kontratat më të rëndësishme për qytetin, pas përfundimit të objektit në fjalë që është përballë sheshit të Dëshmorëve do të vazhdohet edhe objekti ku gjendet BKT, pra në varësi të kontratës dhe pozicioneve do të mbesin të lira sepse janë disa lloje të kontratave të cilat po shpenzohen edhe në varësi të shpenzimit apo mbetjes që do të kemi, ne do të vazhdojmë por gjithsesi edhe nëse nuk do të ketë brenda kësaj kontrate, ne jemi në përgatitje të projektit tjetër që do të vazhdojmë edhe me objekte publike për meremetimin e tyre.

Gjithashtu ishte edhe pyetja për asfaltimin e rrugës lidhëse Sfeçël-Dumosh, nuk është në planifikime për këtë vit mirëpo nëse është në afërsi të hekurudhës atëherë është problematike pronësia, ne në fakt kemi edhe rrugë dhe lagje tjera të caktuara të qytetit në afërsi të varrezave që nuk kemi mundësi t’i asfaltojmë shkak i pronës. Pra ajo rrugë momentalisht nuk është e planifikuar por do ta shohim si mundësi së paku për vitin 2024 t’i fillojmë procedurat e përgatitjes së projektit.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, dëshiroj të shtojë diçka rreth propozimit që e bëri z.Valon Demolli, ajo rrugë është në mes fshatrave Obrancë - Llapashticë, aty janë 2 familje që fëmijët i dërgojnë në shkollë në Llapashticë edhe e kanë problem sepse kalojnë nëpër zabel dhe nuk kanë rrugë. Aty më me rëndësi do të ishte ndërtimi i një rruge e cila e lidhë shtëpitë e tyre me shkollën e fshatit Llapashticë, sepse ata për momentin rrugëtojnë nëpër mal.

z.Naim Çunaku, theksoi, kam edhe një pyetje, çfarë është bërë me pullazet e atyre objekteve që janë fasaduar në qytet, dihet mirëfilli sepse një pjesë e mirë e atyre ndërtesave kanë qenë të mbuluar me azbest e që dihet efektet e azbestit që shkaktojnë efekte kancerogjene, si dhe a janë larguar apo vetëm janë mbuluar me një pjesë tjetër gjegjësisht me llamarinë dhe ato kanë mbetur sërish si bomba të kurditura për brenda ndërtesave.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, drejtori i DPUMM fajin i’u la ardhjes së mërgimtarëve por rr.“Skënderbeu” ka filluar më 09 qershor 2022 dhe ka pasur 205-210 ditë për ekzekutim e që nënkupton se është dashur të përfundoj me 5 deri 10 janar, tani jemi në ditën e fundit të korrikut që i bie edhe aq ditë, pra edhe 210 tjera. Nuk e kuptoj qysh ke guxuar ti drejtor apo kushdo qoftë që ka marr vendim për ta larguar gjelbërimit nga ai projekt dhe të merr vendim për të mbjellë drunj, kush e analizoj qe mu largu hapësira të gjelbëruara ndërmjet trotuareve të këmbësoreve dhe stazës së biçikletave më u mbjellë drunj, përse nuk është bërë projekti në fillim, është dashtë në fillim me

thënë nuk ka vend e jo me publiku hapësirën e gjelbëruar në çdo vend tek faqja juaj dhe në ueb faqen e Komunës dhe të Kryetarit të Komunës, çdo kund në projekt është hapësira e gjelbëruar, qysh e hjekët tani, a ka pasë të formuar komision për këtë, a i është zbritur çmimin kompanisë apo është rritur çmimi sepse sa jam në dijeni ajo kompani ka marr edhe punë shtesë, plus janë larguar hapësirat, dhe tani i thuhet mbjelli disa drunj, madje ne nuk e dimë as çfarë cilësie kanë drunjët, kështu që goxha e çuditshme më duket kjo.

z.Leutrim Krasniqi, drejtor i DPUMM, theksoi, pikë së pari është menaxheri i kontratës së bashku me zyrtarin mjedisor të cilët i ndërmarrin masat e nevojshme për materialet e rrezikshme të cilat konsiderohen për shëndetin e njeriut. Çështja tjetër që ka të bëjë me rr.“Skënderbeu” unë nuk jua lash aspak fajin mërgimtarëve, por e thash se për hir të tyre kemi shtyrë afatin për 1 muaj në procesin e fillimit të punimeve apo të gërmimeve në rr.”Skënderbeu”.

Meqë nuk pati të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, Kryesuesi e konstatoi të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 17:55

**Procesverbalin e mbajti;
Enis Sheholli**

**Nr.Prot.01-060/04-0055054/23
Podujevë,
31 korrik 2023**

**Kryesuesi i Kuvendit
Hilmi Hoxha**



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS

Kryesuesi i Kuvendit

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d) dhe 40.2 shkronja d) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040, nenit 13 paragrafi 1.2 të Rregullores (MAPL) nr.02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës, nenit 6 paragrafi 1.1 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në Komuna, neneve 14, 15 paragrafi 2.3 dhe 34 paragrafi 2.4 të Statutit të Komunës së Podujevës, nr.prot.01-020/01-0050862/18, Kuvendit të Komunës së Podujevës, i,

Propozohet

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT AD-HOC PËR HARTIMIN E DRAFT PLANIT TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2024

Neni 1

Me këtë vendim formohet komisioni ad-hoc për hartimin e Draft Planit të punës së Kuvendit të Komunës së Podujevës për vitin 2023, dhe atë në këtë përbërje;

1. _____, kryesues i komisionit
2. _____, anëtar nga radhët e Kuvendit
3. _____, anëtar nga radhët e Kuvendit
4. _____, anëtar nga radhët e Kuvendit
5. _____, anëtar nga radhët e Kuvendit
6. _____, anëtar nga radhët e Kuvendit
7. _____, anëtar nga radhët e Ekzekutivit
8. _____, anëtar nga radhët e Ekzekutivit
9. _____, anëtar nga radhët e Ekzekutivit

Neni 2

Komisioni sipas këtij vendimi, përgatit draftin fillestar të Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024, organizon konsultime publike si dhe zhvillon të gjitha veprimet e nevojshme procedurale deri në hartimin final dhe procedimin në Kuvendin e Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Neni 3

Komisioni bashkëpunon dhe koordinon me Ekzekutivin e Komunës dhe shërbimet përkatëse në kuadër të Institucionit të Komunës së Podujevës.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryesuesi i Kuvendit.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Nr.prot. 01-016/01-0077033/23
Podujevë, datë: 19.10.2023



Kryesuesi i Kuvendit
Elmi Hoxha



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova

Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040, nenit 13 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 04/2018 për Transparencë në Komuna, Udhëzimin Administrativ (MAPL) nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, nenit 13 paragrafi 1.1 të Rregullores (MAPL) nr.02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës, dhe nenit 14, 15 paragrafi 2.4 të Statutit të Komunës së Podujevës, nr.prot.01-020/01-0050862/18, Kuvendit të Komunës së Podujevës, i,

Propozon

VENDIM PËR VËNIE NË KONSULTIM PUBLIK

Neni 1

Vëhet në konsultim publik:

- **Draft Plani Lokal i Veprimit për Barazi dhe Diskriminim në Komunën e Podujevës 2023-2026**

Neni 2

Diskutimi publik sipas këtij paragrafi, zgjat 30 ditë përkatësisht prej datës, ___ __ 2023 deri më ___ __ 2023, brenda së cilës Zyra për Komunikim me Publikun dhe Informim në bashkëpunim dhe koordinim me Njësinë për të Drejtat e Njeriut, dhe Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim mund të organizojnë diskutime/konsultime të ndryshme publike, kurse Debati i përgjithshëm publik me qytetarë mbahet më ___ __ 2023 duke filluar nga ora ___;___, në ndërtesën e re të Komunës, katë përdhës - salla e mbledhjeve.

Neni 3

Propozimet, sugjerimet, apo vërejtjet eventuale paraqiten gjatë debateve publike, gjithashtu në formë të shkruar mund të paraqiten gjatë kohëzgjatjes së diskutimit/konsultimit publik në Zyrën për Komunikim me Publikun dhe Informim, ndërtesa e re e Komunës zyra nr.54, si dhe në formë elektronike në e-mail adresën; info.podujeva@rks-gov.net; të cilat pastaj përcjellën në Njësinë, brenda periudhës së diskutimit/konsultimit publik.

Neni 4

Dokumenti sipas nenit 1, është pjesë përbërëse e këtij vendimi dhe i njëjti publikohet në ueb-faqen zyrtare të Komunës: <http://kk.rks-gov.net/podujeve> (rubrika; aktet për diskutim publik), në Platformën qendrore të konsultimeve publike, si dhe në lokalitete të ndryshme aty ku Komuna e vlerëson të nevojshme.

Neni 5

Konsultimi/debati publik zbatohet nga Zyra për Komunikim me Publikun dhe Informim e cila bashkëpunon dhe koordinon me Njësinë për të Drejtat e Njeriut, dhe Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim, që përkujdesen për përgatitjen dhe publikimin e raportit nga konsultimi dhe debati publik dhe të jepen sqarime për arsyeshmërinë e pranimit ose mospranimit të propozimeve dhe sugjerimeve konkrete.

Neni 6

Pas shqyrtimit dhe miratimit, Vendimi hyn në fuqi pas 7 ditë pas publikimit ueb faqen zyrtare të Komunës.

Nr.prot. 02-016/01-0077096/23
Podujevë, datë: 19.10.2023





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS
Njësia për të Drejtat e Njeriut

DRAFT
PLANI LOKAL I VEPRIMIT PËR BARAZI DHE DISKRIMINIM NË
KOMUNËN E PODUJEVËS 2023-2026

Shtator 2023

Shkurtesat

Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK) është mekanizmi me bazën më të detajuar ligjore të zhvilluar përmes bashkëpunimit ndërmjet organeve të nivelit qendror që kanë përgjegjësi të drejtpërdrejtë, apo të tërthortë për çështjet e komuniteteve:

Buxheti i Konsoliduar i Kosovës BKK

Kuvendi Komunal Podujevë KKP

Drejtorja Komunale e Arsimit DKA

Drejtorja e Administratës DA

Drejtorja e Shendetësisë dhe Mirëqenies Sociale DSHMS

Drejtorja e Financave DF

Drejtorja për Planifikim dhe Zhvillim Ekonomik DPZHE

Drejtorja e Planifikimit Urban dhe Mbrojtje Hapsinor DPUMH

Drejtorja e Sherbimeve Publike DSHP

Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport DKRS

Drejtorja e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural DBPZHR

Drejtorja për Gjeodezi dhe Kadastër DGJK

Policia e Kosovës PK

Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës ZKM

Zyra për Komunitete dhe Kthim pranë Kryeministrit ZKK

Zyra për qeverisje të mirë, të drejta të njeriut, mundësi të barabarta dhe çështje gjinore ZQMTNJMBÇGJ

Ministria për Komunitete dhe Kthim (MKK),

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS),

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL),

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor (MAPH),

Ministria e Integritimit Europian (MIE),

Ministria e Drejtësisë (MD),

Ministria e Punëve të Brendshme (MPB),

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT),

Ministria e Administratës Publike (MAP),

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI)

Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE),

Ministria e Financave (MF)

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS)

Ministria e Diasporës (MeD)
Policia e Kosovës (PK)
Qendra për Punë Sociale (QPS)
Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK)
Njësi për të Drejtat e Njeriut dhe Barazia Gjinore
Komiteti Komunal Veprues, Komuna e Podujevës

HYRJE

Qeveria e Republikës së Kosovës vazhdon të jetë e përkushtuar në parimet e saj për një shoqëri demokratike, me të drejta të barabarta për të gjithë qytetarët pa dallim etnike, feje, gjuhe, gjinie, moshe në bazë të legjislacionit të saj primarsi Kushtetuta e Kosovës dhe atyre ndërkombëtare. Qeveria e Kosovës shpreh përkushtimin dhe angazhimin e plotë në zbatimin e prioriteteve të “Strategjisë dhe Planit të Veprimit të integritetit të komuniteteve rom, shkali dhe egjiptian 2022 – 2026” të cilat në të njëjtën kohë paraqesin përgjigje ndaj kërkesave të procesit të Stabilizimit dhe Asocimit. “Strategjia dhe Plani i Veprimit për integritet të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian 2022 – 2026” mbaron në vitin 2026, Prandaj Qeveria e Kosovës duke i kushtuar rëndësi të veçantë përmirësimit të pozitës së komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në “Planin e dokumenteve strategjike të qeverisë për vitin 2022-2026” ka përfshirë edhe hartimin e planit të ri. Për realizimin e Planit të Veprimit Komuna e Podujevës, përkatësisht Zyra për Komunitete dhe Kthim në bashkëpunim me Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim Europian OSCE, me pjesëmarrje të të gjitha drejtorive komunale, institucioneve të Sigurisë dhe Organizatave Joqeveritare që veprojnë në Podujevë ka hartuar Planin e ri të Veprimit 2023 – 2025. Ky plan ruan strukturën organizative të Planit të Veprimit të Qeverisë së Kosovës, rrjedhimisht ky plan është hartuar duke u bazuar me planin qeveritar duke gërshetuar të dhënat dhe specifikat që ka komuna e Podujevës.

Në bazë të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje ishte përpjekje e përbashkët e grupit punues për hartimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit edhe për Planin Lokal të Veprimit për Barazi dhe Diskriminim në Komunën e Podujevës 2023-2026. - Strategjia dhe Plani i Veprimit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Planit të Veprimit Lokal për Barazi dhe Diskriminim.

Është një nga dokumentet më të rëndësishme të Komunës së Podujevës, hartimi i të cilit ka ndjekur një proces të gjatë diskutimesh dhe kontributesh konkrete të institucioneve relevante që punojnë për këtë fushë për ta parandaluar diskriminimin dhe për të avansuar çdoherë për barazi dhe të drejtat e njeriut pa diskriminim.

METODOLOGJIA:

Procesi i hartimit të Planit Lokal të Veprimit për barazi dhe diskriminimin në Komunën e Podujevës për vitin 2023-2026.

Në përgjithësi ky Plan Veprimi është hartuar në përputhje me sugjerimet, kërkesat dhe kontributet e përfaqësuesve të ndryshëm nga Komuna e Podujevës, Komiteti Komunal Veprues si dhe përfaqësues të OJQ-ve dhe grupeve avokuese që merren me të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore që merren me grupet e cënueshme për barazi dhe të drejtat e tyre.

Ku rolin kryesor e ka Njësiti për të Drejtat e Njeriut dhe Barazia Gjinore.

* Pas themelimit të Komitetit Komunal Veprues dhe grupeve punuese nga Komuna janë zhvilluar disa takime konsultative dhe tri punëtori për hartimin e këtij Plani Lokal të Veprimit.

* Për të avansuar edhe më tutje përfshirjen në këtë Plan të Veprimit kontribut kanë dhënë edhe OJQ-të vendore që vijnë nga komunitetet

jo-shumicë siç janë: OJQ “Qëndrimi”, OJQ “Një hap me ne” dhe OJQ “Shpresa Demokratike”.

* Po ashtu është angazhuar edhe OSBE-ja e cila ka përkrahur dhe ndihmuar me këshilla dhe mbështetje në facilitimin e punëtorëve për këtë plan të veprimit për barazi dhe diskriminim në të gjitha fushat e jetës.

VIZIONI DHE MISIONI:

* Komuna e Podujevës ka përcaktuar vizionin e saj për avansimin e pozitës së komuniteteve jo-shumicë dhe të gjitha grupeve të cënueshme duke krijuar një ambient të përshtatshëm social, ekonomik, arsimor, shëndetësor, pronësor etj, që mundëson zbatimin e legjislacionit në fuqi dhe përmbushë standartet më të larta të të drejtave të njeriut.

*** MISIONI:**

